



ANALIZA VJETORE 2024 E VEPRIMTARISË TË INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ 2025

Lënda: Dërgimi i Analizës Vjetore për 2024

Z. Ervin HOXHA

MINISTËR I BRENDSHËM

TIRANË

I nderuar Z.Ministër,

Në zbatim të Ligji Nr.9780 datë, 16.07.2007 “ Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme ”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr.893, datë 4.11.2015 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit ”, i ndryshuar, si dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, po ju dërgojmë sa më poshtë:

- Analizën Vjetore të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për vitin kalendarik 2024.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTOR

Dallëndyshe BICI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME
INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2024

A N A L I Z Ë
E VEPRIMTARISË SË PUNËS TË IKMT-së
PËR VITIN 2024

I. HYRJE

IKMT-ja gjatë vitit 2024, ka pasur si objektiv qendror rritjen në konsolidimin e nivelit të:

1. Rritjes të performancës në drejtim të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe në fusha të tjera inspektuese të mjedisit, pyjeve dhe ujrave;
2. Mbikëqyrjes së zonave me qëllim parandalimin e punimeve/ndërtimeve të paligjshme, kryesisht në zonat e mbrojtura, të infrastrukturës publike, zonave bregdetare dhe liqenore etj;
3. Realizimin me korrektësi të inspektimeve sipas përcaktimeve të akteve ligjore dhe nën/ligjore dhe programeve të miratuara në nivel qendror edhe në fushat e shtuara të përgjegjësi të IKMT-së;
4. Mundësimin e zgjidhjeve sa më efikase për të shmangur sa më shumë pasojat e zhvillimeve të paligjshme në territor;
5. Dhënien dhe përpunimin e informacionit në kohë sa më të saktë për vendimmarrësit.
6. Mbikëqyrja me instrumentat që disponohet sipas strukturës së miratuar, për kryerjen e inspektimeve me korrektësi.

Gjatë kësaj periudhe analizuese, nëpërmjet intensifikimit të punës në të gjitha strukturat e saj është bërë e mundur:

1. Evidentimi, procedimi dhe prishja e ndërtimeve pa leje/me leje (pas trajtimit sipas legjislacionit) konkretisht:
 - Në zonat e brezit të zhvillimit të kontrolluar dhe zonave me përparësi të turizmit.
 - Ndërhyrja ndaj ndërtimeve pengesë për zhvillimet e projekteve me interes publik.
2. Mbrojtja e territorit nga krimi mjedisor është një sfidë e vazhdueshme për institucionin tonë ku përveç ndëshkimit me masë administrative të subjekteve vazhdon bashkëpunimi për procedimin penal të këtyre kundërvajtësve. IKMT ka hartuar një plan veprimi të detajuar për çlirimin e hapësirave publike, i cili do të vazhdojë me intensitet të lartë dhe gjatë vitit 2025.
3. Kontrolli dhe mbrojtja e territorit është prioriteti më i madh për IKMT-në.
4. Një qasje më e madhe me digjitalizimin dhe informatizimin e shërbimeve online, për kontrollin më të detajuar të territorit të vendit, në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe çlirimin e

hapësirave publike të zaptuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

5. Bashkëpunimi i ngushtë: Trinomi: IKMT, Policia e Shtetit dhe qytetar.

II. VEPRIMTARIA DHE AKTIVITETI I IKMT-SË ËSHTË MBËSHTETUR NË KËTO DOKUMENTE KRYESORE:

- Ligji Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.8402, datë 10.09.1998, “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.9290, datë 07.10.2004, “Për Produktet e Ndërtimit”, i ndryshuar;
- Ligj Nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar,
- Ligji Nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji 57/2020 “Për Pyjet”;
- Ligjit Nr.10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
- Ligjit Nr.9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin e ujërave të ndotur” i ndryshuar;
- Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar;
- Ligji Nr.61/2016 “Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë”;
- Ligji Nr.9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10448 date 14.07.2011 " Per Lejet e Mjedisit" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10440 date 07.07.2011 " Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" i ndryshuar;
- VKM Nr.893, datë 4.11.2015 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, i ndryshuar;
- VKM Nr.894, datë 4.11.2015 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit e ai Vendor”;
- VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar;
- VKM Nr.798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”;
- V.K.M Nr.438, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore”;
- Udhëzimit Nr.2, datë 03.03.2017 “Për kërkesa teknike të caktimit të ngastrës dhe grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
- Urdhrit Nr.424, datë 25.11.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”.

III. PERFORMANCA E IKMT-SË :

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar:

1. Numri ankesave/shkresave (të reja dhe në vazhdim) për kthimin e përgjigjeve të si dhe vënien në dispozicion të informacionit për institucione dhe individëve kërkuar është: 9681

Gjatë vitit 2024, IKMT-ja ka mbajtur këto vendime:

- 427 Objekte/ndërtime të prishura, të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin/VKM shpronësimi.
- 261 Vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje;
- 159 Vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën e mjedisit, ujërave;
- 2 Vendime për dënim me gjobë të vëna në fushën pyjeve;

- 6 Vendime për dënim me gjobë të vëna mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet e ndërtimit/burimet ujore;
- 19 Vendime për dënim me gjobë të vëna ndaj Kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprime/mosveprimet e tyre.

2. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoritë Qendrore të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, numri i inspektimeve të realizuara është: 1480

- Numri i inspektime që janë realizuar në Fushën e Mjedisit dhe Burimeve Ujore: 283.
- Numri i inspektime që janë realizuar në Fushën e Ndërtimit: 1059.
- Numri i inspektime që janë realizuar në Pyje: 110.
- Numri i inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit: 28.

3. Nga Drejtoritë Qendrore të IKMT – së, trajtimi shkresor i ankesave/shkresave (këto të reja dhe në vazhdim), për kthimin e përgjigjeve të ankesave/kërkesave të paraqitura si dhe vënien në dispozicion të informacionit për institucionet dhe individëve kërkuar është: 5226

Ankesa në total nga Platforma e Bashkëqeverisjes, “Shqipëria që duam”: 141

4. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoritë Rajonale të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, numri i inspektimeve të realizuara është: 6436

- Numri i inspektime që janë realizuar në Fushën e Mjedisit dhe Burimeve Ujore: 2174.
- Numri i inspektime që janë realizuar në Fushën e Ndërtimit: 2151.
- Numri i inspektime që janë realizuar në Pyje: 1623.
- Numri i inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit: 298.
- Numri i inspektime në monitorim në shkollë: 190.

5. Nga Drejtoritë Rajonale të IKMT – së, trajtimi shkresor i ankesave/shkresave (këto të reja dhe në vazhdim), për kthimin e përgjigjeve të ankesave/kërkesave të paraqitura si dhe vënien në dispozicion të informacionit për institucionet dhe individëve kërkuar është: 4314

6. Operacioni “Bregdeti ynë” i ndërmarrë nga IKMT në bashkëpunimin Policinë e Shtetit ka në fokus të tij lirin e hapësirave publike, të zaptuara pa leje nga pronarë subjektsh që operojnë përgjatë vijës bregdetare në vendin tonë. Në kuadër të këtij aksioni janë kryer inspektime në terren në të gjitha stukturat e ngritura përgjatë bregdetit, në total janë kryer 84 prishje.

Ndërhyrjet në prishjet të objekteve si më poshtë:

- Bashkia Himarë (në plazhin e Dhërmiut, Drimadhas, plazhi Gjipe, Qeparo dhe Borsh);
- Bashkia Sarandë (në plazhin e Lukovës dhe Ksamilit);
- Bashkia Shkodër (zona përendimore e liqenit).

7. Në vijim të projektit “Rishikimi i Projektit për Segmentin Rrugor të vazhdimin Unaza e Madhe Tiranë nga “Sheshi Shqiponja - “Bulevardi i Ri “ dhe rikualifikimi i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6 të ndryshuar është realizuar prishja e 103 objekteve nga 1 deri 6 kat. të trajtuara me VKM shpronësimi, me VKM 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT ja. Në vijim të projektit segmentit rrugor “Thumanë - Vorë Keshar” është realizuar prishja e 82 objekteve nga 1 deri 4 kat. të trajtuara me VKM shpronësimi, me VKM 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT ja.

Aktualisht, vazhdon puna nëpërmjet një sfide të re për shembjen e objekteve të ngritura në shkelje flagrante të ligjit, të cilët pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të kësaj vepre të madhe infrastrukturore.

8. Realizimi i projekteve kombëtare:

Në vijim të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregdetit perëndimor të Liqenit të Shkodrës”.

Kemi realizuar prishjen e 10 objekteve me vendim prishje të dal nga IKMT-ja.

9. Çështje në fushën mbi masat administrative ne rang kombeetaree nee fushën e mjedisit/ujeerave dhe pyjeve

Gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave dhe Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur 148 masa administrative vendime “Dënim me gjobë”.

10. Situata me Zjarret dhe emergjencat

Drejtoria e Inspektimit të pyjeve nuk ka patur kërkesë për mbështetje shtesë në rastet e rënies së zjarreve, duke qenë se dhe kompetencat i kanë patur Bashkitë,

Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit sëbashku me Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka patur raste sporadike nga disa prej Drejtorive Rajonale si më poshtë vijon:

Tabela e zjarreve në të gjithë Republikën e Shqipërisë.

Nr.	Drejtoritë Rajonale	Numri i rasteve	Sipërfaqja e përshkruar/ha	Sipërfaqja e djegur/ha	Pronësia	Inspektime/ Subjekte të Inspektuar	Mjete të ndaluara	Bashkëpunime me Policinë e Shtetit	Inspektime në Gjueti	Prokurori	Material drusor i Sekuestruar (raste)
			Pyje	Kullota	Pyje						-
1	Tiranë		61			34	34	1	-		-
2	Kukës	26	565,99		565,99	21	0	21	32		-
3	Berat	-	-	-	-	-			-		-
4	Dibër	9	876.1			78	-	17	-	-	2
5	Durrës	-	-	-	-	-	-	27	15	2	2
6	Elbasan	-	-	-	-	164		1	47		-
7	Shkodër		3640	-	79	85	-	-	-	-	-
8	Vlorë		745	-		4	-	-	-	-	-
9	Lezhë			-			-	-	-	-	-
10	Fier			-			-	-	-	-	-
11	Korçë	9	2947.18	-	-	-	-	4	-	4	2
12	Gjirokastrë	4	1223	-	-	-	-	-	-	-	-

13. Kallëzime penale

IKMT duhet të garantojë parandalimin e çdo forme ndërtimi pa leje, mbrojtjen e mjedisit nga çdo lloj ndotësi dhe mbrojtjen e pyjeve nga shkelësit e ligjit dhe mbi të gjitha ndëshkim penal të kundërvajtësve. Për periudhën janar - dhjetor 2024 janë dërguar 2 kallëzime penale.

IV. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INFOMACIONIT, KONTROLLIT TË TË DHËNAVE DHE MARREDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Trajtimi i shkresave dhe ankesave të ardhura nga qytetarët përmes portalit në e-Albania është një proces i rëndësishëm që synon të përmirësojë efikasitetin dhe shërbimin ndaj publikut. Qëllimi

kryesor i këtij procesi është të inkurajojë qytetarët të përdorin platformën online për të shmangur radhët e gjata në sportelet fizike dhe për të siguruar një eksperiencë më të lehtë dhe më të shpejtë në lidhje me shërbimet qeveritare.

Në kuadër të këtij procesi, një ekip i specializuar është i përgjegjshëm për monitorimin dhe përpunimin e shkresave dhe ankesave të pranuar. Kjo përfshin verifikimin e identitetit të personit që ka bërë shkresën dhe vlerësimin e përmbajtjes së saj për të siguruar një trajtim të saktë dhe efikas.

Përmes këtyre veprimeve dhe praktikave, qëllimi është të krijojë një mjet efikas dhe të lehtë për komunikimin midis qytetarëve dhe institucioneve, duke thelluar besimin në përdorimin e platformës online për të kryer shërbimet qeveritare.

2. Mbledhja e të gjithë informacionit periodik nga drejtoritë qendrore dhe rajonale, i cili është më pas analizuar për të identifikuar problematikat dhe për të përmirësuar performancën e institucionit tonë.

Sigurimi i një komunikimi të vazhdueshëm me drejtoritë qendrore dhe rajonale është gjithashtu kritik për të monitoruar zhvillimet aktuale, duke ndërtuar një mjet efikas për shkëmbim të informacionit dhe për bashkëpunim.

3. Realizimi i digjitalizimit të ndërveprimeve midis institucioneve përmes Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), duke përdorur Sistemin e Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik (SQDNE) , paraqet një përparim të rëndësishëm në modernizimin dhe efikasitetin e proceseve administrative.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

1. Përmbledhja dhe analiza e Informacionit dhe përpunimi i tij për të evidentuar problematika e punës në mënyrë për rritjen e performancës së Drejtorisë dhe të gjithë institucionit;
2. Ringritje e bashkëpunimit ndërinstytucional të Inspektoratit Kombëtarë të Mbrojtjes së Territorit me institucionet e tjera për mbarvajtjen e punës;
3. Prioriteti për sektorin e medias për vitin 2024 ka qenë publikimi i të gjitha zhvillimeve për Projektin e Unazës së Madhe dhe "Bregdeti Ynë";
4. Gjithashtu, një prioritet ka qenë krijimi i faqes web dhe mirëmbajtja e tij në bashkëpunim me Aksh-in, si dhe publikimet në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram;
5. Implentimi i sistemeve satelitore në bashkëpunim me ASIG në mbështetje të procesit punës së IKMT-së;
6. Kalendari vjetor i aktiviteteve të IKMT-së.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të shërbimeve online gjatë vitit 2024 janë si më poshtë vijon:

- Njëpërmjet portalit e-Albania kanë ardhur 442 kërkesë/ankesa të cilat janë trajtuar dhe janë ngarkuar në sistemin SQDNE;
- Njëpërmjet portalit e-Albania –Shërbime online kanë ardhur 304 të cilat janë trajtuar dhe janë ngarkuar në sistemin SQDNE;
- Numrit të telefonatave kemi një numër prej tetëdhjetë (1000) telefonatave nga qytetarë të ndryshëm që denoncojnë kryesisht raste për ndërtime pa leje dhe ndotje mjedisore nga kompanitë private abuzuese;
- Nga Komisioneri për të drejtën e Informimit kanë ardhur 30 kërkesa për informacion;
- Për këtë vit janë kryer 368 publikime në rrjetet sociale për aksionet e ndërmarra në IKMT;
- Kryesisht për projekte të Unazës së Madhe dhe në Bregdet janë kryer 20 publikime.

Risitë e vitit 2024:

1. Krijimi i faqes web dhe mirëmbajtja e tij në bashkëpunim me Aksh-in, si dhe publikimet në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram.
2. Identifikimi i problematikave dhe sfidave nga Drejtoria e Informacionit mbi raportimet javore /mujore nga Drejtoritë Rajonale dhe Qendrore.
3. Ringritje e bashkëpunimit ndërinstytucional të Inspektoratit Kombëtarë të Mbrojtjes së Territorit me institucionet e tjera për mbarvajtjen e punës.
4. Në pritje të implementimit dhe zbatimit të marrëveshjes me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Brendshme për marrjen e shërbimit të dronëve.
5. Implentimi i sistemeve satelitore në bashkëpunim me ASIG në mbështetje të procesit punës se IKMT-së.

Mangësi dhe problematika 2024:

1. Raportimi javor/mujor i informacionit jo në kohën e duhur nga Drejtoritë Rajonale dhe Qendrore;
2. Mungesa e postproduksionit për materialet foto/video të hedhura në platformë;
3. Mungesa e aparateve për fotot dhe video për aksionet e kryera nga IKMT-ja në terren;
4. Moskoordinimi nga drejtoritë përkatëse mbi kthim përgjigjet e kërkes/ankesave të ardhura nga qytetarët/gazetarët.

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria (emri i drejtorisë) përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektorit të Marrëdhënieve me publikun dhe Median
2. Sektori i Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave

Sektori i Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave:

Sektori i Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Fokusi i sektorit të Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave në analizat periodike të punës dhe evidentimin e problematikave që pengojnë kryerjen e detyrave është një qasje e menaxhimit që mund të sjellë vlerë shtesë për institucionin. Disa hapa dhe praktika që mund të ndiqen në këtë drejtim përfshijnë:

- 1. Analizat Periodike të Performancës:** Përmes analizave periodike të performancës, sektori i informacionit mund të vlerësojë se sa efektive janë operacionet dhe proceset e IKMT. Kjo përfshin vlerësimin e ndjeshmërisë ndaj objektivave, përdorimin e resurseve, dhe identifikimin e rezultateve kyçe.
- 2. Identifikimi i Kufizimeve dhe Problematicave:** Përmes analizave të thelluara, mund të identifikohen kufizimet dhe problematikat që ndikojnë në kryerjen e detyrave. Kjo mund të përfshijë vonesa, mungesë të koordinimit, ose nevojën për përmirësime në teknologji dhe infrastrukturë.
- 3. Raportimi i Rregullt dhe Transparent:** Evidentimi dhe raportimi i rezultateve të analizave periodike duhet të bëhet në një mënyrë të rregullt dhe transparente. Kjo mund të përfshijë hartimin e raporteve të rendit të ditës, të javës, ose të muajit për të ndarë me ekipin dhe drejtuesit e lartë.

4.Përmirësimi i Proceseve: Bazuar në rezultatet e analizave, sektori i informacionit mund të propozojë përmirësime konkrete në proceset dhe procedurat ekzistuese. Kjo mund të ndihmojë në minimizimin e problematikave dhe në rritjen e efikasitetit.

5.Komunikimi dhe Bashkëpunimi i Përditësuar: Sigurohemi që ekipi i informacionit komunikon dhe bashkëpunon me departamentet e tjera për të adresuar problematikën dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta. Kjo do të ndihmojë në krijimin e një kulture të bashkëpunimit brenda dhe jashtë institucionit.

Përmes përqendrimit në analizat periodike të punës dhe evidentimin e problematikave, sektori i informacionit ka mundësinë të bëjë ndryshime të nevojshme për operacionet në përmirësimin e kryerjes së detyrave në IKMT.

Treguesit kryesor të Sektorit të Informacionit dhe Kontrollit të të Dhënave gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

- 1.Plani Veprimit për Jetësimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Brendshme 2022-2024 dhe IKMT-së;
- 2.Plani i veprimit për sigurinë në komunitet për vitin 2021-2023 të Strategjisë së Sigurisë në Komunitet 2021-2026;
- 3.Monitorimi i zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2023-2025 të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025;
- 4.Indikatorët Matës të Performancës në punë të Drejtorive të IKMT-së;
- 5.Raportimet javore të DRIKMT-ve dhe Drejtorive Qendrore të IKMT-së;
- 6.Raportimet mujore të DRIKMT-ve dhe Drejtorive Qendrore të IKMT-së;
- 7.Raportim javor/mujor në Ministrinë e Brendshme;
- 8.Analizë e raporteve të punës për Drejtorinë e Informacionit;
- 9.Trajnime në fushën e mjedisit Kapitulli 27 nga OSCE;
10. Trajnimet për Drejtoritë rajonale/qendrore në metodologjinë e raportimit.

Sektori Marrëdhënieve me Publikun

Për periudhën janar-dhjetor 2024, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun ka vendosur një përqendrim kryesor në përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve, duke vënë theks në transparencën e proceseve të shërbimit online. Disa nga drejtimit kryesorë të veprimtarisë janë:

- 1.Përmirësimi i Portaleve dhe Platformave Online:** Sektori ka investuar në përmirësimin e portalit dhe platformave online për të bërë shërbimin ndaj qytetarëve sa më të qasshëm dhe transparent.
- 2.Përdorimi i Nënshkrimit Elektronik dhe Verifikimi i Identitetit:** Sektori ka implementuar nënshkrimin elektronik dhe mekanizma për verifikimin e identitetit për të siguruar sigurinë dhe besueshmërinë e shërbimeve online. Ky hap ka për qëllim rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve.
- 3.Krijimi i Rrjeteve Të Reja të Komunikimit:** Sektori ka ndërtuar rrjete të reja të komunikimit për të njoftuar dhe informuar qytetarët rreth ndryshimeve në shërbimet online. Përmes rrjeteve sociale dhe postimeve informative, ka ndihmuar në sensibilizimin e publikut dhe në adresimin e pyetjeve të tyre.
- 4.Hartimi i Udhëzimeve dhe Materialeve Edukative nëpërmjet rrjeteve sociale:** Sektori ka krijuar udhëzime dhe materiale edukative për të ndihmuar qytetarët në përdorimin e shërbimeve online. Kjo ka për qëllim rritjen e kuptueshmërisë dhe vetëshërbimit të qytetarëve në këtë kontekst.
- 5.Monitorimi i “Fëdback-ut” dhe Përmirësimi i Shërbimeve:** Sektori ka implementuar mekanizma për të marrë fëdback dhe vlerësime nga qytetarët rreth shërbimeve online nëpërmjet email zyrtar të institucionit. Bazuar në këto vlerësime, kanë ndërmarrë veprime për përmirësim dhe për të përshtatur shërbimet sipas nevojave reale të përdoruesve.

6. Raportimi Transparent i Performancës: Ka bërë përpjekje për të raportuar në mënyrë transparente mbi performancën dhe efikasitetin e shërbimeve online. Kjo përfshin përdorimin e raporteve periodike dhe platformave të hapura për të ndarë informacionin me qytetarët dhe palët e interesuara.

Këto hapa kanë për qëllim të rrisin përdorimin e shërbimeve online nga ana e qytetarëve, duke e bërë procesin sa më transparent dhe të përshtatshëm për nevojat e tyre. Transparenca dhe përdorueshmëria janë në qendër të përpjekjeve për të ofruar një përvojë sa më pozitive për qytetarët në shërbimet online.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

Për të përmirësuar efikasitetin në terren dhe ambientin e zyrës duke përqendruar vëmendjen në fushën e teknologjisë së informacionit, mund të zbatohen disa hapa dhe strategji për të siguruar një përdorim sa më të mirë të resurseve dhe për të arritur sukses në kryerjen e detyrave. Disa nga këto hapa mund të jenë:

1. **Zhvillimi i Aplikacioneve të Përshtatshme:** Krijimi i aplikacioneve të dedikuara për shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit në terren dhe në zyrë mund të ndihmojë në lehtësimin e përpunimit të informacionit, monitorimit të detyrave dhe ndjekjes së progresit. Aplikacionet mobile mund të përdoren për regjistrimin e të dhënave, fotografi, dhe për komunikim të shpejtë.
2. **Sistemet e Përpunimit të të Dhënave (Data Processing Systems):** Nëse ka një fluks të madh të të dhënave, përdorimi i sistemeve të përpunimit të të dhënave mund të ndihmojë në analizën dhe interpretimin efikas të informacionit. Këto sisteme mund të ndihmojnë në identifikimin e modeleve dhe trendeve që mund të përmirësojnë strategjitë dhe vendimet.
3. **Automatizimi i Detyrave Rutinore:** Identifikimi dhe automatizimi i detyrave rutinore përmes teknologjisë së informacionit, si p.sh. proceset e raportimit ose monitorimi, mund të çlirojnë kohë për të personelin dhe të ulë barrën e punës manuale.
4. **Siguria e të Dhënave:** Me përdorimin e teknologjisë së informacionit vjen një përgjegjësi e shtuar për sigurinë e të dhënave. Ndërton një strategji të sigurisë që përfshin mbrojtjen e informacionit në terren dhe në zyrë për të parandaluar rreziqe potenciale të sigurisë.
5. **Trajnimit të Personelit:** Të sigurohemi që personeli të ketë njohuri të mjaftueshme dhe aftësi për të përdorur teknologjinë e informacionit. Trajnimet dhe mbështetja e vazhdueshme mund të ndihmojnë në sigurimin që të gjithë ndjehen kompetent në përdorimin e teknologjisë.
6. **Monitorimi dhe Vlerësimi i Performancës:** Përdorimi i teknologjisë për të monitoruar dhe vlerësuar performancën e punonjësve dhe proceseve mund të ndihmojë në identifikimin e fushave që kanë nevojë për përmirësim dhe zhvillim shtesë.
7. **Sisteme të reja të logjistikës, mjete të reja të teknologjisë së informacionit.** Me këto masa të ndërmarra, institucioni juaj ka mundësinë të përmirësojë përdorimin e teknologjisë së informacionit për të rritur efikasitetin, lehtësuar punën në terren dhe në zyrë, dhe për të arritur më shumë sukses në kryerjen e detyrave.
8. **Në vitin 2025 po angazhohemi për implementimin e dhe zbatimin e platformës “Open Data”:** Publikimin e raporteve, statistikave, vendimeve dhe dokumentave të tjera duke përmirësuar transparencën dhe aksesin publik në zbatim të ligjit 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
9. **Përdorimi i imazheve satelitore nga ASIG:** Në kuadër të monitorimeve në distancë.
10. **Ndërveprimi intensiv me median:** Në kuadër të transparencës të veprimtarisë së IKMT-së.
11. **Përmbushja e objektivave sipas Planit të Punës.**

V. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë realizuar detyrat institucionale për:

1. Planifikimi dhe menaxhimi me efektivitet i burimeve financiare në funksion të realizimit me sukses të objektivave të IKMT- së të reflektuara në buxhet;
2. Ndjekja e proceseve të punësimit, menaxhimit dhe ngritjen profesionale të burimeve njerëzore për institucionin në qendër dhe drejtoritë rajonale;
3. Mbajtja në gadishmëri dhe përmirsimi (pajisja me aktive të reja) e aktiveve materiale të institucionit dhe vendosja e tyre në dispozicion të drejtorive referuar urdhërave ose autorizimeve të punës si dhe kërkesave për materiale;
4. Marrja në dorëzim, protokollimi, arkivimi dhe përpunimi i dokumentacionit hyrës dhe atij institucional sipas dispozitave ligjore.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për përmbushjen e detyrave të sipërcituara:

- Menaxhimi i burimeve financiare dhe materiale me efektivitet dhe efikasitet nga të gjitha strukturat si dhe planifikimi i kërkesave buxhetore gjithëpërfshirëse, mbështetur në nevojat reale të drejtorive në qendër dhe rajone;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore të drejtorisë, evidentimi dhe ndjekja e nevojave të institucionit për burime njerëzore, lidhjen e kontratave individuale të punës dhe procedimi i marrëdhënieve të punës sipas vakancave të organikes, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet juridike administrative të punës;
- Dërgimi brenda afateve për ekzekutim i urdhërave të ardhur nga Drejtoria e Inspektimit Juridik;
- Blerja e pajisjeve informatike dhe pajisjeve speciale;
- Sistemit i arkivës ekzistuese në vite dhe përgatitja e dokumentacionit arkivor për dorëzimin e tyre në arkivën e sistemit;
- Ndjekja me prioritet e rekomandimeve të lënë nga auditet.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Realizimi i buxhetit të miratuar për vitin 2024;
2. Likuidimi i detyrimeve të marrëdhënieve kontraktuale dhe të prapambetura;
3. Lidhjen e kontratave individuale të punës ndjekja e nevojave të institucionit me burime njerëzore;
4. Urdhëra ekzekutimi në ekzekutim
5. Evidentimi dhe plotësimi i nevojave për bazë materiale i drejtorive në qendër dhe rajone;
6. Arkivimi i dokumentacionit në vite/dosje të arkivuara.

Risite e vitit 2024:

- Krijimi i Komisionit Disiplinor mbi shqyrtimet e shkeljeve të propozuara për punonjesis;
- Blerja e pajisjeve informatike të reja për administratën;
- Akomodimi i Drejtorisë Rajonale të IKMT Tiranë në ambiente të përshtatshme pune.

Prioritetet:

1. Ngritja profesionale e punonjësve nëpërmjet trajnimeve;
2. Përmirësimi i logjistikës blerja e mjeteve te reja;
3. Përpunimi dhe dorzimi i dokumentave të arkivuara në vite të cilat janë RHK në arkiven e sistemit;
4. Ndjekja me prioritet i rekomandimeve të lënë nga auditet.

Mangësi dhe problematika gjatë vitit 2024:

- Fonde të pamjaftueshme për likuidimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura dhe të krijuara gjatë vitit buxhetor;
- Mungesa e mjeteve të transportit për të gjitha strukturat për realizimin e objektivave e cila ka ardhur nga mungesa e fondeve për investime;
- Mungesa e kushteve dhe ambjenteve në qendër dhe disa Drejtori Rajonale;
- Fondit arkivor i krijuar ndër vite.

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Financës dhe Buxhetit;
2. Sektori i Burimeve Njerëzore;
3. Sektori i Shërbimeve të Brendshme;
4. Sektori i Arkivës dhe Protokollit.

Sektori i Financës dhe Buxhetit:

Sektori i Financës dhe Buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Ndjekjen e fondeve të planifikuara, miratuara, realizuara gjatë vitit 2024 dhe i pritshmi për tu realizuar deri më 27.01.2025 e cila paraqitet në tabelën më poshtë:

Situacioni shpenzimeve Viti 2024									
Artikujt	Emërtimi	Njësia Shpenzuese IKMT	Shtim fond i vecante, Shkresa nr. 1906 Date_01.03. 2024	Shtim fond Viti 2024 Shkresa MB5597/8117 /3date 19/08/2024 Shkresa MB9759/5 6015 date 19/09/2024 Shkresa MB10662/2/ 6461 date 18/10/2024 Shkresa MB12009/2 6767 date 15.11.2024 Shkresa MB12376/3 & 6980 date 06.12.2024	Pakësim fondi Viti 2024 Shkresa MB9759/5 6015 date 19/09/2024 Shkresa MB10662/2/ 6461 date 18/10/2024 Shkresa MB12376/3 & 6980 date 06.12.2024	Njësia Shpenzuese IKMT	Realizimi Vjetor 2024	Diferenca për tu realizuar deri me 26.01.2025	Fondi i përdorur
		Detajim Viti 2024 Nr.18408/1 dt 20.12.23 investimet nr.18408/39 dt.21.02.24							
6000000	Paga, shpërblime dhe t	475,484,000	-	29,785,000	36,000,000	469,269,000	465,519,902	-	3,749,098
6010000	Kontribute për Sig Shogë	80,382,000	-	5,971,900	8,100,000	78,253,900	77,602,637	-	651,263
6020000	Mallra dhe shërbime të tj	50,000,000	-	126,230,000	-	176,230,000	99,846,294	76,353,373	30,333
6040000	Transferta korrente të brendshme					-	-	-	-
6050000	Transferta korrente jashtë vendit					-	-	-	-
6060000	Transferta për Buxhete Familjare dhe Indi		1,000,000	15,000		1,015,000	1,007,525	-	7,475
231	Shpenz. për rritjen e akt	9,088,000			3,800,000	5,288,000	2,571,360	-	2,716,640
Totali		614,954,000	1,000,000	162,001,900	47,900,000	730,055,900	646,547,718	76,353,373	7,154,809

Referuar të dhënave në tabelën e mësipërme situata e realizimit të buxhetit paraqitet si më poshtë:

- Për artikullin 600 është miratuar fondi prej 475,484,000 lekë, i cili pësoi rritje në vlerën 29,785,000 lekë si rezultat i efektit të rritjes së pagave sipas VKM-ve 421 dhe 422, aktualisht fondi për pagat

e punonjesve i rishikuar për vitin 2024 ka qenë 469,269,000 lekë realizimi i të cilit është 465,519,902 lekë në përqindje 99.2%.

- Për artikullin 601 është miratuar fondi prej 80,382,000 lekë, i cili pas rishikimeve rezulton të jetë 78,253,000 lekë realizimi i të cilit është 77,602,637 lekë dhe në përqindje 99.1%.
- Për artikullin 602-606 është miratuar fondi prej 51,000,000 lekë, i cili pësoi rritje në vlerën 126,245,000 lekë si rezultat i kërkesave për fonde shtesë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vendimet e gjykatës së formës së prerë si dhe për fondi i vecantë ndihmë ekonomike, realizimi i të cilit duke përfshirë dhe fondet e pritshme për tu realizuar (nga shtesa e fondit nga Akti Normativ nr.05, pritet të jetë 100%.
- Për artikullin 602 në shpërndarjen e fondeve prioritet i është dhënë blerjes së karburantit, mirëmbajtjes së mjeteve dhe shpenzimeve të punonjësve për udhëtim të brendshëm, të cilët kanë një tregues kyç që ndikojnë drejtpërdrejtë në realizimin e misionit të institucionit duke pasur parasysh natyrën inspektuese të tij.
- Gjithashtu në këtë zë një peshë të madhe zënë dhe detyrimet e prapambetura nga vitet e kaluara të cilat rrjedhin nga vendimet e gjykatave të formës së prerë dhe për mungesë fondesh nuk likuidohen brenda vitit, për të cilat janë bërë kërkesa të vazhdueshme për fonde dhe janë të përfshira në kërkesat buxhetore shtesë në PBA-të e çdo viti, por në detajimin e fondeve të miratuar nuk janë parashikuar si rezultat i pamjaftueshmërisë së këtyre fondeve.
- Për artikullin 231 investime të brendshme për vitin 2024 IKMT ka fonde të miratua për blerjen e pajisjeve informatike dhe pajisjeve speciale, në vlerën 9,088,000 lekë konkretisht:
- Blerje pajisje informatike plan 6,428,000 lekë dhe fakti 2,571,000 lekë blerje e realizuar nga AKSHI.
- Blerje pajisje speciale plan 2,660,000 lekë fond i parealizuar nga QBP pas publikimit të dy procedurave të prokurimit.

Në total realizimi i buxhetit pritet të jetë 98.5%.

Për realizimin e fondeve të miratuara Sektori i Financës dhe Buxhetit ka kryer të gjitha proceset e tij të punës si:

- Situacioni i shpenzimeve dhe të ardhurave mujore/vjetore 2024;
- Regjistri i pagave viti 2024;
- Llogaritja dhe pagesa e Udhëtimeve të brendshme/jashtme të punonjësve 2024;
- Regjistri i lëvizjes së aktiveve viti 2024;
- Ndjekja e faturave të furnitorëve në sistemin e fiskalizimit dhe përpilimi i urdhrave të shpenzimit dhe ngarkimi i tyre programin e pagesave online AFMIS;
- Regjistri i debitorëve dhe kreditorëve të mbartura ndër vite dhe të krijuara gjatë vitit 2024;
- Regjistrimi i të gjitha lëvizjeve të mësipërme në programin financiar Alpha Ëeb dhe pasqyrimi i tyre në Librin e Madh të kontabilitetit;
- Kontrolli dhe konfirmimi i të gjithë regjistrimeve nga përgjegjësi i sektorit.

Gjatë vitit 2024 janë dërguar pranë sektorit të financës për marjen në pasqyrat financiare akte administrative (vendim dënim me gjobë) nga strukturat inspektuese, janë krijuar kreditorë të rinj të ardhur nga vendimet e gjykatave të formës së prerë dhe janë krijuar të ardhura nga likuidimet e gjobave të vendsura ndër të cilat paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Numër debitorë/kreditorë	Vlera në lekë debitorë/kreditorë
1	Debitorë të krijuar në vitin 2024	447	1,211,864,269
2	Gjopa likuiduara gjatë viti 2024	174	107,759,748
3	Kreditorë të krijuar gjatë viti 2024(nga vendime gjykate	10	85,861,487

	dëmshpërblime dhe lirime nga puna)		
--	------------------------------------	--	--

Për të gjitha veprimet e mësipërme është bërë edhe regjistrimi i tyre në Programin Financiar Alpha Eëb dhe rakordimi i llogarive vjetore për ti pasqyruar të gjitha këto veprime me vërtetësi në pasqyrat financiare vjetore për vitin 2024 punë e cila do të vijohet deri në 31.03.2025.

Për mbylljen e të gjitha veprimeve financiare dhe raportin përfundimtar të realizimit të buxhetit Sektori i financës po vazhdon punën për mbylljen e fondeve buxhetore të vitit 2024 të akorduara me Aktin normativ Nr. 05, dhjetor 2024 dhe në zbatim të Udhëzimit nr.13, datë 18.12.2024 “Për mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të viti 2024”.

Sektori Burimeve Njerëzore:

Sektori i Burimeve Njerëzore për periudhën Janar – Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

- 1.Lidhja e Kontratave të punës të reja dhe procedimi i marrëdhënieve të punës për vitin 2024;
- 2.Mbikqyrja e respektimit të orarit zyrtar të punonjësve në punë;
- 3.Krijimi dhe plotësimi i dosjeve të personelit;
- 4.Plotësimi regjistrat Themeltar të punonjësve (fizikisht dhe elektronikisht);
- 5.Përditësimi i Grafikut të Planifikimit dhe Miratimit të Pushimeve Vjetore për të gjithë strukturën e IKMT;
- 6.Përpilimi i Listprezencës ditore dhe mujore ne referim te prezencave te departamenteve dhe kontrollit te sektorit mbi prezencen ne pune;
- 7.Përditësimi i sistemit HRMIS (regjistri qendror i personelit);
- 8.Bashkëpunimi me Institucionet e tjera mbi informacione të ndryshme;
- 9.Marrja e masave për njohjen dhe zbatimin e normave të përgjithshme në punë mbi disiplinën, kodin e etikës etj;
- 10.Përditësimi i Rregjistrat të trajnimeve për të gjithë punonjësit.

Menaxhimi i burimeve njerëzore:

Gjatë vitit 2024, për Menaxhimin e Personelit janë hartuar gjithsej 448 praktika, nga të cilat:

- 1.Emërime total 118;
- 2.Transferime total 142;
- 3.Lirime/ Largime total 78;
 - Dorëheqje 51;
 - Dalje në pension 4;
 - Shkelje kontratës individuale, mosparaqitje në punë, mospërmbyllje të detyrave ;
 - Funksionale, shkelje të rënda 18;
- 4.Rikthim në detyrë total 2;
- 5.Pezullime total 1;
- 6.Komandime total 35;
- 7.Masa disiplinore total 72;
- 8.Emërime me kontratë të përkohëshme 118;
9. Lirime/ Largime me kontratë të përkohëshme total 4;
10. Trajnime total 8 nga Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektimit Pyjor në Drejtorinë Rajonale Vlorë, Drejtorinë Rajonale Fier dhe Drejtorinë Rajonale Gjirokastër.

Sektori i Shërbimeve të Brendshme:

Sektori i Shërbimeve të Brendshme ka përqëndruar punën e tij bazuar në objektivat IKMT-së për vitin 2024 në këto drejtime:

1. Planifikimin e nevojave për shërbime dhe materiale si dhe ndjekjen e të gjitha kërkesave për bazë materiale për strukturat në qender dhe rajone;
2. Mbajtja në gadishmëri e flotës së mjeteve të transportit dhe të mjeteve prishëse dhe vendosja e tyre në dispozicion të drejtorive në bazë të urdhërave të punës ose autorizimeve, si dhe monitorimi i furnizimit të tyre me karburant;
3. Vendosje për ekzekutim i urdhrave të ekzekutimit të ardhur nga Drejtoria e Inspektimit juridik;
4. Ndjekja e kërkesave të ardhura nga zyrat përmbartimore në lidhje me detyrimeve të IKMT ndaj të tretëve.

Flota e mjeteve në inventar të IKMT përbehet nga 67 mjete nga të cilat:

- 25 mjete janë vlerësuar për jashtë përdorimit ;
- 42 mjete të cilat aktualisht punojnë, por janë të amortizuara nga përdorimi i gjatë në vite (nga viti 1991);
- 10 mjete të marra me qera nga AAPSK të cilat sollën dhe plotësimin e pjesshëm të nevojave për mjete transporti;

Për vitin 2024 është bërë furnizimi i mjeteve të punës dhe transportit në mbështetje të urdhrave të punës sipas drejtorive në qendër dhe rajone.

Sektori i Shërbimeve të Brendshme gjatë vitit 2024, ka përgatitur kërkesat për prokurime, të cilat janë realizuar nga Komisioni i Prokurimit Publik me vlerë të vogël dhe blerja e karburantit i realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruar.

Në vitin 2024 sektori i Shërbimeve Mbështetëse ka përqendruar punën e tij për vendosjen në ekzekutim të Urdhrave të Ekzekutimit të përcjella nga Drejtoria Juridike për 249 gjopa të vendosura nga trupat e inspektimit në Territor, Mjedis, dhe Pyjeve të cilat i përkasin akteve administrative të viteve si më poshtë:

- Janë vendosur 3 gjopa të vitit 2016 (të cilat kanë qënë në proces gjyqësor);
- Janë vendosur 1 gjobë të vitit 2017;
- Janë vendosur 54 gjopa të vitit 2022;
- Janë vendosur 126 gjopa të vitit 2023;
- Janë vendosur 65 gjopa të vitit 2024.

Këto gjopa janë vendosur në zyra të ndryshme përmbartimore dhe janë administruar dhe ndjekur rast pas rasti me përmbartuesit përkatës duke u hedhur në regjistrat e krijuar nga ana jonë dhe përditësimin e tyre për çdo veprim që zyrat përmbartimore kanë kryer.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Përmirësimi i logjistikës me mjete transporti si rezultat i fondeve të miratuar për investime të brendshme;
2. Përfundimi dhe publikimi i përshkrimeve të vendeve të punës;
3. Sistemit dhe dorëzimi i fondit arkivor i krijuar në vite.

VI. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INSPEKTIMIT TË MJEDISIT DHE UJËRAVE

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

Nga ana e DIMU, është operuar në përputhje me plane pune vjetore dhe mujore, si dhe janë realizuar inspektime online për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarive të lidhura me fushën e mjedisit dhe ujërave. Këto plane dhe inspektime kanë shërbyer për organizimin dhe zbatimin e detyrave në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektivat strategjike të institucionit.

Sa i takon vitit 2024, nga ana e DIMU janë ushtruar gjithsej 249 inspektime online, duke përfshirë si inspektimet e planifikuara ashtu edhe ato të paplanifikuara, të cilat janë realizuar mbi bazën e ankesave, informacioneve dhe kërkesave të tjera. Këto inspektime kanë synuar mbikëqyrjen dhe trajtimin e çështjeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet e përcaktuara.

Nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave (DIMU) gjatë vitit 2024 është vënë një fokus i veçantë në monitorimin dhe inspektimin e subjekteve që ushtronin aktivitet në disa fusha kryesore, përfshirë:

- Subjektet që operojnë në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, veçanërisht hidrocentrale (HEC), duke siguruar respektimin e Kuotës Ekologjike (Q-ekologjike) dhe shfrytëzimin e burimeve ujore vetëm mbi bazën e lejeve të vlefshme të lëshuara nga institucionet kompetente;
- Subjektet që veprojnë në fushën e shfrytëzimit të gurit gëlqeror dhe gurëve dekorativë, duke përfshirë karrierat në qiell të hapur dhe minierat nëntokësore;
- Veprimtaritë prodhuese, përfshirë fabrikat e përpunimit të metaleve me ngjyrë dhe mineraleve;
- Subjektet dhe veprimtaritë që shfrytëzojnë materiale inerte nga shtretërit e lumenjve, qofshin ata me ujë apo të thatë;
- Monitorimin dhe zbatimin e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 16.02.2024, për evidentimin, ndalimin e krijimit dhe mbylljen e vendgrumbullimeve të mjeteve motorike, rimorkiove dhe pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit, në një distancë jo më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Këto inspektime kanë synuar të sigurojnë zbatimin e standardeve ligjore dhe mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mjedisit.

Në kuadër të inspektimeve të kryera nga grupet e Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave (DIMU) gjatë vitit 2024, për gjetjet e konstatuara janë ndërmarrë masa sanksionuese, duke vendosur gjoba për subjektet që kanë shkelur dispozitat ligjore.

- Në total janë vendosur 47 (dyzet e shtatë) masa administrative;
- Vlera e përgjithshme e këtyre gjobave arrin në 93.850.000 (nëntëdhjetë e tre milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Këto masa pasqyrojnë angazhimin e DIMU për të garantuar zbatimin e rregulloreve mjedisore dhe administrimin efektiv të burimeve natyrore.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, trupat inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave (DIMU) janë fokusuar në:

- Trajtimin e shkresave dhe ankesave të ardhura në rrugë shkresore apo elektronike, duke siguruar një qasje efikase dhe të drejtë ndaj çështjeve të adresuara;
- Bashkëpunimin me Drejtoritë Rajonale të IKMT-së, duke ofruar suport dhe trajnime për trupat inspektuese, veçanërisht në sektorët e Mjedisit dhe Ujërave.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua zbatimit të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr. 44, datë 16.02.2024, për:

Evidentimin, ndalimin dhe mbylljen e vendgrumbullimeve të mjeteve motorike, rimorkiove dhe pjesëve të këmbimit të dala jashtë përdorimit, të vendosura brenda një distance prej më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave ngriti grupe pune për të gjithë qarqet e Shqipërisë. Rezultatet e veprimtarisë së këtyre grupeve janë përmbledhur dhe do të paraqiten në detaje më poshtë.


Tabela Nr.1. Të dhënat statistikore totale.

Numri Total i Subjekteve të verifikuara nga DIMU	
Nr. total i pikave të identifikuar nga Drejtoritë Rajonale	619
Numri i Inspektimeve nga DIMU	615
Lirimet Vullnetare	349
Masat administrative	41
Sekuestro	3

Tabela Nr.2. Të dhënat sipas Inspektimit në terren nga DIMU

DRIKMT	Berat	Fier	Korçë	Tiranë	Shkodër	Lezhë	Kukës	Dibër	Vlorë	Elbasan	Durrës	Gjirokastrë
Nr. total pikave të identifikuar nga Dr.Rajonale	16	51	86	75	34	59	24	40	14	35	170	15
Numri i Inspektimeve nga DIMU	17	56	90	60 pa përfunduar	42	57	25	43	15	37	160	14
Lirimet Vullnetare	17	37	72	17	12	42	13	19	5	11	96	8
Në Proces	0	16	15	32	24	9	5	22	7	15	56	6
Nuk ka vepruar	0	3	2+1 ¹	11	6	6	7	2	3	11	6+2 ²	0
Masat administrative	3	2	6	4	0	6	5	2	4	2	5	5
Sekuestro	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	1

Grafiku Nr.1. Paraqitja grafi



Nga të dhënat statistikore për inspektimet e kryera nga grupet e punës së Drejtorisë së Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave (DIMU) gjatë vitit 2024, rezulton:

- 56.7% e rasteve kanë përfunduar me lirime vullnetare të vendgrumbullimeve të mjeteve në fund të jetës;
- 33.7% e rasteve janë në proces të evadimit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të dala jashtë përdorimit;
- 9.6% e rasteve ende nuk kanë marrë masa për evadimin e mjeteve në fund të jetës, duke vijuar të mbeten problematike në këtë aspekt.

Këto të dhëna tregojnë përpjekjet e vazhdueshme dhe sfidat e hasura në zbatimin e detyrimeve ligjore për eliminimin e vendgrumbullimeve të kundërligjshme dhe përmirësimin e menaxhimit të mjedisit.

Të dhënat statistikore mbi sekuestrimet e mjeteve gjatë aksioneve të kryera për monitorimin dhe kontrollin e subjekteve që operonin në shfrytëzimin e shtretërve të lumenjve në Qarkun e Lezhës:

Nr. Aksionit	Numri i Mjeteve të Sekuestruara	Lloji i Kundërvajtjes	Shënime
1	3	Operim pa leje për nxjerrjen e materialit inert nga shtretërit e lumenjve	Mjetet sekuestruar në zonën XYZ
2	4	Shfrytëzim i shtretërve të lumenjve jashtë koordinatave të miratuara	Subjektet ishin të pajisura me leje, por e shkelën
3	2	Shfrytëzim mbi volumin e miratuar për nxjerrjen e materialit inert	Shkeljet u konstatuan gjatë patrullimit

Përmbledhje:

- Totali i mjeteve të sekuestruara: 9;
- Fushat kryesore të shkeljeve: mungesa e lejeve, shkelje të koordinatave, dhe tejkalim i volumit të miratuar për shfrytëzim;
- Rezultatet: Subjektet janë sanksionuar dhe mjetet janë sekuestruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këto aksione përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kontrollit mbi shfrytëzimin e burimeve ujore dhe mbrojtjes së mjedisit në zonat e rrezikuara.

VII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË TË INSPEKTIMIT TË PYJEVE

Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, pranë IKMT-së, përgjatë vitit 2024, ka pasur si objektiv kryesor:

1. Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve është institucioni qendror shtetëror përgjegjës në varësi të Ministrisë së Brendshme për kontrollin, mbrojtjen dhe sigurinë e fondit pyjor kullor, Zonat e Mbrojtura, florën e faunën e egër, biodiversitetin, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera;
2. Kontrollin, mbrojtjen e territorit dhe e peisazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e pyjeve;
3. Kontribuimi në hartimin e planeve të veprimit për mbrojtjen e pyjeve, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm duke drejtuar kryerjen e inspektimit, verifikimit dhe duke nxitur e bashkërenduar

veprimtaritë, të cilat çojnë në përmirësimin e zbatimit të ligjit në fusha përkatëse të veprimit që mbulon Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve;

4. Rritja e parametrave të parandalimit të paligjshmerisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të kësaj drejtorie, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.

Gjatë kësaj periudhe analizuese, Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, nëpërmjet intensifikimit të punës në të gjitha strukturat e saj, ka bërë të mundur:

1. Zbatimin e ligjshmërisë në fondin pyjor dhe kullor; mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimet, prerjet, zëniet dhe përdorimet e paligjshme; zjarret; mbrojtjen e faunës së egër; zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale e tanifere;
2. Veprimtarinë inspektuese dhe kontrolluese të pandërprerë për mbikëqyrjen e territorit lidhur me fushën e pyjeve dhe parashikimin për të adresuar dhe parandaluar këto rreziqe;
3. Azhurnimin e legjislacionit dhe njohjen me ndryshimet ligjore për trupën inspektuese;
4. Koordinimin efikas dhe të shpejtë me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet e tjera vendore për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe administrative;
5. Vlerësimin e përgjegjësive të sektorëve si dhe inspektorëve;
6. Përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në takime dhe tryeza për vazhdimësinë dhe koordinimin e legjislacionit në fuqi;
7. Hartimin e analizës së riskut;
8. Hartimin e Planit të Masave për Sezonin Turistik, sipas Udhëzimit të Kryeministrit;
9. Hartimin e Modullit për Trajnim, sipas Udhëzimit të Inspektoratit Qendror.

Performanca e IKMT-së:

Gjatë vitit 2024, janë trajtuar:

1. Ankesat e protokolluara pranë institucionit tonë, ato të dërguara nëpërmjet postës elektronike dhe ankesat e adresuara në portalet qeveritare;
2. Shkresat dhe korrespondencat me organet ligjzbatuese, si Prokuroria dhe Gjykata;
3. Shkresat dhe korrespondencat me Kryeministrinë, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
4. Shkresat dhe korrespondencat me Bashkitë dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP);
5. Shkresat dhe korrespondencat me Inspektoratin Qendror (IQ), referuar problematikave që lidhen me mbivendosjen e kompetencave dhe njoftimet që lidhen me sistemin unik “e-inspektimi”.

Veprimtaria e Drejtorisë (Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve)

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Grumbullimin, përpunimin dhe analizën e plotë të të dhënave për të gjitha aktivitetet e kundravajtjeve në pyje, kullota dhe gjueti, në nivel qarku dhe rang kombëtar;
2. Verifikimin e ankesave të ardhura nga qytetarët, të protokolluara pranë institucionit tonë, si dhe të ankesave të dërguara në portalet qeveritare që kanë lidhje me shkeljet në pyje, kullota, gjueti, etj;
3. Ngritjen e postobloqeve fikse dhe të lëvizshme, në zbatim të Udhëzimit Nr. 161, datë 23.06.2020, të Ministrit të Brendshëm, “Për procedurat e veprimit të përbashkët të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit me Policinë e Shtetit”, për kontrollin e transportit të paligjshëm të materialit drusor;

4. Ushtrimin e kontrolleve nga grupet e Inspektimit të Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve dhe 12 Drejtoritë Rajonale, në Fondin Pyjor Kullosor, duke vlerësuar situatën dhe kryer rakordimet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve;
5. Hartimin e një draft-amendimi për Ligjin Nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet në Republikën e Shqipërisë”, për të sqaruar mbivendosjen e kompetencave;
6. Hartimin e Planit të Masave, referuar Urdhërit të Kryeministrit Nr. 20, datë 1.3.2024, për “Ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale të Sezonit Turistik Veror 2024”;
7. Hartimin e programit të masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret, organizimin e takimit me Task-Forcën e Prefekturës dhe përcaktimin e detyrave për koordinimin sa më të mirë të punës në rast zjarri.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për:

- Parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve;
- Parandalimin e zënies dhe përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor dhe kullosor;
- Parandalimin e grumbullimit dhe tregtimit të bimëve medicinale, tanifere dhe eterovajore (MTE);
- Mbrojtjen nga zjarret nëpërmjet videove sensibilizuese;
- Mbrojtjen e faunës së egër nëpërmjet inspektimit online në portalin unik “e-inspektimi”.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve, gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 janë kryer 77 inspektime në terren;
2. Janë sekuestruar materiale drusore, lëndë punimi, si dhe mjete që kanë shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes;
3. Nuk është kryer asnjë inspektim, referuar Udhëzimit Nr.17, datë 20.04.2024, “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e mbrojtjes së pyjeve,” nga Inspektori i Përgjithshëm pranë Inspektoratit Qendror;
4. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë mbajtur dhe administruar dokumentet për të gjitha rastet që janë adresuar për kallëzim penal pranë Prokurorive respektive;

Risite e vitit 2024:

1. Nxjerrja e urdhërave për sekuestron e mjetit që ka shërbyer për kryerjen e kundërvajtjes;
2. Përdorimi i e-mailit zyrtar për çdo punonjës, duke ndikuar me njohjen me shpejt të informacionit;
3. Rritje të numrit të inspektimeve në rang kombëtar;
4. Hartimi i planit të integritetit dhe planin e veprimit, i cili është një dokument mjaft i rëndësishëm që ka të bëjë me mbarëvajtjen e veprimtarisë, efikasitetin dhe realizimin e objektivave të paracaktuara nga ky institucion. Ky plan krijon një sistem të mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit institucional, detajon hapa të rëndësishëm në fushën e integritetit, etikës, transparencës dhe paanësisë së institucionit;
5. Rritje të veprimtarisë inspektuese dhe kontrolluese e pandërprerë për mbikëqyrjen e territorit lidhur me fushën e pyjeve me patrullime ditën dhe natën, për konstatim dhe parandalim të paligjshmërisë;

Prioritetet:

1. Përgatitja e udhëzimeve e rregullave për standartizimin e inspektimit të fondit pyjor, kullosor në funksion të parandalimit të prerjeve ilegale të pyjeve, zënies e përdorimit të paligjshëm të fondit

- pyjor e kullor si dhe mbrojtjes së faunës së egër. Përgatitja e udhëzimit për analizën e riskut dhe marrja e masave për adresimin e problemeve sipas rëndësisë dhe shkallës së dëmtimeve;
2. Përgatitja e udhëzimeve për përmirësimin e ekzekutimit të gjobave dhe ndjekjes së vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtjet nga strukturat që administrojnë pyjet. Kontrolli i strukturave të administrimit të pyjeve për hartimin e planit vjetor të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota dhe ndjekja e zbatimit të tij;
 3. Inspektimi i zbatimit të legjislacionit rregullator për pyjet në administrim të Bashkive, AKZM – ve si dhe atyre privatë. Inspektim i subjekteve të shfrytëzimit të pyjeve për ndalimin e ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit në fondin pyjor dhe disiplinimi i këtij aktiviteti (ushtrimi i inspektimeve periodike në drejtoritë rajonale të IKMT, sipas ngastrave të shfrytëzimit të kontraktuara me Bashkitë);
 4. Inspektim në subjektet që grumbullojnë, përpunojnë produktet pyjore, bimët mjekësore etero-vajore. Inspektime në rrugët auto-pyjore, nacionale për evidentimin e transportit të paligjshëm të materialeve drusorë dhe atyre me origjinë në fondin pyjor dhe kullor;
 5. Krijimi i regjistrit kombëtar të gjobave/shkeljeve për kundërvajtjet në pyje, kullota e gjueti dhe rifreskimi i tij në vazhdimësi. Krijimi i regjistrit kombëtar të zënieve të paligjshme të fondit pyjor dhe kullor dhe ndjekja e praktikave shkresore e ndërhyrjeve në terren për çlirimin dhe prishjen e ndërtimeve;
 6. Organizimi i trajnimeve me personelin e Inspektorët e Sektorit Pyjorë, pranë IKMT-ve rajonale, për zbatimin e legjislacionit rregullator për mbrojtjen e pyjeve, kullotave dhe faunës së egër e gjuetisë, Ligjin e Inspektimit etj. Organizimi i një udhëtimi studimor në një nga vendet e rajonit dhe të BE me ngjashmëri të strukturave të inspektimit në fushën e pyjeve e faunës së egër dhe mbrojtjen nga zjarret. Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me shtetet fqinje për reformën institucionale në veçanti për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret. Pjesëmarrja në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare me objekt inspektimin dhe bashkëpunimin në fushën e inspektimit;
 7. Përmirësimin e ekzekutimit të gjobave dhe ndjekjes së vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtjet nga strukturat që administrojnë pyjet. Promovimi në media i rezultateve të kontrolleve;
 8. Bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, tatime, doganat dhe policinë e shtetit, për mbrojtjen e pasurive pyjore, në të gjitha nivelet;
 9. Rritja e përgjegjësisë të inspektorëve të sektorëve të Drejtorive Rajonale në DIP, për të informuar në kohë mbi tjetërsimet e fondit pyjor e kullor me qëllim hapjen e tokave të lira.
 10. Pajisja me infrastrukturën e duhur të grupeve të inspektimit si: (armatim, mjete lëvizëse dhe lundruese, karta e inspektorit, uniforma, drone, GPS-së, harta etj);
 11. Inspektim i subjekteve të shfrytëzimit të pyjeve në zbatim të ligjit të moratoriumit për ndalimin e ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor dhe disiplinimi i këtij aktiviteti (ushtrimi i inspektimeve periodike në drejtoritë rajonale të IKMT, sipas ngastrave të shfrytëzimit të kontraktuara me Bashkitë);

Trajnime të ndryshme: Sugjerohet trajnimi i Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve (Qendër), si dhe trajnimi i trupës së inspektorëve në 12 Drejtoritë Rajonale, për Bazën Ligjore mbi të cilën funksionon Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, rasteve konkrete të praktikave të mira, si dhe Udhëzimeve të dala nga IQ.

Mangësi dhe problematika :

1. Mosnjohja e plotë e kuadrit ligjor nga inspektorët, mosqenia ekspert i fushës dhe eksperiencë e kufizuar prej tyre, sjell vështirësi në shqyrtimin dhe verifikimin të ankesave ose inspektimeve të ushtruara në subjekte sipas planeve mujore;
2. Mostrajnim i stafit në lidhje me plotësimin e procedurave në sistemin e inspektimit online (autorizim, listë verifikimi, procesverbal, vendim përfundimtar), rrjedhimisht është hasur vështirësi në plotësimin e dokumentacionit online;

3. Mungesa e mjeteve për kryerjen e inspektimeve në zonat me rëndësi kombëtare dhe urbane e rurale. Duke patur parasysh faktin se ushtrimi i detyrave sidomos në kontrollin në vend të hapësirave të shfrytëzuara të lëndëve drusore në pyje, ndjekja, parandalimi, goditja e aktiviteteve të paligjshme si gjuetia e paligjshme, etj, gjenden në terrene malore, në zona të largëta të cilat janë gati të pakontrollueshme në këmbë për shkak të largësisë dhe terrenit të keq sektoret e inspektimit kanë hasur mjaft vështirësi në përmbushjen e detyrave të ngarkuara dhe evidentimin në kohë të shkeljeve të caktuara;
4. Mungesa e ambienteve të punës sjell vështirësi në menaxhimin e punës;
5. Mungesa e pajisjeve elektronike në institucion për kryerjen me efikasitet dhe brenda afateve kohore të detyrave të ngarkuara;
6. Në shumë raste, mungesë e bashkëpunimit ndërinstitutional me njësitë e qeverisjes vendore, në rastet e evidentimit të problematikave, duke mos kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara ligjore ose informacioni i dërguar ka qene i cunguar ose i paqartë, gjë që përbën pengesë për zgjidhjen e problemit në kohën e duhur;
7. Në disa raste, ka mungesë bashkëpunimi me institucione të tjera vendore ose shmangie të tyre nga përgjegjësitë, në lidhje me zgjidhjen e problematikave të caktuara që kanë të bëjnë me ndotjen e mjedisit, pyjeve, territorit.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria (Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve) përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i monitorimit dhe Analizës së Riskut, ka në strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 3 inspektorë (sektor i plotësuar);
2. Sektori i Inspektimit të Pyjeve, ka në strukturë 1 përgjegjës sektori dhe 4 inspektorë (sektor i plotësuar).

Nr.	Drejtoritë Rajonale	Numri i rasteve	Sipërfaqja e përshkruar/ha	Sipërfaqja e djegur/ha	Pronësia	Inspektime/ Subjekte të Inspektuar	Mjete të ndaluara	Bashkëpunime me Policinë e Shtetit	Inspektime në Gjueti	Prokurori	Material drusor i Sekuestruar (raste)
			Pyje	Kullota	Pyje						-
1	Tiranë		61			34	34	1	-		-
2	Kukës	26	565,99		565.99	21	0	21	32		-
3	Berat	-	-	-	-	-			-		-
4	Dibër	9	876.1			78	-	17	-	-	2
5	Durrës	-	-	-	-	-	-	27	15	2	2
6	Elbasan	-	-	-	-	164		1	47		-
7	Shkodër		3640	-	79	85	-	-	-	-	-
8	Vlorë		745	-		4	-	-	-	-	-
9	Lezhë			-			-	-	-	-	-
10	Fier			-			-	-	-	-	-
11	Korçë	9	2947.18	-	-	-	-	4	-	4	2
12	Gjirokastër	4	1223	-	-	-	-	-	-	-	-

Drejtoria e Inspektimit të pyjeve nuk ka patur kërkesë për mbështetje shtesë në rastet e rënies së zjarreve, duke qenë se dhe kompetencat i kanë patur Bashkitë,

Inspektorati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit sëbashku me Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, si dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve, ka patur raste sporadike nga disa prej Drejtorive Rajonale si më poshtë vijon:

Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve ka kryer në total 77 inspektime në të gjithë territorin e Shqipërisë kryesisht në zonat me risk më të lartë të shfrytëzimit të pyjeve dhe ku operojnë subjektet që meren me tregtimin dhe përpunimin e materialit drusor.

Nga këto veçojmë Qarqet: Elbasan, Shkodër, Tiranë, Korçë, Pogradec si dhe Lezhë.

Gjithashtu në Qarkun Shkodër kemi pasur dy raste sekuestro mjetesh të cilat po transportonim material drusor pa dokument shoqërues ligjor.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Organizimi Punës, Përshtatja dhe implementimi i ndryshimeve ligjore të ligjit Nr.99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Akses, përdorim dhe marrje informacioni në sistemin e "e-inspektimi";
2. Standartizimi i inspektimit të Fondit Pyjor e Kullosor, në funksion të parandalimit të prerjeve ilegale të pyjeve, zënies e përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor e kullosor si dhe mbrojtjes së faunës së egër, nëpërmjet inspekimit online në portalin unik e-inspektimi;
3. Përgatitja e udhëzimeve e rregullave për standartizimin e inspektimit të fondit pyjor, kullosor në funksion të parandalimit të prerjeve ilegale të pyjeve, zënies e përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor e kullosor si dhe mbrojtjes së faunës së egër. Përgatitja e udhëzimit për analizën e riskut dhe marrja e masave për adresimin e problemeve sipas rëndësisë dhe shkallës së dëmtimeve;
4. Përgatitja e udhëzimeve për përmirësimin e ekzekutimit të gjobave dhe ndjekjes së vjeljes së vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtjet nga strukturat që administrojnë pyjet. Kontrolli i strukturave të administrimit të pyjeve për hartimin e planit vjetor të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota dhe ndjekja e zbatimit të tij;
5. Standartizimi i inspektimit të Fondit Pyjor e Kullosor, në funksion të parandalimit të prerjeve ilegale të pyjeve, zënies e përdorimit të paligjshëm të fondit pyjor e kullosor si dhe mbrojtjes së faunës së egër, nëpërmjet inspekimit online në portalin unik e-inspektimi;
6. Përmirësimin e ekzekutimit të gjobave dhe ndjekjes së vjeljes së vlerës së dëmit të shkaktuar nga kundërvajtjet nga strukturat që administrojnë pyjet;
7. Promovimi në media i rezultateve të kontrolleve;
8. Bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, tatime, doganat dhe policinë e shtetit, për mbrojtjen e pasurive pyjore, në të gjitha nivelet;
9. Rritja e përgjegjësisë të inspektorëve të sektorëve të Drejtorive Rajonale në DIP, për të informuar në kohë mbi tjetërsimet e fondit pyjor e kullosor me qëllim hapjen e tokave të lira.
10. Pajisja me infrastrukturën e duhur të grupeve të inspektimit si: (armatim, mjete lëvizëse dhe lundruese, karta e inspektorit, uniforma, drone, GPS-së, harta etj);
3. Inspektim i subjekteve të shfrytëzimit të pyjeve në zbatim të ligjit të moratoriumit për ndalimin e ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor dhe disiplinimi i këtij aktiviteti (ushtrimi i inspektimeve periodike në drejtoritë rajonale të IKMT, sipas ngastrave të shfrytëzimit të kontraktuara me Bashkitë);

Trajnime të ndryshme: Sugjerohet trajnimi i Drejtorisë së Inspektimit të Pyjeve (Qendër), si dhe trajnimi i trupës së inspektorëve në Drejtoritë Rajonale, për Bazën Ligjore mbi të cilën funksionon Drejtoria e Inspektimit të Pyjeve, si dhe marrja e udhëzimeve nga IQ.

Organizimi i një udhëtimi studimor: Në një nga vendet e rajonit dhe të BE me ngjashmëri të strukturave të inspektimit në fushën e pyjeve e faunës së egër dhe mbrojtjen nga zjarret. Bashkëpunim dhe shkëmbim eksperience me shtetet fqinje për reformën institucionale në veçanti për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret. Pjesëmarrja në aktivitet kombëtarë dhe ndërkombëtarë me objekt inspektimin dhe bashkëpunimin në fushën e inspektimit.

VIII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË ZBATIMIT TË VENDIMEVE

Gjatë vitit 2024, nga Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve janë përmbushur detyrat institucionale për:

- 1.Zbatimin e vendimeve të prishjes të dala nga IKMT ja.
- 2.Lirimin e sheshit të ndërtimit Unaza e Madhe Tiranë nga objektet pengesë.
3. Lirimin e sheshit të ndërtimit Segmenti rrugor Thumanë - Vorë - Kashar nga objektet pengesë.
- 4.Rikualifikimi i hyrjes së Qytetit të Shkodrës.
- 4.Mbështetjen e IMTve të Bashkive për ekzekutimin e vendimeve.
- 5.Ekzekutimin e vendimeve të prishjes në Zonat Bregdetare.
- 6.Shoqërimin e mjeteve të sekuestruara nga vendi i bllokimit për në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit,

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për:

1. Zbatimi i Vendimeve të dala nga IKM ja.
2. Lirimi i Sheshit të ndërtimit nga objektet pengesë për realizimin e projektit : “Unaza e Madhe Tiranë”.
3. Lirimin e sheshit të ndërtimit Segmenti rrugor Thumanë - Vorë - Kashar nga objektet pengesë

Strukturat Përbërëse.

Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve përbëhet nga sektorët si vijon:

- Sektori I- rë i ndërhyrjes
- Sektori II - të i ndërhyrjes
- Sektori III -të i ndërhyrjes
- Sektori IV- të i ndërhyrjes
- Sektori V- të i ndërhyrjes
- Sektori VI- të i ndërhyrjes
- Sektori VII- të i ndërhyrjes

Në vijim të projektit “ Rishikimi i Projektit për Segmentin Rrugor të vazhdimin të Unaza e Madhe Tiranë nga “Sheshi Shqiponja – “Bulevardi i Ri “ dhe Rikualifikimi i Unazës Lindore për Lotet 4,5,6,të ndryshuar është realizuar prishja e **103** objekteve nga 1 deri 6 kat. të trajtuara me vkm shpronësimi , me vkm 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT ja.

Në vijim të projektit segmentit rrugor”Thumanë - Vorë Kashar “ është realizuar prishja e **82** objekteve nga 1 deri 4 kat të trajtuara me vkm shpronësimi , me vkm 409 (akt marrëveshje) dhe me vendime prishje të marra nga IKMT ja .

Në vijim të projektit “Rikualifikimi i hyrjes së Qytetit të Shkodrës dhe bregdetit perëndimor të Liqenit të Shkodrës.

Kemi realizuar prishjen e **10** objekteve me vendim prishje të dal nga IKMT-ja.

- Jemi angazhuar në rritjen e parametrave të sigurisë rrugore për pastrimin e tyre nga tabelat e kioskat pa leje në afërsi të pikave doganore (Hani i Hotit, Muriaqn, Morinë , Kapshticë, Qafë Thanë, Kakavijë) Kemi realizuar prishjen e **51** Tabelave (Billbordera) dhe **20** Kioska. Të gjitha me vendime prishje të dal nga IKMTja.

- Kemi ndërhyrë në “Vijën Bregdetare“ me qëllim mbrojtjen e vijës bregdetare nga ndërtimet e kundraligjeshme dhe cdo elementi që çënon imazhin dhe peisazhin në zonat turistike në Bashkinë Shkodër (Velipojë) ku dhe kemi realizuar prishjen e **48** objekteve kryesisht beach bare . kioska tenda etj. në Bashki të Himarë (Himarë, Drimadhe, Dhërmi, Borsh, ku janë prishur **6** objekte si kioska kantonier, tenda beach bare etj,në Bashkinë Sarandë (Ksamil) ku janë prishur **4** objekte në Bashkinë Vlorë 5 objekte.
- Kemi ndërhyrë në By Passin e Vlorës –Tuneli i Llogaras dhe kemi realizuar prishjen e **10** objekteve (kioska ,tenda etj.)
- Kemi ndërhyrë për prishjen e objekteve pengesë në kuadër të realizimit të projektit “Lungomare Faza 3 dhe 4 në vijën bregdetare Vlorë - Orikum.dhe kemi realizuar prishjen e **27** objekteve (beach bare , kioska ,Tenda etj,)
- Kemi ndërhyrë për prishjen e ndërtimeve të kundraligjeshme në territor(Lac,Tiranë,Durrës,Korcë,Këlcyrë,Tepelenë,Gjirokastrë,Kukës) dhe është realizuar prishja e **15** objekteve me vendime prishje të marra nga IKMT ja.
- Kemi vepruar në mbështetje të Drejtorive Rajonale(Kukës, Dibër, Lezhë, Korçë, Berat, Tiranë Vlorë.Gjirokastrë.Elbasan) të IKMT-së dhe të Drejtorive të Mjedisit dhe Pyjeve ku është realizuar shoqërimi i **15** mjeteve(eskavator.kamion të Tonazhit të rëndë) të sekuestruara për në Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit.
- Kemi vepruar në mbështetje të IMT-ve (Vlorë .Himarë,Korcë,Sarandë,) sipas kërkesave për mbështetje ku dhe është realizuar prishja e **74** objekteve.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

- Lirimi i Shesheve të ndërtimit nga objektet pengesë për realizimin e projekteve : sipas kërkesave të Autoritetit Rrugor Shqipëtar.
- Zbatimi i Vendimeve të prishjes të dala nga IKMT ja.
- Veprime në mbështetje të IMT-ve sipas kërkesave për mbështetje.
- Veprime në mbështetje të institucioneve tjera sipas kërkesave respective.

IX. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INSPEKTIMIT TË TERRITORIT DHE PLANIFIKIMIT

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit mbulon veprimtarinë për ushtrimin e përgjegjësi të inspektimit mbi zbatimin e ligjshmërisë, në këto drejtime kryesore:

- Kontrollin e territorit për parandalimin e zhvillimeve pa leje/pa autorizuar apo punimeve/zhvillimeve në shkelje të kushteve të lejeve të miratuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Respektimin e normave dhe standarteve për materialet dhe produktet e ndërtimit që hidhen në treg;
- Respektimin e normave dhe standarteve për shfrytëzimin e rezervave ujore, atyre minerare dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore, shfrytëzimin e karriera të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit dhe për pusët e ujit;
- Mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë nga Kryeinspektorët dhe inspektorët pranë IMT të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
- Mbikëqyrjen e respektimit të kërkesave ligjore nga organet e planifikimit;
- Kontrollin e Drejtorive Rajonale të IKMT-ve;
- Organizimin dhe drejtimin e punës për realizimin e objektivave të programuara, zbatimin e detyrave organike dhe funksionale;
- Bashkërendimin e punës në nivel qendror dhe rajonal;
- Organizimin e punës për trajtimin, ndjekjen e praktikave të korrespondencës administrative brenda

- dhe jashtë institucionit;
- Bashkërendimin e punës me institucionet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve të përbashkëta gjatë ndërhyrjeve për konstatimin dhe ndëshkimin e kundërvajtjeve në fushën e ndërtimit të integruar dhe me produktet e ndërtimit;
 - Përgatitjen e raporteve informative periodike mbi punën e kryer;
 - Ndjekjen dhe kontrollonin e punës për trajtimin efektiv dhe brenda afateve të praktikave të korrespondencës administrative, të adresuara pranë kësaj drejtorise sipas sektorëve përkatës;
 - Ndjekjen e drejtpërdrejtë të ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit dhe kontrollit për zbatimin e ligjshmërisë në përputhje me objektin e veprimtarisë së sektorëve.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë:

1. Rivendosja e ligjshmërisë në bregdet në kuadër të operacionit “Bregdeti Ynë”; inspektimi i objekteve/ndërtimeve në zonën bregdetare; azhurnimi në të gjithë vijën bregdetare të Shqipërisë;
2. Monitorimi i situatës ndërtimore në realizimin e strukturave të shërbimit në stacionet e plazhit nga subjektet e listës së miratuar nga AZHT;
3. Evidentimi i çdo lloj punimi ndërtimor në zonën bregdetare që klasifikohet si zonë me përparësi zhvillimi turizmi;
4. Përmbushja e detyrimeve për monitorimin dhe kontrollin e këtyre zonave me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm;
5. Mbikëqyrja e veprimtarive ndërtimore të kundërligjshme në Zonat e Mbrojtura;
6. Mbështetja për prishjen e objekteve në territoret administrative të bashkive të vendit, me qëllim realizimin e projekteve urbane;
7. Angazhimi në lirimin e shesheve të ndërtimit nga objektet pengesë për realizimin e projekteve me interes publik, sipas kërkesave për bashkëpunim të ARRSH-së apo institucioneve të tjera.

Objektivat e Drejtorisë së Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit:

- Parandalimi, zbulimi dhe goditja e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
- Mbajtja nën mbikëqyrje dhe inspektimi i subjekteve fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të materialeve të ndërtimit;
- Inspektimet mbi zbatimin e dispozitave ligjore nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Njësive në nivel të qeverisjes vendore;
- Mbikëqyrja me qëllim kontrollin për njohjen dhe zbatimin e ligjit nga Drejtoritë Rajonale;
- Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera;
- Informimi në kohë, sanksionimi dhe vendimmarrja për subjektet që operojnë në mënyrë të kundërligjshme;

Në total nga Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit janë mbajtur vendimet si më poshtë:

- 283 vendime për “Prishje objekti të kundërligjshëm”.
- 40 Vendime për “Pezullimin e punimeve në ndërtim”;
- 262 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna në fushën e ndërtimeve pa leje dhe në fushën e prodhimit dhe tregtimit të materialeve dhe produkteve të ndërtimit ;
- 23 vendime për “Dënim me gjobë” të vëna ndaj kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT-ve të bashkive për veprimet/mosveprimet e tyre;

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Territorit;
2. Sektori i Burimeve Natyrore dhe Produkteve të Ndërtimit;
3. Sektori i Mbikqyrjes së IMT-ve;

Sektori i Inspektimit të Territorit

Disa nga detyrat që janë kryer nga ky sektor:

- Angazhimi për evidentimin deri në ndërhyrje ndaj ndërtimeve të kundërligjshme përgjatë zonës bregdetare;
- Inspektime në terren mbi kontrollin e situatës ndërtimore në objekte sipas problematikave teknike dhe ligjore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Hartimi i urdhërave të punës sipas ankesave/kërkesave të institucioneve/individëve apo nevojave për inspektime direkt në terren;
- Ndjekja e korrespondencës së vazhdueshme me ASHK rreth statusit ligjor të subjekteve kundravajtëse në ndihmë të realizimit në kohë të projekteve për lirim të sheshit të ndërtimit dhe në përgjithësi;
- Plotësimi i aktëve administrative referuar proces-verbalit të konstatimit të mbajtur nga inspektorët e drejtorisë qendrore dhe ato rajonale; përgatitja e njoftimeve të aktit administrativ, vendimit për prishje të objektit të kundërligjshëm dhe vendimit për dënim me gjobë për subjektet kundravajtëse;
- Kontrolli i dokumentacionit të administruar nga IKMT për subjektet dhe konkluzionet rreth tyre (njoftim fillim punimesh);
- Trajtimi dhe ndjekja e problematikave/ankesave të bëra prezente në mënyrë elektronike dhe shkresore pranë IKMT-së;
- Përgatitja e relacioneve përkatëse rreth inspektimeve të kryera në terren.

Trupa inspektuese e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit ka qenë e angazhuar në të gjithë territorin e vendit për kryerjen e kontrollit dhe inspektimeve sipas fushës së përgjegjësisë së këtij inspektorati dhe për periudhën janar – dhjetor 2024 janë kryer 1059 inspektime në fushën e ndërtimit.

Gjithashtu është angazhuar në lirim të sheshit të ndërtimit për realizimin e projekteve me interes publik si më poshtë vijon:

- “Unaza e Madhe Tiranë-Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri-Shkozë”;
- Realizimi i projektit “Aksi rrugor Thumanë-Vorë-Kashar”;
- Inspektim deri në prishje përgjatë vijës bregdetare, Qarku Shkodër;
- Inspektime deri në prishje të tabelave në akset rrugore drejt pikave kufitare të Hanit të Hotit, Muriqan, Morinë, Kapshticë, Qafë-Thanë, Kakavijë, Blladë;
- “Rikualifikimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës”;
- “Parku Ujor Drilon - Tushemisht”, Bashkia Pogradec;
- Realizimi i projektit “Qukës – Qafë Plloç”;
- “Studim, Projektim, Zgjerimi i Rugës Elbasan – Përrenjas – Qafë Thanë”;
- “Lidhja e rrugës Transballkanike me Portin Detar”, Vlorë;
- “Lungomare Loti 3 dhe Loti 4”, përgjatë vijës bregdetare Vlorë-Orikum;
- Projekte të infrastrukturës në territorin e Bashkisë Himarë.

2. Sektori i Burimeve Natyrore dhe Produkteve të Ndërtimit

Sektori i Burimeve Natyrore dhe Produkteve të Ndërtimit për periudhën Janar – Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Kryerjen e kontrolleve periodike në fushën e materialeve të ndërtimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim hedhjen në treg të produkteve në përputhje me standartet shqiptare dhe ato të harmonizuara me standartet Europiane;
2. Shqyrtimin e ankesave të marra në mënyrë elektronike dhe kryerjen e inspektimeve përkatëse;
3. Inspektime të kryera mbi bazë shkresë-ankesash të ardhura në Institucion nga subjekte juridike apo fizike;
4. Inspektime të kryera në bazë të ankesave të qytetarëve emisionet investigative.

Nga Sektori i Burimeve Natyrore dhe Produkteve të Ndërtimit është ushtruar kontroll në 171 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e prodhimit dhe tregtimit të materialeve dhe produkteve të ndërtimit sipas qarqeve konkretisht:

1. Qarku Gjirokastrë
2. Qarku Fier
3. Qarku Korçë
4. Qarku Vlorë
5. Qarku Tiranë
6. Qarku Berat
7. Qarku Lezhë
8. Qarku Shkodër

Në bazë të Udhëzimit nr. 1 datë 3.01.2024, “Për unifikimin e veprimtarisë së inspektimit të shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga zjarri në shkallë vëndi” të Ministrisë së Brendshme, në bashkëpunim me Drejtorinë e përgjithshme Mbrojtja e Zjarrit dhe Shpëtimit (MZSH), në zbatim të ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 për “Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” si dhe ligjit nr. 9290/2004 “Për Produktet e Ndërtimit” i ndryshuar, kanë kryer inspektime qarkun Tiranë, Elbasan dhe Fier.

Sektori i Mbikqyrjes së IMT-ve

Për periudhën janar – dhjetor 2024 janë kryer në total 14 inspektime mbi zbatimin e dispozitave ligjore nga Inspektoratët e Mbrojtjes së Territorit në bashkitë sipas qarqeve konkretisht:

Në Qarkun Tiranë:

1. Bashkia Tiranë
2. Bashkia Kamëz
3. Bashkia Vorë
4. Bashkia Kavajë
5. Bashkia Rrogozhinë

Në Qarkun Fier

6. Bashkia Fier
7. Bashkia Mallakastër

Në Qarkun Berat

8. Bashkia Berat
9. Bashkia Dimal
10. Bashkia Kuçovë

Në Qarkun Vlorë

11. Bashkia Himarë

12. Bashkia Konispol

13. Bashkia Sarandë

Në Qarkun Korçë

14. Bashkia Korçë

Gjithashtu nga ky sektor, në njohje dhe zbatim të detyrave funksionale:

- Janë marrë 23 masa administrative “Dënim me Gjobë”;
- Janë përpiluar relacionet përkatëse dhe janë dorëzuar;
- Janë ushtruar kontrole mbi bazë të shkresave të ardhura sipas kërkesës së IKMT në vazhdimësi të detyrave të sektorit tonë;
- Ushtrimi i kontrollit është bërë mbi të dhënat e vendosura nga IMT-të;
- Janë marrë masa administrative për veprimet dhe mosveprimet e funksionarëve përgjegjës;
- Janë trajtuar ankesat e ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes dhe ankesat/kërkesat e adresuara me adresë zyrtare në emailin e koordinatorit për të drejtën e informimit.

X. VEPRIMTARIA E DREJTORISË TË INSPEKTIMIT JURIDIK

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Përfaqësimin e veprimtarisë juridike dhe ligjore të IKMT-së pranë institucioneve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykatës, në rang vendi;
2. Përgatitjen e materialeve mbrojtëse dhe argumentuese në procese gjyqësore, bazuar në tipologjinë dhe natyrën e objektit të padisë;
3. Ushtrimin e të drejtës ankimore/rekursuese, sipas dispozitivit të vendimeve gjyqësore, në përputhje me afatet ligjore specifike të tyre;
4. Përgatitjen e kërkesave për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit dhe ndjekjen e tyre deri në momentin e dërgimit të tyre pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
5. Trajtimin dhe ndjekjen e praktikave të korrespondencës administrative, të cilat lidhen me veprimtarinë juridike dhe marrëdhëniet me të tretët.
6. Përfshirjen në komisione të ndryshme të ngritura në funksion të IKMT-së, me urdhër të Kryeinspektorit, për vlerësim nga ana juridike;
7. Bashkëpunimin në dhënien e informacionit dhe raportimin me Drejtorinë e Informacionit, Kontrollit të të Dhënave dhe Marrëdhënieve me Publikun;
8. Dhënien e vlerësimit juridik të anës formale të akteve procedurale të mbajtura nga njësitë inspektuese dhe drejtoritë rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit;
9. Pjesëmarrjen dhe përfshirjen në grupet e punës të ngarkuara me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të tjera me karakter normativ (manuale, udhëzuesat, formularë, etj.), lidhur me ristrukturimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sipas ndryshimeve ligjore të Ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

1. Organizimi për realizimin e objektivave të funksionimit të brendshëm dhe zbatimin e detyrave funksionale, në përputhje me objektivin e veprimtarisë së Drejtorisë;
2. Pjesëmarrja aktive në grupet e punës për përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të tjera me karakter normativ që rregullojnë marrëdhëniet juridike dhe administrative, në përputhje me objektin e veprimtarisë që mbulon kjo Drejtori;

3. Ndjekja e praktikave të korrespondencës administrative, të cilat lidhen me veprimtarinë juridike dhe legjislative, në përputhje me dispozitat ligjore brenda dhe jashtë institucionit;
4. Marrja e pjesës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera në aparatin qendror, në organizimin e veprimtarive të ndryshme për diskutim, informim dhe sensibilizimin e grupeve të interesit ose opinionit publik, në funksion të rritjes së objektivitetit të vendimmarrjeve për çështje me rëndësi të veçantë;
5. Përgatitja e raporteve informative periodike që pasqyrojnë situatën reale mbi punën dhe misionin e Drejtorisë dhe paraqitja e tyre për njohje dhe miratim Kryeinspektorit;
6. Bashkërendimi i punës me drejtoritë e tjera në aparatin qendror, si dhe me drejtoritë rajonale të IKMT-së në bazë, për probleme me karakter të përbashkët në aspektin e kuadrit ligjor.
7. Evidentimi i problematikave, paqartësive ose pasaktësive që mund të hasen gjatë ushtrimit të përgjegjësisë ligjore, duke marrë masa konkrete për zgjidhjen e tyre.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesorë të Drejtorisë së Inspektimit Juridik gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. 460 procese gjyqësore të regjistruara për vitin 2024;
2. 487 përgatitje materialesh për përfaqësim, drejtuar institucioneve gjyqësore dhe Drejtorive Rajonale;
3. 879 përfaqësime pranë institucioneve gjyqësore;
4. 470 ankime administrative drejtuar institucioneve gjyqësore (397 Sektori i Ankimeve dhe Ndjekjes së Zbatimit të Vendimeve dhe 73 Sektori i Inspektimit Juridik dhe Përfaqësimit Ligjor);
5. 290 vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, të përcjella pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve, me qëllim vënien në ekzekutim të gjobave me anë të përmbaruesve;
6. 98 memo + shkresa përcjellëse brenda drejtorive të aparatit qendror;
7. 143 korrespondenca të ndryshme shkrese drejtuar institucioneve të ndryshme në rang vendi;
8. 37 kërkesa për ndreqje ndaj vendimeve për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit për vendimet për dënim me gjobë;
9. 35 procese gjyqësore të përfunduara në apel;
10. 27 vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, refuzim mase sigurim padie;
11. 60 vendime të institucioneve gjyqësore të shkallës së parë, rrëzim padie.

Risite e vitit 2024:

1. Përgatitja e memo-ve për dhënien e vlerësimit juridik të anës formale të akteve procedurale të mbajtura nga njësitë inspektuese dhe drejtoritë rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit;
2. Pjesëmarrja aktive dhe angazhimi në grupet e punës në lidhje me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, etj., për ristrukturimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Prioritetet:

1. Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për menaxhimin dhe organizimin e mbrojtjes ligjore pranë institucioneve gjyqësore;
2. Koordinimi me drejtoritë rajonale të IKMT për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore;
3. Bashkëpunimi me Avokaturën e Shtetit lidhur me përfaqësimin pranë institucioneve gjyqësore në të gjitha nivelet e tyre;
4. Inicimi i procedurës së ekzekutimit të vendimeve për dënim me gjobë në rrugë gjyqësore, brenda afateve ligjore;
5. Trajtimi dhe ndjekja e praktikave të korrespondencës administrative, të cilat lidhen me veprimtarinë juridike dhe marrëdhëniet me të tretët;
6. Përfshirja në komisione të ndryshme, me urdhër të Kryeinspektorit, për vlerësim juridik;

7. Përgatitja e memo-ve për dhënien e vlerësimit juridik të anës formale të akteve procedurale të mbajtura nga njësitë inspektuese dhe drejtoritë rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit;
8. Pjesëmarrja dhe përfshirja në grupet e punës të ngarkuara me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të tjera me karakter normativ (manuale, udhëzuesat, formularë, etj.), lidhur me ristrukturimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sipas ndryshimeve ligjore të Ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Mangësi dhe problematika:

1. Performancë e ulët e trupave inspektuese lidhur me mbajtjen e procedurave administrative, për të cilat është i nevojshëm trajnimi i trupave inspektuese;
2. Dystandartizimi, i diktuar nga vendimet gjyqësore për të njëjtat rrethana dhe objekte procedurale;
3. Mungesa e njoftimit të vendimeve, si dhe provave shkresore për vërtetimin e marrjes dijeni nga subjektet kundërvajtës në lidhje me vendimmarrjen e trupave inspektuese;
4. Mangësi lidhur me "gjeneralitetet" dhe adresat e debitorëve (subjektet kundërvajtës), duke marrë indicie nga vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në lidhje me kërkesat "Për Lëshimin e Urdhërave të Ekzekutimit", apo dhe nga fletë-thirrjet për plotësimin e të metave;
5. Ndikimi i Vendimit nr. 15, datë 22.06.2022, i Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 52, pika 1, shkronja "e", të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", për të cilat nevojiten ndryshime ligjore.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria e Inspektimit Juridik përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit Juridik dhe Përfaqësimit Ligjor
2. Sektori i Asistencës Ligjore
3. Sektori i Ankimeve dhe Ndjekjes së Zbatimit të Vendimeve

Sektori i Përfaqësimit Ligjor

Sektori i Përfaqësimit Ligjor për periudhën janar – dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Përgatitja e materialeve mbrojtëse për përfaqësimin e mbrojtjes ligjore të interesave institucionale;
2. Ndjekja rigoroze e proceseve gjyqësore në rang vendi;
3. Koordinimi me drejtoritë rajonale të IKMT për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore;
4. Ushtrimi i të drejtës ankimore nga vendime gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit;
5. Ushtrimi i të drejtës së rekursit pranë Gjykatës së Lartë, në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit;
6. Raportimi javor/mujor dhe vjetor lidhur me veprimtarinë e Sektorit.

Sektori i Ankimeve dhe Ndjekjes së Zbatimit të Vendimeve

Sektori i Ankimeve dhe Ndjekjes së Zbatimit të Vendimeve, për periudhën janar - dhjetor 2024, e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Përgatitja e kërkesave për "Lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit" për vendimet për dënim me gjobë, tituj ekzekutivë, duke iniciuar procesin e ekzekutimit të këtyre vendimeve në rrugë gjyqësore;
2. Mbledhja dhe koordinimi nga Sektori i Arkiv Protokollit dhe drejtoritë përkatëse të inspektimit në nivel rajonal dhe qendror, i materialeve shkresore provë dhe dosjes së inspektimit për titujt ekzekutivë, për të cilat duhet të investohet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë "Për Lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit";

3. Korrespondenca shkresore me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përsa i përket vendimeve për lëshimin e urdhërave të ekzekutimit, si dhe problematikave që lidhen me to;
4. Ushtrimi i të drejtës ankimore ndaj vendimeve gjyqësore të gjykatave, apo dhe plotësimi i të metave, përsa i përket vetëm me kërkesat për urdhërat e ekzekutimit;
5. Koordinimi me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për vendimet për dënime gjobë, si dhe përcjellja pranë kësaj drejtorie e vendimeve "Për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit" të Gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim pranë përmbartuesëve;
6. Raportimi javor/mujor dhe vjetor lidhur me veprimtarinë e Sektorit.

Sektori i Asistencës Ligjore

1. Mbledhja, përditësimi dhe ndarja e informacioneve me të gjitha drejtoritë qendrore dhe rajonale të IKMT-së në lidhje me njohjen, ndryshimet e reja ligjore dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e funksioneve dhe përgjegjësi;
2. Asistencë ligjore ndaj strukturave përbërëse të IKMT-së nëpërmjet konsulencës juridike.
3. Trajtimi, ndjekja e praktikave të korrespondencës administrative që lidhen me veprimtarinë juridike dhe marrëdhëniet me të tretët;
4. Bashkëpunimi në dhënien e informacionit me Drejtorinë e Informacionit, Kontrollit të të Dhënave dhe Marrëdhënieve me Publikun për t'iu përgjigjur në kohë ankesave të qytetarëve;
5. Përgatitja e memove për dhënien e vlerësimit juridik të anës formale të akteve procedurale të mbajtura nga Njësitë Inspektuese dhe Drejtoritë Rajonale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit të Territorit dhe Planifikimit;
6. Raportimi javor/mujor dhe vjetor lidhur me veprimtarinë e Sektorit.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Përgatitja e raporteve informative periodike që pasqyrojnë situatën reale mbi punën dhe misionin e Drejtorisë dhe paraqitja e tyre për njohje dhe miratim pranë Kryeinspektorit.
2. Përgatitja dhe planifikimi i masave për menaxhimin dhe organizimin e mbrojtjes ligjore pranë institucioneve gjyqësore;
3. Koordinimi me drejtoritë rajonale të IKMT për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e proceseve gjyqësore;
4. Mbledhja dhe koordinimi me Sektorin e Arkiv Protokollit dhe drejtoritë përkatëse të inspektimit në nivel rajonal dhe qendror të materialeve shkresore provë dhe dosjes së inspektimit, për titujt ekzekutivë, për të cilat duhet të investohet Gjykata Administrative e Shkallës së Parë për "Lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit", deri në përcjelljen pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
5. Trajtimi, ndjekja e praktikave të korrespondencës administrative që lidhen me veprimtarinë juridike dhe marrëdhëniet me të tretët;
6. Pjesëmarrja dhe përfshirja në grupet e punës të ngarkuara me përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe akteve të tjera me karakter normativ (manual, udhëzues, formularë, etj.) lidhur me ristrukturimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sipas ndryshimeve ligjore të Ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të cilat prekin fushat inspektuese të Institucionit, si mjedisin, territorin, ujin, pyjet, etj.

XI. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE TIRANË

Gjatë vitit 2024, nga Drejtoria Rajonale e IKMT Tiranë, janë përmbushur detyrat institucionale mbi:

1. Kontrollin për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të kundraligjshme dhe zbatimit të ligjshmërisë në fushën e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave;
2. Mbikqyrja dhe koordinimi me strukturat e inspektorateve vendore të ngritura pranë njërive vendore përmes kryerjes së korrespondencës shkresore zyrtare të ndjekur, si dhe inspektimeve të drejtpërdrejta me fokus të përbashkët në objekt;

3. Ushtrimi i kontrollit në subjekte/ndërgjegjësimi me qëllim parandalimin dhe minimizimin mbi uljen e nivelit apo dhe shmangien totale të ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
4. Rritjen e bashkëveprimit me strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim goditjen e paligjshmërisë në bashkëpunimin me institucionet e tjera;
5. Inspektim-kontroll mbi parandalimin e prerjeve të paligjshme të pyjeve dhe gjuetisë së faunës.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë Rajonale Tiranë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për inspektim:

1. Zonat me rëndësi kombëtare ku janë ushtruar kontrole të herë pas herëshme dhe rrugët nacionale, zona bregdetare dhe inspektimi në njësitë vendore në rang qarku;
2. Kontrolli i objekteve në zhvillim dhe kontrolli IMT-ve në shkallë qarku;
3. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
4. Përmirësimi i kushteve të mjedisit;
5. Parandalimin e gjuetisë së paligjshme;
6. Parandalimin, bllokimin dhe sekuestrimin e mjeteve që transportojnë material drusor pa dokumentacionin përkatës konform ligjeve në fuqi;
7. Parandalimin dhe hetimin e zënieve të fondit pyjor dhe kullosor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi:

- Rritjen e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të IKMT-së si në Drejtoritë Qendrore dhe Rajonale, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera;
- Mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit;
- Garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë së pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedim penal të autorëve të tyre në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimin dhe forcimin e bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.
- Mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, në aspektin administrativ e financiar, për trajtimin e informacioneve, praktikave e procedurave të ardhura.

Objektivi:

- Parandalimi, zbulimi e goditja e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- Parandalimin e transportit të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të tjera me origjinë nga pylli;
- Monitorim për dëmtuesit dhe sëmundjet në fondin pyjor.
- Funksonimi optimal i shërbimeve mbështetëse e logjistike, në përputhje me nevojat parësore të drejtorisë;
- Menaxhimi dhe administrimi i dokumentacionit me karakter financiar dhe administrativ;
- Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera;

- Rivlersimi i situatës dhe përmirësimin e punës në marrjen e masave për parandalimin, evidentimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e ndërtimit të paligjshëm në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale Tiranë përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori Inspektimit të Territorit;
2. Sektori Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave;
3. Sektori Inspektimit Pyjor;
4. Sektori Financave dhe Shërbimeve Mbështetës.

Raportim janar - dhjetor 2024 mbi inspektime të kryera:

Fusha Inspektimit/zona /çështja	Mjedisi/ujra	Ndërtimi	Pyjet	Inspektimet e realizuara në bashkëpunim me Policinë	Totali
Zona me rëndësi kombëtare	---	---	--	--	--
Rezervat Ujore		--	--	--	
Zona Pyjore	--	--	--	--	--
Zona të tjera (Urbane/Rurale/Industriale)	270	752	140	--	1162
Burime Natyrore/ujore	--	--	--	--	--
Shkresa/ankesa/informacion				--	1800

Në total nga DRIKMT Tiranë nga të tre sektorët për periudhën JANAR - DHEJTOR 2024 janë kryer 1162 inspektime dhe janë trajtuar/process 1800 shkresa, kjo me institucione të tjera dhe IKMT Qendër

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Inspektimit të Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Zonat me rëndësi kombëtare/bregdetare dhe ato breg liqenore;
2. Akset rrugore dhe rrugët nacioanle;

3. Kontrolli i IMT-ve;
4. Kontrolli i objekteve në zhvillim me leje ndërtimi.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje e produktivitetit për zgjidhjen e ankesave;
2. Rritje e gadishmërisë (bashkëpunim me sektorët e tjerë në qendër dhe ato me institucione të tjera);
3. Rritje e performancës;
4. Rënie e akteve procedurale sa lidhet me ankesat;
5. Rritje e zgjidhjes së ankesave nga Platforma e Bashkëqeverisjes;
6. Rritje e performancës sa lidhet me ecurinë për realizimin e Segmentit të Unazës së Tiranës;
7. Rritja në mënyrë të konsiderueshme e objekteve të prishura në këtë segment.

Sektori Inspektimit Territorit ka kryer inspektime në Bashkitë Tiranë, Vorë, Kamëz, Rrogozhinë dhe Kavajë dhe ka realizuar, 752 inspektime, ka mbajtur 60 proces verbale Për Konstatimin E Kundërvajtjes, është asistuar në prishjen e 54 objekteve.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave:

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Në zonat minerare;
2. Në ndërtimin e impianteve;
3. Në linjat e fraksionimit të inerteve;
4. Pastrimi nga ndotja e ujërave të lumenjve dhe liqeneve;
5. Vend depozitimeve për makinat në fund të jetës, në zbatim të Urdhërit nr.44, datë 16.02.2024 “ Për marrjen e masave të menjëherëshme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore”.

Sektori Mjedisit dhe Ujërave ka kryer 270 inspektime në Bashkitë Tiranë, Rrogozhinë, Vorë, Kavajë nga dhe janë marrë 52 vendime me gjobë.

Sektori i Inspektimit Pyjor:

Sektori i Pyjeve për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Kthimi i përgjigjeve të shkresave të ardhura nga institucionet si dhe ankesat e qytetarëve brenda afateve ligjore;
2. Transportimin e lëndës drusore nga kundërvajtës pa dokumentacion përkatës sipas ligjeve në fuqi;
3. Parandalimin e gjuetisë së paligjshme sipas Moratoriumit të Gjuetisë;
4. Parandalimin dhe hetimin e zënieve të fondit pyjor dhe kullësor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
5. Garantimin dhe mbrojtjen e faunës së egër dhe bimëve medicinale përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimi;
6. Rritjen e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera, Policinë e Shtetit dhe ADZM.

Konkretisht janë realizuar 140 inspektime në terren, janë mbajtur 26 akt-konstatime.

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

Sektori i Finances dhe Shërbimeve Mbështetës për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Rritja e performancës, etika në punë;
2. Përpilimi dhe dërgimi në kohë të listë prezencës mujore, evidentimi i mungesave si dhe rasteve të mungesave të arsyetuara me dokumentacionin justifikues, raport mjekësor dhe dërgimi i tyre në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në IKMT Qendër në mënyrë elektronike dhe në formë shkresore;
3. Planifikimi i lejeve të zakonshme të cdo punonjësi në institucion dhe ndjekja e grafikut të lejeve;
4. Rivlerësimin e pajisjeve dhe matërialeve në ambientet e punës në bashkëpunim me IKMT Qendër;
5. Është bërë parashikimi tek buxheti për vitin pasardhës, pajisjeve elektronike si kompjutera, fotokopje, skaner si dhe mjete kancelarike. Po ashtu është bërë kërkesa për planifikimin e buxhetit të vitit 2024-2026.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Janë kryer të gjitha detyrat dhe rekomandimet e lëna nga audit, specialistë të Sektorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore si dhe ato të dhëna nga titullari i institucionit;
2. Mbajtja e kontakteve të përditshme përmes adresës elektronike të institucionit, kthimi në në respektim të afateve ligjore i përgjigjeve të rasteve/problematika të deleguara nga IKMT Qendrore.

Në total në DRIKMT Tiranë për periudhën janar - dhjetor 2024, janë 1730 shkresa dalëse dhe 1800 shkresa hyrëse, kjo nga institucione të tjera dhe IKMT Qendër.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Rritjen e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të IKMT si Qendrore dhe Rajonale, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera;
2. Mbajtja e kontakteve të përditshme të adresës elektronike të institucionit, kthimi në kohë i përgjigjeve të problematikave të kërkuara nga IKMT Qendër dhe institucione të tjera;
3. Kontrolli i vazhdueshëm i zonave me rëndësi kombëtare/bregdetare, rrugët nacionale, breg liqenore dhe inspektimi i njësive vendore në rang qarku;
4. Kontroll i perimetrit të sigurisë së shkollave për objektet në zhvillim;
5. Kontrolli me qëllim vendosjen e standarteve unifikuese të procedurave të mbajtura nga IMT-të respektive të njësive vendore në qark;
6. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
7. Ruajtja, mbrojtja, përmirësimi i natyrës dhe diversiteti;
8. Përmirësimi i kushteve të mjedisit;
9. Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj;
10. Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit natyror;
11. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut;
12. Garantimin, mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale;
13. Garantimin, mbrojtjen e gjuetisë së paligjshme sipas “Moratoriumit të Gjuetisë”;
14. Garantimin, mbrojtjen e faunës së ergër dhe bimëve medicinale përmes parandalimit,

- zbulimit dhe hetimit;
15. Parandalimin, bllokimin dhe sekuestrimin e mjeteve që transportojnë material drusor pa dokumentacionin përkatës konform ligjeve në fuqi;
 16. Parandalimin dhe hetimin e zënieve të fondit pyjor dhe kullësor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

XII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT ELBASAN

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

- 1.Sektorin e Inspektimit Pyjor
- 2.Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave
- 3.Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit
- 4.Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

- 1.Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Mbrojtjen e Mjedisit bazuar në Ligjin Nr. 10431, Dt. 09.06.2011, menaxhimin e integruar të mbetjeve të bazuar në ligjin Nr. 10463, si dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
- 2.Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit Pyjor kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për mbrojtjen në fushën e pyjeve sipas ligjit Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, sipas ligjit Nr. 81/2017 datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe ligjit Nr. 60/2022 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”;
- 3.Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit është planifikimi, kontrolli dhe përgatitja e masave në zbatim të Ligjit Nr.9780 Dt.16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme” të ndryshuar dhe në zbatim të Planit Mujor të Inspektimeve.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë, sipas sektorëve inspektues:

- 1.Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Inspektimit të Pyjeve gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:
 - Janë kryer 164 inspektime nga të cilat 114 inspektime janë në akset rrugore/autopyjore, 47 inspektime në zona gjuetie dhe 3 inspektime sipas 3 ankesave të ardhura.
2. Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:
 - Janë kryer 211 inspektime në zonat urbane, rurale dhe industriale si dhe janë trajtuar dhe 13 ankesa.
4. Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:
 - Janë kryer 83 inspektime në zonat urbane, rurale dhe industriale ku nga këto: 25 janë ankesa të trajtuara nga ana e DR.IKMT Elbasan dhe 58 janë inspektime të ushtruara në territoret e Bashkisë së Qarkut Elbasan.

Risitë e vitit 2024:

1. Risitë në Sektorin e Mjedisit dhe Ujërave për vitin 2024 kanë qenë parandalimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve në fushën e mjedisit;
2. Risitë në Sektorin e Pyjeve për vitin 2024 kanë qenë parandalimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve në fushën e mjedisit;
3. Risitë në Sektorin e Mbrojtjes së Territorit për vitin 2024 kanë qenë trajnimi dhe testimi i inspektorëve me qëllim rritjen e performancës në punë, trajnimi për përdorimin e sistemit online për ushtrimin e kontrollit në territor.

Prioritetet:

1. Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Mbrojtjen e Mjedisit bazuar në Ligjin Nr. 10431, Dt. 09.06.2011, menaxhimin e integruar të mbetjeve të bazuar në ligjin Nr. 10463, si dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
2. Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit Pyjor kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për mbrojtjen në fushën e pyjeve sipas ligjit Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, sipas ligjit Nr. 81/2017 datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, si dhe ligjit Nr. 60/2022 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Prioritet gjatë këtij viti për Sektorin e Inspektimit të Territorit janë ushtrimi i kontrollit në : Zonat e mbrojtura, Rugët nacionale, Zona me përparësi zhvillimin dhe turizmin, shtimin e kontrollit në territorin e Qarkut Elbasan, verifikimin e lejeve të ndërtimit, parandalimi i ndërtimit të objekteve të kundërligjshme.

Mangësi dhe problematika:

1. Makina, Karburant
2. Pajisja me mjete pune për zyrat
3. Fotokopje, skaner
4. Uniforma me logo IKMT

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria e IKMT Elbasan përbëhet nga sektorët si vijon:

- a. Sektori Financës e Shërbimeve Mbështëse
- b. Sektori Inspektimit të Mbrojtjes Territorit
- c. Sektori Inspektimit të Mjedisit e Ujërave
- d. Sektori Inspektimit të Pyjeve

Sektori (emri i sektorit)

- e. Sektori i Mbrojtjes Territorit për periudhën janar – dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: Në parandalimin e objekteve pa leje, në shkelje të lejeve të ndërtimit duke respektuar rregullat për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, kordimini me IMT-Bashki për zbatimin e paligjshmërive dhe informimin institucional;
- f. Sektori i Mjedisit dhe Ujërave për periudhën janar – dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Mbrojtjen e Mjedisit, menaxhimi i integruar i mbetjeve, si dhe menaxhimi i integruar i burimeve ujore;
- g. Sektori i Inspektimit Pyjor për periudhën janar – dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: kanë qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për mbrojtjen në fushën e pyjeve, zonat e mbrojtura dhe gjuetinë.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

- i. Sektori i Mjedisit dhe Ujërave vëren përmirësim në situatën e ndërgjegjësimit të qytetarëve në fushën e mjedisit si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në rang qarku;
- ii. Sektori i Inspektimit Pyjor vëren përmirësim në situatën e ndërgjegjësimit të qytetarëve në fushën e pyjeve, gjuetisë si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional në rang qarku;
- iii. Sektori i Mbrojtjes së Territorit vëren se është rritur bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet IMT-Bashkive të Qarkut, Drejtorisë së Policisë Elbasan në kuadër të Task-Forcës së përbashkët për parandalimin e paligjshmerive.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Prioritet për vitin 2025 për Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë përgatitja dhe planifikimi i masave për Mbrojtjen e Mjedisit, menaxhimi i integruar i mbetjeve, si dhe menaxhimi i integruar i burimeve ujore;
2. Prioritetet kryesore për vitin 2025 janë përgatitja dhe planifikimi i masave për mbrojtjen në fushën e pyjeve, zonat e mbrojtura dhe gjuetinë
3. Parandalimin, zbulimin e goditjen e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
4. Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë me institucionet e tjera, ushtrimi i kontroleve periodike në territorin e Bashkive të Qarkut Elbasan;
5. Verifikimi i ankesave dhe kthimi i përgjigjes brenda afateve kohore sipas legjislacionit në fuqi.
6. Rritja e performancës në punë.

XIII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT BERAT

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Parandalimin, zbulimin e goditjen e veprimtarisë së paligjshmerisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
2. Zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe realizimin e të gjitha inspektimeve të planifikuara për sektorët;
3. Mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut;
4. Kontrolli i zbatimit të dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, faunën e egër veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor nga subjektet private dhe publike;
5. Rritjen e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të IKMT si Qendrore dhe Rajonale, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për:

1. Të minimizojë dhe eliminojë ndërtimet pa leje dhe ndërkohë të kontrollojë respektimin rigoroz të kushteve zhvillimore dhe projekt-zbatimin e objekteve në përputhje të plotë me lejen e dhënë;
2. Të ndërgjegjësojë qytetarët me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe respektimin e plotë të ligjit dhe akteve në zbatim të tij;
3. Të zgjerojë fushën e veprimit të Drejtorisë me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe pyjeve nga krimet mjedisore;
4. Mbarëvajtja e veprimtarisë së institucionit në aspektin administrative dhe financiar.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë Rajonale Berat gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Përgjatë vitit 2024 në Drejtorinë Rajonale Berat janë realizuar 450 inspektime në tre sektorët përkatës;
2. Në Sektorin e Mbrojtjes së Territorit janë realizuar 175 inspektime, prej të cilave 140 janë realizuar në bazë të planit të punës dhe 35 inspektime janë realizuar në kuadër të ankesave dhe informacioneve. Janë mbajtur 7 masa administrative për kundërvajtës në fushën e ndërtimit të paligjshëm;
3. Sektori i Inspektimit në Pyje ka realizuar 147 inspektime, ku 127 inspektime janë kryer në bazë të planit të punës dhe 20 janë realizuar në bazë të verifikimeve/shkresave dhe informacionit të marrë në rrugë operative;
4. Në Sektorin e Mjedisit dhe Ujerave janë kryer 128 inspektime nga të cilat 98 inspektime janë realizuar sipas planit të punës dhe 30 inspektime janë realizuar në bazë të ankesave, shkresave dhe informacioneve të marra. Sektori M/U gjatë kësaj periudhe ka vendosur 14 masa administrative për kundërvajtës.

Risite e vitit 2024:

1. Bashkëpunimi me strukturat Qendrore dhe Vendore;
2. Hartimi i planit të masave të përbashkëta për situatën e zjarrvënies në pyje gjatë periudhës së verës;
3. Inspektimet e kryera në kuadër të Paketës së Sigurisë në shkolla;
4. Inspektimet e kryera për evidentimin e pikave të grumbullimit të skrapeve dhe mjeteve motorrike të dala jashtë përdorimit;
5. Përmirësimi i inspektimeve nga trupa inspektuese;
6. Rritja e numrit të inspektimeve;
7. Rritja e profesionalizmit në ushtrimin e detyrës nga trupa inspektuese;
8. Zhvillimi i takimeve sensibilizuese me strukturat vendore pranë bashkive të Qarkut;
9. Aktivitete të ndryshme në kuadër të mbrojtjes së mjedisit.

Prioritetet:

1. Forcimin e kontrollit të ushtruar nga IKMT në lidhje me ndërtimet në të gjithë territorin nën juridiksion;
2. Goditja e krimeve mjedisore si masë e dosmosdoshme dhe efikase për parandalimin e shkeljeve në mjedis;
3. Rritja e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe vendore. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese në fushën e mjedisit, ujrave, pyjeve me qëllim shkëmbimin e të dhënave, informacioneve për rastet ose/dhe inspektime të përbashkëta në terren;
4. Parandalimin dhe ndëshkimin e subjekteve që çenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mjedisin.

Mangësi dhe problematika:

1. Mungesa e automjeteve 4x4 ka sjellë vështirësi në inspektimet që kryhen në territore të largëta të Qarkut, më së shumti në sektorin e mbrojtjes së mjedisit/ujra dhe sektorin e inspektimit në pyje, për shkak të zonave specifike të thella malore, ku aksesimi me automjet normal është i pamundur.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale Berat përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Territorit.
2. Sektori i Inspektimit të Pyjeve.
3. Sektori i Inspektimit në Mjedis dhe Ujra.
4. Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Inspektimit në Territor për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Inspekte në zonat e rëndësisë së vecantë si zonat e Mbrojtura, zona Muzeale, monumente Kulture, zonat me atraksion të vecantë turistike;
2. Inspekte në akset rrugore nacionale të qarkut Berat në të 5 bashkitë për monitorimin për ndërtime të kundraligjshme përgjatë aksit rrugor;
3. Trajtimin e ankesave të ardhura Online nëpërmjet platformave qeveritare dhe trajtimin e tyre brenda afateve;
4. Bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për rastet e konstatuara nga ana e sektorit;
5. Kontrolli i IMT pranë bashkive si dhe marrja e informacionit prej tyre.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje të numrit të inspekteve në zonat e rëndësisë së vecantë;
2. Rritje të trajtimit efikas të ankesave të adresuara nga qytetarët;
3. Rritja e sipërfaqes territoriale të inspektimit;
4. Shfaqjen problematika vetëm për inspektimet e kryera në zonat e thella të qarkut.

Sektori i Inspektimit të Pyjeve:

Sektori i Inspektimit në Pyje për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Inspekte në zonat e mbrojtura në Parkun Kombëtar Mali i Tomorrit;
2. Inspekte në akset rrugore nacionale të qarkut Berat për monitorimin dhe ndalimin e automjeteve që kryejn transport të paligjshëm të lëndës drurësore;
3. Monitorimin e zonave që paraqesin rrisht të lartë për gjueti të paligjshme në kuadër të Moratoriumit të Gjuetisë;
4. Inspektimin në pyje për konstatimin e rasteve të zjarrëvënies, në bashkëpunim me institucionet relative;
5. Bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për rastet e konstatuara nga ana e sektorit.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje të numrit të inspekteve në zonat e mbrojtura Park Kombëtar;
2. Inspekte më të shpeshta sa i përket kontrollit të gjuetisë së paligjshme dhe respektimin e Moratoriumit të Gjuetisë;
3. Shfaqjen problematika vetëm për inspektimet e kryera në zonat e thella të qarkut pasi mungesa e automjeteve për terren të vështirë, ngadalëson punën për aksesimin e këtyre zonave.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave:

Sektori i Inspektimit të Mjedis Dhe Ujërave për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Inspekte në akset rrugore nacionale të qarkut Berat për monitorimin dhe ndalimin e ndotësve potencial;
2. Inspekte në subjekte që operojnë në fushën e Autoservis, Gomisteri, Mobileri-Zdruktitari;
3. Monitorimin e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit gjatë periudhës së pelegrinazhit, me qëllim parandalimin e ndotjes nga hedhja e lëkurave të kafshëve të therura;
4. Inspektimin në fabrikat e përpunimit të vajit të ullirit gjatë muajve të vjeshtës, sidomos pranë fabrikave në afërsi të shtratit lumor;
5. Inspektimi dhe evidentimi i pikave të grumbullimit të skrapeve dhe mjeteve motorike të dala jashtë përdorimi;
6. Kontroll në subjekte Thertore dhe Pulari;
7. Bashkëpunimin me Policinë e Shtetit për rastet e konstatuara nga ana e sektorit.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje të numrit të inspekteve në subjekte me ndikim në mjedis;
2. Rritje të trajtimit efikas të ankesave të adresuara nga qytetarët;
3. Shfaqjen problematika vetëm për inspektimet e kryera në zonat e thella të qarkut;
4. Problematikë ngelet ndërgjegjësimi qytetar për zbatim të ligjshmërisë në fushën e mjedisit.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

1. Mbajtja në mënyrë korrekte në protokollimin e korrespondencës hyrëse dhe dalëse të institucionit;
2. Raportimi javor, mujor, në lidhje me inspektimet e kryera;
3. Përcjellja e praktikave gjyqësore pranë Drejtorisë Juridike Qendër, gjithashtu dhe njoftimin e vendimeve ndaj subjekteve;
4. Mbajtja dhe dërgimi elektronikisht dhe në formë shkresore çdo muaj i listëprezencës së punonjësve;
5. Dërgimi i faturave postare në IKMT Qendër për likuidimin e tyre;
6. Mbajtja e inventarit të drejtorisë dhe kartelat e inventarit për të gjithë personelin.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Parandalimi i shkeljeve në drejtim të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme;
2. Trajnimi i inspektorëve për procesin e plotësimit të dokumentacionit të inspektimit sipas dispozitave ligjore;
3. Shtimi i kapaciteteve logjistike për kryerjen e inspekteve;
4. Goditja e krimeve mjedisore si masë e dosmosdoshme dhe efikase për parandalimin e shkeljeve në mjedis dhe ndotjen e burimeve ujore, lumenjëve etj;
5. Rritja e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe vendore. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese në fushën e mjedisit, ujrave, pyjeve me qëllim shkëmbimin e të dhënave, informacioneve për rastet ose/dhe inspekte të përbashkëta në terren;
6. Parandalimin e shkeljeve në fushën e pyjeve, mbikqyrjen e zonave të mbrojtura dhe park Kombëtar;
7. Zhvillimi i takimeve ndër-institucionale dhe dëgjuesat me qytetarë me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për shkeljet e kryera në fushën e veprimtarisë së IKMT.

XIV. VEPRIMTARIA DREJTORIA RAJONALE IKMT SHKODËR

Gjatë vitit 2024, për DRIKMT Shkodër, janë përmbushur detyrat institucionale për:

- Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit dhe burimeve ujore.
- Sektori i Inspektimit të Pyjeve është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë në fondin pyjor/kullosor përmes mbikëqyrjes, parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndëshkimit nga ndërhyrjet e kukundërligjshme duke përfshirë edhe mbrojtjen faunës, zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale, eterovajore dhe tanifere.
- Sektori i Inspektimit të Territorit është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë dhe parandalimin e zhvillimeve të paautorizuara, pa leje ndërtimi në territor, të shkeljeve të kushteve të lejeve, kondicioneve urbane dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit.
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është fokusuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, në aspektin administrativ dhe financiar, për trajtimin e informacioneve, praktikave dhe procedurave të ardhura, në funksionimin optimal të shërbimeve mbështetëse e logjistike.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për :

1. Forcimin e kontrollit të ushtruar nga IKMT në lidhje me ndërtimet në të gjithë territorin nën juridiksion;
2. Forcimin e bashkëpunimeve me IMT-të, pranë Njësive Vendore, me Policinë e Shtetit;
3. Bashkëpunimi me grupet e punës së ngritur nga IKMT, Qendër;
4. Parandalimin e ushtrimit të aktivitetit nga subjektet pa leje mjedisore përkatëse;
5. Parandalimin dhe ndëshkimin e subjekteve që çenojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mjedisin;
6. Kryerja e inspektimit online në subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre me ndikim në mjedis dhe ujra;
7. Ka monitoruar dhe kontrolluar territorin e Qarkut Shkodër, për mbrojtjen e territorit dhe lumenjve nga ndotjet mjedisore, shkarkimet dhe ndërhyrjet e kukundërligjshme;
8. Mbrojtjen e pyjeve nga ndërhyrjet e kundërligjshme;
9. Mbarëvajtja e veprimtarisë së institucionit në aspektin administrative dhe financiar;
10. Mbajtja e protokollit;
11. Hartimi i listprezencës ditore dhe listprezencës mujore të punonjësve;
12. Përfaqësimi në çështjet gjyqësore të DRIKMT Shkodër me autorizim nga Kryeinspektori.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të Drejtorisë Rajonale IKMT Shkodër gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Zbatimi i planeve mujore, në plotësimin e detyrave të ngarkuara;
2. Monitorimi dhe kontrolli për parandalimin e zhvillimit të paligjshmërive;
3. Bashkëpunimi me IKMT, Qendër dhe institucione si IMT, Policia e Shtetit, Agjensia Rajonale e Mjedisit, ADZM etj;
4. Trajtimi i ankesave të ardhura me (shkresa, email-e), ndjekja e tyre deri në zgjidhje përfundimtare dhe kthim përgjigjja e tyre.

Risite e vitit 2024:

1. Përmirësimi i inspektimeve nga trupa inspektuese;
2. Rritja e profesionalizmit në ushtrimin e detyrës nga trupa inspektuese;
3. Trajtimin e problematikave dhe komunikimet me IKMT Qendër në mënyrë shkresore dhe elektronike;

4. Në kuadër të operacionit “Bregdeti Ynë” dhe Urdhërave të Kryeinspektorit, në bashkëpunim me grupin e punës së IKMT Qendër u bë evidentimi dhe kontrolli i subjekteve të ngritura përgjatë vijës bregdetare në plazhin e Velipojës.

Mangësi dhe problematika :

1. Problematikë nga ana e inspektorëve të sektorit të inspektimit Pyjorë Drejtoria Rajonale Shkoder, pengesat në kryerjen e punës në mënyre sa më efikase nga ana jonë është pjesa e infrastruktures pasi ekonominë pyjore në të cilat ka edhe dëmtimet më të mëdha janë në zona rurale shumë të thella dhe me rrugë të pa kalueshme nga mjeti që kemi në dispozicion, gjithashtu problematikë e vazhdueshme për kryerjen e detyrave funksionale është edhe mungesa e karburantit;
2. Problematika nga ana e inspektorëve të Sektorit të Territorit janë hasur në lidhje me identifikimin e subjekteve posedues në prona të inspektuara;
3. Marrja e informacioneve nga autoritetet planifikuese dhe inspektuese të qeverisjes vendore në lidhje me dokumentacionin mbi ligjshmërinë e objekteve/ndërtimeve të inspektuara;
4. Ndërgjegjësimi i subjekteve apo individëve në respektimin e legjislacionit në fuqi sidomos në fushën e ndërtimeve, bashkëpunimi me Drejtoritë e Policive, si dhe mungesa e logjistikës,veçanërisht ajo e transportit;
5. Problematika nga ana e inspektorëve të sektorit të mjedisit janë hasur në indentifikimin e subjekteve kundravajtës;
6. Mungesa e miratimit të akteve të konstatimit të kundravajtjes persa i përket Sektorit të Inspektimit të Pyjeve.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale e IKMT Shkodër përbëhet nga sektorët si vijon:

- Sektori i Inspektimit të Territorit;
- Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave;
- Sektori i Inspektimit të Pyjeve;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Inspektimit të Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Gjatë muajit janar:

Janë realizuar 8 inspektime. Nisur nga rastet e përcjella nga Komisariati i Policisë Shkodër është ushtruar kontroll:

- Subjektin Sajmir Brankaj,ku është mbajtur PVK Nr 24;
- Subjektin Kin Lazër Thaçina ku është mbajtur PVK NR 26,27, 28,29;
- Subjektin Rrok Zhari ku është mbajtur PVK Nr 25;
- Në zbatim të planit të punës është ushtruar kontroll në zonën e Velipojës në fshatrat Reç i Vjetër, Reç i Ri, Sektor dhe Pulaj- Plazh;
- Janë administruar 4 ankesa nga ku i jemi drejtuar IMT Bashkia Shkodër për kompetencë.

Gjatë muajit shkurt:

Janë realizuar 15 inspektime. Gjatë kontrollit në zonën e Thethit, Njësia Administartive Shalë, Bashkia Shkodër janë mbajtur 3 PVKK:

- Subjekti Pllumb Harusha ku është mbajtur PVK Nr 1;
- Subjektin Kolë Zallinaj është mbajtur PVK Nr 22;
- Subjektin Bledar Fahri Lekaj është mbajtur PVK Nr 21;
- Në zbatim të Urdhërit të Kryeinspektorit është ushtruar kontroll afër pikave doganore Hani i Hotit dhe Muriqan;
- Afër pikës Hani i Hotit, Bashkia Malësi e Madhe janë konstatuar 5 tabela reklamuese dhe 1 kioskë, ku dhe janë mbajtur 6 PVK;
- Afër pikës doganore Muriqan, Bashkia Shkodër janë konstatuar 11 tabela reklamuese dhe 2 kioska pa deklarata paraprake. Janë mbajtur 13 PVK;
- Janë administruar 4 ankesa nga qytetarët për ndërtime pa leje.

Gjatë muajit mars:

Janë realizuar 17 inspektive.

- Është bërë riinspektim afër pikës doganore Hani i Hotit, ku janë evidentuar 3 tabela reklamuese dhe 20 kioska pa deklarata paraprake. Janë mbajtur 23 PVKK. Janë rimbajtur 8 PVK;
- Gjatë kontrollit në zonën e Thethit, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër është mbajtur 1 PVKK ndaj subjektit Kolë Vat Gjeloshi;
- Gjatë kontrollit në zonën e Bogës, Bashkia Malësi e Madhe është mbajtur 1 PVKK ndaj subjektit Asar Bashi;
- Është administruar 1 ankesë nga qytetari për ndërtim pa leje. Në trajtim të ankesës i jemi drejtuar IMT-së Bashkia Shkodër.

Gjatë muajit prill:

Janë realizuar 59 inspektive.

- Në zbatim të Urdhërit Nr 373 të Kryeinspektorit është ushtruar kontroll në zonën e plazhit Velipojë për evidentimin e ndërtimeve pa leje dhe/ose në shkelje të kushteve të lejes (të beach bareve);
- Gjatë kontrollit janë evidentuar 33 objekte pa leje. Janë mbajtur 33 PVK. Në mbështetje të IKMT Qendër është bërë ekzekutimi i vendimeve të prishjes;
- Nisur nga rastet e përcjella nga Komisariati i Policisë Shkodër është ushtruar kontroll në zonën e Thethit. Është mbajtur PVK Nr 27 ndaj subjektit Sebastiano Mali si dhe është mbajtur PVK Nr 26 ndaj subjektit Kolë Vat Gjeloshi;
- Janë administruar 4 ankesa. Dy nga ankesat iu është kthyer përgjigje nga ana jonë ndërsa për 2 të tjerat i jemi drejtuar IMT- së, Bashkia Shkodër.

Gjatë muajit maj:

Janë realizuar 14 inspektive.

- Në zbatim të planit të punës është ushtruar kontroll në territorin e bashkisë Shkodër. Është mbajtur PVK me Nr 1 me subjekt të paidentifikuar. Gjithashtu është ushtruar kontroll në vijën bregdetare të Plazhit të Velipojës në lidhje me beach baret ku nuk u konstatuan beach bare në ndërtim e sipër;
- Është ushtruar kontroll në zonën e Rrjollit Njesia Administrative Velipojë , është mbajtur PVK me Nr 5 ndaj subjektit Andis Danaj;
- Në bashkëpunim me sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave është ushtruar kontroll në territorin e Bashkisë Shkodër në zbatim të urdherit të Prefektit të Qarkut Shkodër lidhur me perimetrin e sigurisë në shkollë;
- Është ushtruar kontroll në fashtin Zues nisur nga rasti i përcjellë nga IMT Bashkia Shkodër. Është mbajtur PVK me Nr 3;

- Nisur nga rasti i përcjellë nga Komisariati i Policisë Shkodër është ushtruar kontroll në subjektin Sebastiano Mali në zonën e Thethit është mbajtur PVK me Nr 2.
- Është rimbajtur PVK ndaj subjektit Kin Lazër Thaçina;
- Janë administruar 3 ankesa. Dy nga ankesat iu është kthyer përgjigje nga ana jonë ndërsa për 1 i jemi drejtuar IMT-së, Bashkia Shkodër.

Gjatë muajit qershor:

Janë realizuar 13 inspektive.

- Në zbatim të planit të punës është ushtruar kontroll në plazhin e Velipojës në bashkëpunim me IMT-në. Gjatë kontrollit të ushtruar përgjatë vijes bregdetare nga pjesa e pedonale dhe në rërë nuk u konstatua asnjë ndërtim i beach bareve;
- Nisur nga rasti i përcjell nga Komisariati i Policisë Shkodër për ndërtim pa leje në fshatin Mollë në vëndin e quajtur Lumi i Shalës është ushtruar kontroll në bashkëpunim me IMT. Nga ana e IMT-së është mbajtur PVK ndaj subjektit Ndue Zef Kodrari;
- Është ushtruar kontroll në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe është mbajtur PVK me nr 7 me subjekt të paidentifikuar për kundërvajtjen e konstatuar në fshatin Bogë;
- Janë administruar 4 ankesa. I jemi drejtuar IMT-së, Bashkia Shkodër për kompetencë.

Gjatë muajit korrik:

Janë realizuar 9 inspektive.

- Është ushtruar kontroll në fshatin Bugjon, Njësia Adm. Fierzë, Bashkia Fushë Arrëz nisur nga shkresa e Komisarariatit të Policisë Pukë. Është mbajtur PVK Nr.8;
- Është ushtruar kontroll në hyrjen e qytetit të Shkodrës për azhurnimin e objekteve që preken nga projekti i rikualifikimit të hyrjes së qytetit. Gjatë azhurnimit janë evidentuar 22 objekte. Korrespondencë me IMT Bashkia Shkodër dhe ASHK lidhur me këto objekte;
- Janë administruar 7 ankesa. 1 nga ankesat iu është kthyer përgjigje nga ana jonë.

Gjatë muajit gusht:

Janë realizuar 6 inspektive.

- Është ushtruar kontroll në trajtim të ankesave të administruara pranë DRIKMT Shkodër (3 ankesa);
- Janë administruar 7 ankesa.

Gjatë muajit shtator:

Janë realizuar 8 inspektive.

- Nisur nga rasti i përcjell nga Komisariati i Policisë Shkodër është ushtruar kontroll në subjektin Kolë Vatë Gjeloşi. Është mbajtur PVK me Nr. 9;
- Gjatë inspektimit në fshatin Theth është konstatuar ndërtim pa leje dhe është mbajtur PVK ndaj subjektit Nikë Harusha me Nr 16;
- Gjatë inspektimit në fshatin Bogë është konstatuar ndërtim pa leje dhe është mbajtur PVK ndaj subjektit Ded Vrucaj me Nr 17.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit të Pyjeve, Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave dhe IKMT Qendër është bërë monitorimi i hyrjes së qytetit të Shkodrës dhe bregut perendimor të Liqenit të Shkodrës lidhur me objektet që preken nga projekti i hyrjes së qytetit. Janë mbajtur 6 PVK;
- Janë administruar 6 ankesa.

Gjatë muajit tetor:

Janë realizuar 3 inspektive.

- Nisur nga shkresa e ardhur nga IKMT Qendër për rivefikimin e situatës faktike ndërtimore në terren të objektit të konstatuar nga DRIKMT Shkodër në fshatin Bogë, është bërë rivefikimi ku është konstatuar kundërvajtja administrative “ndërtimi i një platforme druri dhe konstrukti metalik pa deklarim paraprak” nga subjekti Ded Vruçaj. Subjekti ka vazhduar punimet duke përfunduar ndërtimin e objektit. Është mbajtur Proçes - Verbal Nr 17;
- Janë administruar 7 ankesa.

Gjatë muajit nëntor:

Janë realizuar 3 inspektive.

- Gjatë muajit nëntor janë realizuar 3 inspektive nisur nga rasti i përcjellë nga ADZM, komisariati i Policisë Shkodër dhe nga 1 ankesë;
- Janë administruar 2 ankesa.

Gjatë muajit dhjetor:

Janë realizuar 2 inspektive.

- Është ushtruar kontroll në zonën e Thethit në trajtim të denoncimit të përcjell më anë të aplikacionit “WhatsApp”;
- Është ushtruar kontroll në trajtim të rastit të përcjell nga Komisariati i Policisë Shkodër.
- Janë administruar 2 ankesa.

Periudha për të cilën kërkohen të dhënat			
janar- dhjetor 2024			
Periudha	Inspektive Territor	PVK	Ankesat
Janar	8	6	4
Shkurt	15	22	4
Mars	17	33	1
Prill	59	35	4
Maj	14	6	3
Qershor	13	1	4
Korrik	9	1	7
Gusht	6		7
Shtator	8	9	6
Tetor	3	2	7
Nëntor	3		2
Dhjetor	2	0	2
TOTAL	157	115	45

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave:

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Gjatë muajit janar:

- Janë realizuar 5 inspektime, janë ushtruar kontrole mbi menaxhimin e mbetjeve në Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vau - Dejës. Për të cilat i jemi drejtuar bashkive përkatëse për marrje masash;
- Është administruar 1 ankesë.

Gjatë muajit shkurt

- Janë realizuar 11 inspektime. Në kuadër të Urdhërit nr.44 datë 16.02.2024 "Për marrjen e masave të menjëhershme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore", u morën masa të menjëhershme për zbatimin e këtij urdhëri;
- U bë njoftimi i të gjitha subjekteve për lirin vullnetar të hapsirave, ju kërkua distancë në jo më pak se 1 km përgjatë autostradës, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore;
- Janë mbajtur 2 vendime përfundimtare me gjobë:
- Subjektin Pllumb Gjergj Harusha;
- Subjektin Hane Ndue Ndrejaj;

Gjatë muajit mars:

- Janë realizuar 24 inspektime në zbatim të Urdhëtit të Ministrit nr. 44 datë 16.02.2024 në lidhje me pikat e grumbullimit të mjeteve motorrike;
- Janë identifikuar 37 subjektel;
- Janë kryer 31 ekzekutime vullnetare;
- 6 subjektet janë të paisur me leje mjedisore.

Gjatë muajit prill:

- Janë realizuar 9 inspektime;
- Inspektim në fshatin Pulaj Velipojë për grumbuj me mbeturina inerte në ane të rrugës nacionale Shkodër - Velipojë. Për të cilat i jemi drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Policisë Vendore për marrje masash;
- Ushtrimi i kontrollit në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ujrave nga ndërhyrjet e kundërligjshme, si dhe në zbatim të urdhërit të Prefektit të Qarkut Shkodër lidhur me perimetrin e siguris në shkolla, u bë verifikimeve në terren në shkollat e Bashkisë Shkodër, nga ku nuk u konstatuan mbetje në perimetrin e sigurisë;
- Në zbatim të urdhërit të Kryeinspektorit nr 373 date 17.04.2024 “ Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve” në bashkëpunim me IKMT Qendër është bërë evidentimi i objekteve pa leje (beach bare) në zonën e plazhit Velipojë.

Gjatë muajit maj:

- Janë realizuar 10 inspektime;
- U inspektua zona e argjaturës në afërsi të fshatit Juban. Gjatë inspektimit nuk u gjenden subjekte duke gërmuar. I jemi drejtuar me shkresë policisë për identifikimin e subjekteve kundërvajtës;
- Në zbatim të paketës së sigurisë në shkolla u bë verifikimeve në terren në shkollat e Qarkut Shkodër, nga ku nuk u konstatuan mbetje në perimetrin e sigurisë.

Gjatë muajit qershor:

- Janë realizuar 10 inspekte;
- Në zbatim të paketës së sigurisë në shkollë u bë verifikimeve në terren në shkollat e Qarkut Shkodër, nga ku nuk u konstatuan mbetje në perimetrin e sigurisë;
- Në zbatim të listës së subjekteve të miratuar nga Inspektoriati Qëndror janë lëshuar autorizime për kontroll të 5 subjekteve në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Është ushtruar kontroll në plazhin e Velipojës mbi menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujrave të ndotura;
- Është administruar 1 ankesë.

Gjatë muajit korrik:

- Janë realizuar 11 inspekte;
- Trajtimin e shkresës së ardhur nga IKMT Qendër lidhur me krimet mjedisore shkaktuar nga mbetjet e nënprodukteve shtazore ku u inspektuan subjektet në territorin e Shkodrës të cilat merren me aktivitet prodhime shtazore të cilat rezultuan komfort rregullave mjedisore dhe legjislacionit në fuqi;
- Në zbatim të listës së subjekteve të miratuar për muajin korrik nga Inspektoriati Qëndror janë lëshuar autorizime për kontroll të 7 subjekteve në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Në mbështetje të Sektorit të Inspektimit të Teritorit mbi azhurnimin e zonës ku do të zbatohet plani i rikualifikimit të hyrjes së qyteti të Shkodrës u morën masa për kryerjen e evidentimit dhe inspektimit të objekteve që bëhen pengesë për realizimin e këtij projekti.

Gjatë muajit gusht:

- Janë realizuar 10 inspekte;
- Në zbatim të listës së subjekteve të miratuar për muajin gusht nga Inspektoriati Qëndror janë lëshuar autorizime për kontroll të 8 subjekteve në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Është ushtruar kontroll në plazhin e Velipojës mbi menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujrave të ndotura. Ku u konstatu se subjektet kishin lidhur kontrata me subjekte të liqensuara për trajtimin e mbetjeve si dhe kontrat me KUZ dhe UK për trajtimin e ujrave të zeza;
- Trajtimin e shkresës së ardhur nga IKMT Qendër lidhur me dy eskavator të evidentuar brenda shtratit të lumit Buna. Ku rezultoi se kishte gjurmë mbetjesh por nuk kishte mjete eskavator në vendin si pas kordinatave. I jemi drejtuar Drejtoris Vendore Policisë Shkodër për identifikimin e kundravajtësve.

Gjatë muajit Shtator:

- Janë realizuar 4 inspekte;
- Është ushtruar kontroll mbi ankesën e ardhur nga shtetasi Gëzim Murati mbi kanalizimin e ujrave të zeza të shkaktuara nga komshiu. I jemi drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Ujshjelles Kanlizimeve Shkodër për marrje masash;
- Trajtim i ankesës së ardhur mbi ndotjen e mjedisit nga fabrika e bakrit, bashkia Fushë-Arrëz;
- Në zbatim të planit mujor për ndërhyrjet e paligjësme të lumit Buna nga germimet për nxjerrje inertesh u monitorua vendi i quajtur Obot. Nga verifikimi rezultoi se këtu pasur nxjerrje të autoveturave, por në momentin e inspektimit nuk u gjetën autor;
- Në zbatim të planit mujor mbi menaxhimin e mbetjeve urbane në brigjet e lumit Kir, u monitorua vendi në afërsi të Varrezave të Dëshmorëve si dhe në lagjen Tepe buzë lumit Kir ku u konstatua hedhje mbetjesh urbane. Gjatë kontrollit nuk u konstatua ndonjë person apo automjet duke hedhur;
- Janë administruar 2 ankesa.

Gjatë muajit tetor:

- Është realizuar 1 inspektim;
- Ushtrimi i kontrollit, monitorimit të brigjeve të lumit Kir dhe lumit Buna mbi menaxhimin e mbetjeve;
- Ushtrimi i kontrollit në zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe ujrave nga ndërhyrjet e kundërligjshme, si dhe në zbatim të urdhërit të Prefektit të Qarkut Shkodër lidhur me perimetrin e sigurisë në shkolla. Me datë 08.10.2024 u inspektuan shkolla 9-vjeçare “Veli Tela”, Moriçan. Nuk u konstatuan probleme në lidhje me perimetrin e sigurisë. U inspektua shkolla 9-vjeçare “Hasan Dardhanjori”, e cila ka probleme me perimetrin e sigurisë në krahun e majtë anësor është rrëzuar gardhi dhe bëhet e mundur hyrja nga jashtë e personave të pa autorizuar. U inspektua gjimnazi “Idriz Hoxha”, Oblike nuk ka probleme me perimetrin e sigurisë;
- Ushtrimi i kontrollit monitorimit, evidentimit të rasteve të ndërhyrjeve të paligjshme në brigjet e lumit Drin, nisur nga denoncimi i ardhur në aplikacionin WhatsApp;
- Është administruar 1 ankesë.

Gjatë muajit nëntor:

- Janë realizuar 2 inspektime;
- Ka ushtruar kontroll në subjektin Albert Gjoni me NIPT L17213003G bazuar mbi shkresën e ardhur nga ARM Shkodër, Lezhë, Kukës;
- Ka ushtruar kontroll në zbatim të Urdhërit të Kryeinspektorit për verifikimin e subjekteve që operojnë në Qarkun Shkodër;

Gjatë muajit dhjetor:

- Eshtë realizuar 1 inspektim;
- Grupi i inspektimit ka ushtruar kontroll në subjektin Albert Gjoni, ku është konstatuar se nuk disponon leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit lryje dhe lustrim makinash. Është mbajtur masa administrative me gjobë me vlere 650000 leke si dhe pezullim aktiviteti;
- Është administruar 1 ankesë.

Tabela e masave administrative të mbajtura nga SIMU Shkodër.

Periudha për të cilën kërkohen të dhënat			
Janar- Dhjetor 2024			
Periudha	Inspektime Mjedisi dhe Ujrave	Masat Administrative	Ankesat
Janar	5		1
Shkurt	11	2	
Mars	24		
Prill	9		
Maj	10		
Qershor	10		1
Korrik	11		
Gusht	10		
Shtator	4		2
Tetor	1		1
Nentor	2		
Dhjetor	1	1	1
TOTAL	98	3	6

Nr.	Emri subjektit	Dënim kryesor me gjobë/Lekë	Dënim plotësues	Urdhër sekuestro
1.	Pllumb Gjergj Harusha	1,000,000	-	-
2.	Hane Ndue Ndrejaj	1,000,000	-	-
3.	Albert Gjoni	650,000	Pezullim i aktivitetit	-

Sektori i Inspektimit të Pyjeve:

Sektori i Inspektimit të Pyjeve për periudhën janar – shtator 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Gjatë muajit janar:

Në total janë realizuar nga SIP, 9 inspektime, objekti i inspektimit ishte gjueti e paligjshme konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në malin Kolej, Hajmel Nenshat dhe fushat e Bunës, Drin, Gjadër, Kir.

Gjatë muajit shkurt:

Për muajin shkurt në total janë realizuar nga SIP, 6 inspektime, objekti i inspektimit ishte gjueti e paligjshme konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Bushat Bërdicë, Koplik, Gruemir, Tarabosh dhe ekonomia Bajz Hot.

Gjatë muajit mars:

Për muajin mars në total janë realizuar nga SIP, 10 Inspektime, objekti i inspektimit ishte gjueti e paligjshme dhe nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Bushat - Berdica, Drin - Gjadër - Kir, rezervuati i Velipojës, Bzhet - Dedaj si dhe në akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht në aksin rrugor Ura e Mesi Domen prekal drisht, Dedaj Razem Bogë, Vau - Dejes - Koman -Pukë.

Gjatë muajit prill:

Për muajin prill në total janë realizuar nga SIP, 8 inspektime, objekti i inspektimit ka nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Malin e Kakarriqit, Maja e Zezë, Pruemosh Sheldi, Kastrat Zagor, si dhe në akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht në aksin rrugor Ura e Mesi Domen- Prekal -Drisht, Dedaj – Razem - Bogë, Vau - Dejes- Koman - Pukë.

Gjatë muajit maj:

Gjatë muajit maj në total janë realizuar nga SIP, 8 inspektime, objekti i inspektimit ka nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Karm, Tarabosh, Brigjet e Bunës , Bogë dhe ekonomitë pyjore Gomsiqe, si dhe në akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht aksin rrugor Ura e Mesi Domen - Prekal - Drisht, Dedaj – Razem - Bogë, Hot – Tamarë - Vermosh.

Gjatë muajit qershor:

Për muajin qershor në total janë realizuar nga SIP, 9 inspektime, objekti i inspektimit ka nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore konkretisht në Ekomit Pyjore/Kullosore, Rosek-Drisht, Shllak 1, Broj 2, Lugina e Cemit, si dhe në

akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht aksi rrugor Ura e Mesi Domen- Prekal -Drisht, Dedaj- Razem- Bogë, Hot-Tamarë- Vermosh, Laç Vau – Dejës - Koman – Pukë.

Gjatë muajit korrik:

Për muajin korrik në total janë realizuar nga SIP, 16 inspektime, objekti i inspektimit ka nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Bajz - Hot, Hajmel - Nenshat, Vukel - Nikç, Kryezi - Bicaj, si dhe në akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht aksi rrugor Ura e Mesi Domen - Prekal -Drisht, Dedaj – Razem - Bogë, Hot - Tamarë - Vermosh, Laç Vau - Dejës - Koman -Pukë.

Gjatë muajit gusht:

Për muajin gusht në total janë realizuar nga SIP, 8 inspektime, objekti i inspektimit ka nderhyrje në fond pyjor dhe transport të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore konkretisht në ekonomitë pyjore/kullosore në Kastrat - Zagorë, Drin - Gjadër - Kir, Gomsiqe si dhe në akset rrugore mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor konkretisht aksi rrugor Ura e Mesi Domen - Prekal - Drisht, Dedaj – Razem - Bogë, Hot – Tamarë - Vermosh, Laç Vau - Dejës - Koman - Pukë, si dhe Shkodër -Rragam.

Gjatë muajit shtator:

Për muajin shtator janë realizuar 9 kontrolle bazuar në Planin e Punës të muajit shtator për parandalimin dhe goditjen e ndërhyrjeve të paligjshme në fond pyjor/kullosor në rrugë auto mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore në Qarkun e Shkodër.

Gjatë muajit tetor:

Për muajin tetor janë realizuar 2 kontrolle për parandalimin dhe goditjen e ndërhyrjeve të paligjshme në fond pyjor/kullosor në rrugë auto mbi transportin e paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të dyta pyjore në Qarkun e Shkodër.

Gjatë muajit nëntor:

Për muajin nëntor është realizuar një inspektim në ekonominë pyjore/kullosore “Bogë”, për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e kundravajtjeve në fond pyjore.

Qarku	Numëri i Inspektimeve dhe Shkresa			Kundrava jtte Penale		Kundravajtje e Administrat ive		Material drusor i sekuestruar		Të dhënat operative për zjarret në pyje dhe kullota			
	Total	Në fondin Pyjor/Kullosor. Në Rugët Auto	Të tjera (Shkresa)	Raste	Vlera e dëmit në 000/lek	Raste	Vlera e gjobave në lek/000	Raste	Sasia në (mst)	Gjithësejtë (Raste)	ipërfaqe e përshkruar në pyje në (ha)	përfaqe e djegur në pyje në (ha)	ënie pushtim Fond pyjor (m³)
Shkodër	105	85	20	-	-	-	-	-	23	2	3640	79	130

Shuma	105	85	20	-	-	-	-	23	2	3640	79130
-------	-----	----	----	---	---	---	---	----	---	------	-------

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Trajnimi i inspektorëve për procesin e plotësimit të dokumentacionit të inspektimit sipas dispozitave ligjore;
2. Shtimi i kapaciteteve logjistike për kryerjen e inspektimeve;
3. Ulja e numrit të ndërtimeve pa leje në territor;
4. Rritja e mbrojtjes së mjedisit dhe pyjeve në vend;
5. Rritja e bashkëpunimit me IMT-të në të gjithë territorin e vendit;
6. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes së mjedisit dhe ujrave;
7. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes së pyjeve.

XV. VEPRIMTARIA E DREJTORISË DREJTORIA RAJONALE IKMT Durrës

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Parandalimin, zbulimin e goditjen e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
2. Janë kryer inspektime periodike gjatë vijës bregdetare, si zone me prioritet me qëllim, evidentimin, parandalimin dhe ndëshkimin e subjekteve të cilët janë konstatuar me shkelje.
3. Koordinimi i punës me IKMT Qendër, si dhe realizimi i aksioneve të përbashkëta, në zbatim të detyrave funksionale;
4. Bashkërendimi i veprimeve me Njësitë Administrative dhe Policinë e Shtetit;
5. Verifikime problematikash dhe ankesash;
6. Monitorim në lidhje me verifikimin e situatës në perimetrin e sigurisë së shkollave për depozitimin e mbetjeve inerte dhe urbane, si dhe respektimin e standardeve të sigurisë së kantjereve në objektet në ndërtim sipas Urdhërit të Ministrit.
7. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji, ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
8. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
9. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut;
10. Inspektime për konstatimin e gjuetisë së paligjëshme, në zbatim të moratoriumit të gjuetisë;
11. Inspektime për konstatimin e subjekteve që kanë zënë në mënyrë të paligjëshme sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullosor;
12. Inspektime në rrugët auto-pyjore, nacionale për evidentimin e transportit të paligjshëm të materialeve drusorë dhe atyre me origjinë fondin pyjor.
13. Përfaqësim juridik dhe mbrojtje e interesave të institucionit në gjykatë.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për :

1. Zbatimin e Urdhërit të Kryeinspektorit, Nr.373, datë 17.04.2024 "Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve", për subjektet që ushtrojnë aktivitetin "beach bar" në vijën bregdetare të Durrësit;
2. Zbatimi i Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.44 datë.16.02.2024, "Për marrjen e masave të menjëhershme për evidentimin, ndalimin e krijimit dhe mbylljen e vendgrumbullimit të mjeteve motorrike, rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit në një distance jo më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare në të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë";

3. Rritjen e cilësisë së inspektimeve dhe praktikave me qëllim rritjen e aftësisë parandaluese dhe kontrollin në të mirë të territorit;
4. Grumbullimi i informacionit në lidhje me fushat e veprimit të sektorëve të IKMT nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional me strukturat përkatëse;
5. Koordinimi i punës me shoqerine koncensionare "G2 Infra" dhe IKMT Tiranë në lidhje me marrjen e masave dhe realizimin e hapave konkrete me fokus ndërhyrjen për identifikimin, dhe shembjen e 22 objekteve të cilat ishin pengesë në realizimin e projektit, për ndërtimin e aksit rrugor "Autostrada Thuman - Kashar";
6. Vijimi i inspektimeve në objektet arsimore, me qëllim zbatimin e Urdhërit të Ministrit për perimetritin e sigurisë në objektet arsimore, ku janë zhvilluar me një frekuencë të lartë, dhe të shpeshtë në të gjitha objektet arsimore të Qarkut Durrës;
7. Monitorim dhe marrja e masave për evidentimin dhe parandalimin e ndërtimeve në vijën bregdetare si zonë me rëndësi të vecantë;
8. Objektivi tjetër i realizuar është mbajtja e korrespondencës shkresore me IMT e Bashkive Durrës, Krujë dhe Shijak, me fokus shkëmbimin e informacionit si dhe delegimin e ankesave të ndryshme të ardhura në adresë të IKMT në rrugë elektronike dhe postare;
9. Bashkëpunim me institucionet relevante në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë Rajonale IKMT Durrës gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Totali i numrit të inspektimeve është 483, që në krahasim me treguesin e vitit 2023, kemi një dyfishim të numrit të verifikimeve/inspektimeve dhe monitorimeve me frekuencë më të lartë;
2. Totali i masave të marra për rastet në të cilat është konsultuar kundërvajtje është përkatësisht:
 - 24 Masa administrative me dënim me gjobë;
 - 2 Kallëzime penale;
 - 1 Paralajmërim subjekti
3. Në bashkëpunim me IKMT Tiranë është zhvilluar aksioni për shembjen e objekteve të cilat prekeshin nga gjurma e projektit të ndërtimit të shëtitorës së Plazhit Durrës, po ashtu është bërë ndërhyrja për shembjen e objekteve të cilat prekeshin nga ndërtimi i aksit rrugor "Autostrada Thumanë-Kashar". Objekte të shpronësuara sipas VKM Nnr.332 datë 31.05.2023 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive që preken nga realizimi i projektit "Aksi rrugor Thumanë-Kashar".

Risite e vitit 2024:

1. Përmirësimi dhe unifikimi i praktikave të inspektimit nëpërmjet standartizimit të procesit të inspektimit duke konkluduar dhe vënë në dispozicion palëve relacionin e detajuar në lidhje me vijueshmërinë dhe me gjetjet e inspektimit, sipas formateve përkatëse të hartuara nga Drejtoria Qendrore e IKMT Tiranë;
2. Qasja sensibilizuese në frymën e ndryshimeve ligjore, me fokus dhe prioritet këshillimin e subjekteve për përmbushjen e kriterëve ligjore, në përputhje edhe me ndryshimet e parashikuara nga Ligji nr 99, viti 2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë". Në këtë ligj për herë të parë është parashikuar si dënim administrativ kryesor "Paralajmërimi" në inspektimin e parë të trupës inspektuese në subjekt, në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative.

Mangësi dhe problematika :

1. Problematikë sa i përket Sektorit të Inspektimit të Territorit mbetet bashkëpunimi dhe trajtimi i rasteve të përcjella për trajtim IMT. Kjo, për arsye se në mënyrë të përsëritur, vecanërisht IMT-

Bashkia Krujë, nuk i trajtojnë/kthejnë përgjigje brenda afateve ligjore ankesat e përcjella për kompetencë;

2. Përsa i përket Sektorit Pyjor, mungon bashkëpunimi me instancat e Njësive të qeverisjes vendore dhe atyre të Zonave të Mbrojtura. Bashkitë nuk kanë ngritur strukturën e inspektimit pyjor referuar Ligjit 57/2020 dt 30.04.2020 "Për pyjet". Në Ligj janë theksuar të gjithë kompetencat e Bashkive si për ruajtjen e fondit pyjor, ashtu edhe për inspektimin si akt administrativ. Mos funksionimi i sektorëve të pyjeve në Bashki. Mungesa e bashkëpunimit me ADZM.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Organika e IKMT- Drejtorisë Rajonale Durrës është e organizuar në këtë mënyrë:

1. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Durrës;
2. Sektori i Inspektimit të Territorit, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 3 specialistë /inspektorë;
3. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 8 specialistë/ inspektorë;
4. Sektori i Inspektimit Pyjor, i cili përbëhet nga 1 përgjegjës sektori dhe 4 specialistë/ inspektorë;
5. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë;

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Inspektimit të Territorit për periudhën Janar - Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Parandalimin, zbulimin e goditjen e veprimtarisë së paligjshmërisë për në fushën e kontrollit dhe siplinimit të ndërtimeve duke marrë masa në rastet kur janë konsultuar paligjshmëri në ndërtim dhe shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
2. Hartimi i Planeve të Veprimtari për identifikimin e subjekteve të cilat ushtrojnë funksionet e strukturave të shërbimit përgjatë plazheve që janë në juridiksionin e IKMT Durrës;
3. Gjithashtu kanë vijuar inspektimet në objektet arsimore, me qëllim zbatimin e Urdhërit të Ministrit për perimetrin e sigurisë në objektet arsimore, verifikime të cilat, janë zhvilluar me një frekuencë të lartë, dhe të shpeshtë në të gjitha objektet arsimore të Qarkut Durrës.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje të disa treguesve të punës, si më poshtë:

Koordinimi i punës me IKMT Qendër, si dhe realizimi i aksioneve të përbashkëta, në zbatim të detyrave funksionale, si:

1. Gjatë muajit Janar është kryer ndërhyrja për shembjen e objekteve të shpronësuar sipas VKM-së nr nr.717 datë 13.12.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr.332 datë 31.05.2023 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive që preken nga realizimi i projektit "Aksi rrugor "Thumanë-Kashar". Në total janë ekzekutuar 22 objekte. 1- PVKK e cila i është përcjellë për vijimin e mëtejshëm të procedurave IKMT Tiranë;
2. Gjithashtu kanë vijuar inspektimet në objektet arsimore, me qëllim zbatimin e Urdhërit të Ministrit për perimetrin e sigurisë në objektet arsimore, verifikime të cilat, janë zhvilluar me një frekuencë të lartë, në të gjitha objektet arsimore të Qarkut Durrës;
3. Zbatim të Urdhërit të Kryeinspektorit, Nr.373, datë 17.04.2024 "Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve", pas hartimit të plan-veprimtari gjatë sezonit turistik nga DRIKMT Durrës, janë kryer inspektime dhe monitorime të herë pas herëshme, përgjatë vijës bregdetare, ku si rrjedhojë janë evidentuar dhe kanë qenë objekte kontrolli 103 subjekte që ushtrojnë veprimtarinë përgjatë vijës bregdetare nga Përroi i Agait-Gjiri i Lalëzit. Nga Dr IKMT Durrës, janë mbajtur PVKK në 3 subjektet, nga të cilat në 2 raste është marrë informacioni nga Dr Policisë Durrës, ndërsa 1 rast është konstatuar në kushtet e flagrancës nga inspektorët e IKMT Durrës gjatë monitorimeve rutinore të vijës bregdetare.

Në vitin 2024 nga Sektori i Inspektimit të Territorit janë kryer 196 inspektime rutinore, nga të cilat në 8 raste është mbajtur PVKK për kundërvajtjet e konstatuara.

Sektori i Inspektimit Pyjor

Sektori i Inspektimit Pyjor për periudhën Janar – Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e egër, veprimtaritë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor nga subjektet private dhe publike;
2. Mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimin penal të autorëve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal;
3. Bashkëpunim me Policinë e Shtetit duke referuar çështjet penale në prokurori.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Nga muaji Prill e në vijim kemi rënie të numrit të inspektimeve për shkak të Urdhërit Nr. 17 datë 24.04.2023 të Inspektorit të Përgjithshëm Z. Shkëlqim Hajdari. Janë realizuar 59 inspektime në total, 36 në fondin pyjor, 15 për gjueti, 8 në subjekte, janë proceduar penalisht 2 shtetas dhe është sekuestruar 1mst dru zjarri. Drurë të prerë gjithsej (pronësi private) rreth 108 copë, sip e dëmtuar 0.6460ha (pronësi bashkiake);
2. Mosbashkëpunim me Njësitë e qeverisjes vendore për shkak të mosngritjes së strukturave përgjegjëse për pyjet nga ana e Bashkisë referuar ligjit Nr. 57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, edhe pas kalimit të afatit 1 vjeçar të sanksionuar në këtë ligj;
3. Kompetencat ligjore përsa i përket mbrojtjes së fondit pyjor, përplasjet me AdzM, Bashkitë, AKP, kanë sjellë një rënie të treguesve sintetike të punës.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave për periudhën Janar – Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
2. Plane Veprimi dhe Plane Masash ne kuader te Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.44 datë.16.02.2024, “Për marrjen e masave të menjëhershme për evidentimin, ndalimin e krijimit dhe mbylljen e vendgrumbullimin e mjeteve motorrike, rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit në një distance jo më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare në të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë”;
3. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
4. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut;
5. Monitorim në lidhje me verifikimin e situatës në perimetrit e sigurisë së shkollave për depozitimin e mbetjeve inerte dhe urbane sipas Urdhërit të Ministrit;
6. Monitorim dhe kontrolli i territorit në lidhje me abandonimin e mbetjeve në vende publike dhe sanksionimi i subjekteve përkatëse sipas Ligjit.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 228 inspektime, nga të cilat është konkluduar me Vendime me Gjobë për 16 subjekte kundravajtës, si dhe 1 Paralajmërim;

2. Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.44 datë.16.02.2024, “Për marrjen e masave të menjëhershme për evidentimin, ndalimin e krijimit dhe mbylljen e vendgrumbullimit të mjeteve motorrike, rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit në një distance jo më pak se 1 km nga akset e rrugëve kombëtare në të gjithë territorin e republikës së Shqipërisë”, ka vijuar menjëherë puna në terren për identifikimin, evidentimin e subjekteve që operojnë në këtë fushë. Fokus dhe prioritet ka qenë sensibilizimi dhe marrja e masave nga ana e subjekteve, të cilët në mënyrë vullnetare u angazhuan në marrjen e masave paraprake për pastrimin vullnetar të hapësirave/akseve rrugore nga mbetjet apo pjesët e makinave në pjesën e shesheve apo territorit/akseve rrugore duke i sistemuar dhe vendosur brenda godinës së aktivitetit. U evidentuan dhe sensibilizuan 170 subjekte të tilla;
3. Në bazë të Planeve mujore të miratuara nga Inspektorati Qendror, për kryerjen e inspektimeve të programuara, janë realizuar në total 58 inspektime të programuara me njoftim paraprak;
4. Përsa i përket Praktikave të inspektimit, bazuar në modelet dhe formatet përkatëse, si rrjedhojë, për vitin 2024 vijojnë të spikasin praktika më të detajuara, të pajisura me relacione, të cilat në mënyrë narrative detajojnë gjetjet e inspektimit, shpjegojnë sanksionin dhe kundërvajtjen duke e rritur cilësinë e mbajtjes/konkludimit të një Procedure me dënim administrativ;
5. Ajo që spikat në praktikën inspektuese është rritja e përdorimit të rubrikës “Këshillimet” në formatet standarte për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, ku trupa inspektuese përshkruan në mënyrë të detajuar, këshillimet që i lihen subjektit për në vijim, për t’i paraprirë dhe shmangur sa më shumë informalitetin mbi bazën ligjore të mjedisit si dhe evituar që në vijimesi të kryhen kundërvajtje në mjedis.

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për periudhën Janar – Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Mbulim të veprimtarisë administrative për funksionimin optimal të shërbimeve të arkivit, protokollit dhe regjimit hyrës dhe dalës të korrespondencës zyrtare;
2. Mbarëvajtje të veprimtarisë së institucionit në aspektin administrativ dhe financiar;
3. Trajtim i informacioneve dhe praktikave e procedurave të ardhura;
4. Funksionim optimal të shërbimeve mbështetëse e logjistike në përputhje me nevojat parësore të Drejtorisë;
5. Përdorimin efektiv të inventareve në dispozicion të institucionit;
6. Mbështetje për sektorët sipas nevojat të brendshme të institucionit;
7. Përfaqësim juridik dhe mbrojtje e interesave të institucionit në gjykatë.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Është realizuar me përpikmëri funksionimi optimal i shërbimeve të arkivit, protokollit dhe regjimit hyrës dhe dalës të korrespondencës zyrtare;
2. Cdo muaj janë rakorduar faturat e shërbimeve, janë përpiluar listëprezencat mujore dhe janë dërguar sipas afateve të vendosura nga IKMT Qendër;
3. Referuar Urdhërit të Kyeinspektorit, Nr.374, datë 17.04.2023 është realizuar vlerësimi 6 mujor i punonjësve të sektorit dhe raportuar në IKMT Qendër;
4. Janë hartuar plane mujore të muajve janar deri dhjetor 2024 dhe raportimet periodike;
5. Është realizuar kontrolli i respektimit të normativave të konsumimit të lëndëve djegëse të automjeteve nën administrimin e institucionit, duke dërguar në IKMT Qendër pasqyrat e lëvizjes së mjeteve cdo fillim muaji për muajin paraardhës;
6. Është mbajtur dhe përditësuar formati i ankesave të ardhura në e-mail apo me shkresë;
7. Është kryer hartimi i Objektivave Smart dhe Regjistri i Riskut për Drejtorinë sipas Planit të Veprimit për vitin 2024;

8. Është bërë planifikimi i planifikimi i pushimeve vjetore të vitit 2024 për të gjithë punonjësit e drejtorisë;
9. Është realizuar përgatitja e parashikimit të kërkesave buxhetore të vitit pasardhës;
10. Janë ndjekur ndjekur seancat gjyqësore dhe përcjell fletëthirrjet, kërkesëpaditë, dhe cdo informacion tjetër pranë IKMT Qendër;
11. Referuar Autorizimit të Kryeinspektorit nr.7107, datë 19.12.2024, është ndjekur procedura e rinovimit të Kontratës së Qirasë për ambjentet e zyrave të drejtorisë.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

Rritjen e cilësisë së shërbimeve nëpërmjet rritjes së performancës gjatë përmbushjes së detyrave funksionale me qëllim mbrojtjen e interesit publik duke zbatuar:

1. Parandalimin, zbulimin e goditjen e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
2. Parimin e këshillimit dhe informimit të subjektit të inspektimit për parandalimin dhe shmangien e shkeljes së kërkesave ligjore;
3. Mbajtja në monitorim e vijës bregdetare, si zone me prioritet, me qëllim, evidentimin, parandalimin dhe marrjen e masave për subjektet kundërvajtëse;
4. Kryerja e monitorimeve/inspektimeve me frekuencë më të lartë për parandalimin/këshillimin/sensibilizimin dhe njohjen e subjekteve me legjislacionin e mjedisit, me fokus turizmin, shkarkimet e lëngëta të pakontrolluara, parandalimin e rasteve të abandonimit të mbetjeve dhe/ose zjarrvënien e tyre);
5. Verifikimi i subjekteve me veprimtari të ndryshme industriale me impakt në mjedis;
6. Kontrolli i vijës bregdetare të Qarkut Durrës për shkarkime të ujërave të zeza;
7. Koordinimi i punës me IKMT Qendër, si dhe realizimi i aksioneve të përbashkëta, në zbatim të detyrave funksionale.
8. Bashkërendimi i veprimeve me njësitë e qeverisjes vendore si dhe, IMT-të, AdZM, AKM dhe Policinë e Shtetit etj
9. Verifikime problematikash dhe ankesash.
10. Monitorim në lidhje me verifikimin e situatës në perimetrin e sigurisë së shkollave për depozitim të mbetjeve inerte dhe urbane, si dhe respektimin e standardeve të sigurisë së kantierëve në objektet në ndërtim sipas Urdhërit të Ministrit.
11. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji; ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
12. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
13. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut
14. Kontrollimin e zbatimit të dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e egër, veprimtaritë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor nga subjektet private dhe publike.
15. Parandalimin, e dëmtimit, pushtimit, shpërdorimit, tjetërsimit, shkatërrimit dhe degradimit të pyjeve, të tokës pyjore, cënimit nga ndërhyrjet e pakontrolluara në fondin pyjor dhe mjedisin natyror.
16. Bllokimin e veprimtarive të ushtruara nga çdo person fizik, juridik që nuk shlyen detyrimet ligjore në afatet e caktuara ose që nuk respektojnë kushtet e kontratave.
17. Garantimin mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimin penal të autorëve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal.

XVI. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT FIER

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Ndjekja dhe zgjidhja e ankesave, problematikave;

2. Kontrolli i subjekteve/individëve, në zbatim të Ligjit 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar;
3. Verifikime/evidentime të strukturave të ngritura përgjatë vijës bregdetare, në zbatim të urdhërave të Kryeinspektori, në kuadër të operacionit Bregdeti Ynë;
4. Trajtimi i rasteve të deleguara me shkresa dhe email - e nga IKMT, Qendër;
5. Bashkëpunim ndërinstitutional me (Policinë e Shtetit, IMT-të, ADZM);
6. Monitorimi dhe kontrolli i subjekteve që shfrytëzojnë burimet ujore e nuk janë të pajisur me leje nga institucionet përkatëse;
7. Monitorimi i subjekteve që operojnë në shtratin e lumenjve me qëllim nxjerrje e inertit lumor;
8. Subjeket që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve pa qenë të pajisur me leje mjedisi apo licencë nga institucionet përkatëse;
9. Trajtimi i ankesave/shkresa të ndryshme;
10. Subjektet që operojnë në shfrytëzimin e shtratit të lumenjve apo burimeve ujore të pajisur me leje nga institucionet përkatëse, por që tejkalojnë kriteret/kushtet e lejes (koordinatat, kushtet etj);
11. Kontrolli i fondit pyjor për të siguruar mbrojtjen e pyjeve, gjueti të paligjshme, faunën e egër, etj ne tërësi nga dëmtimi duke siguruar një meaxhim më të mirë;
12. Rritja e efikasitetit ekonomik i përdorimit të fondit pyjor duke siguruar zbatimin e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e pyjeve dhe duke shmangur abuzimet;
13. Menaxhimin e dokumentacioneve hyrës dhe dalës dhe arkivimi dhe ruajtja e tyre;
14. Hartimi i listprezencës së punonjësve të DRIKMT Fier;
15. Mbajtja në gadishmëri dhe përmirësimi i aktiveve materiale;
16. Hartimi i çështjeve gjyqësore dhe përfaqësimi në çështjet gjyqësore të DRIKMT Fier dhe atyre të autorizuar nga Kryeinspektori;
17. Menaxhimi i burimeve njëzore dhe financiare në funksion të objektivave të IKMT.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Drejtorisë Rajonale të IKMT Fier janë:

1. Bashkëpunimi me grupet e punës së ngritur nga IKMT, Qendër;
Monitorimi i akteve rrugore kombëtare;
Monitorimi i Zonave të Mbrojtura;
Monitorimi i parqeve kombëtare arkeologjike, Apolloni dhe Bylis;
Bashkëpunim ndërinstitutional me (Policinë e Shtetit, IMT-të, ADZM, ASHK);
2. Kontrolli i lumenjëve, konstatimi dhe ndëshkimi i subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore në kundërshtim me Ligjin 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", indryshuar;
3. Kryerja e inspektimit online në subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre me ndikim në mjedis/ujëra;
4. Ka monitoruar dhe kontrolluar në vazhdimësi territorin e Qarkut Fier, për mbrojtjen e territorit dhe lumenjëve, nga ndotjet mjedisore, shkarkimet dhe ndërhyrjet e kundërligjshme;
5. Evidentimi, inspektimi, ndëshkimi i subjekteve të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre të pajisur me leje mjedisore sipas kategorisë përkatëse për ushtrimin e aktivitetit, të parashikuara nga legjislacionet në fuqi për mbrojtjen e mjedisit & ujërave;
6. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me institucione si, IKMT Qendër, DVP Fier dhe Komisaritet në varësi të saj, Agjencin Rajonale të Mjedisit dhe ADZM Fier;
7. Trajtimi i problematikave në trajtë shkresore nga institucione të tjera apo nga qytetarët;
12. Mbajtja e protokollit;
13. Hartimi i listprezencës ditore dhe listprezencës mujore të punonjësve;
14. Kthim përgjigje për cdo shkresë në lidhje me financat;
15. Hartimi i çështjeve juridike.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë/Sektorit të Drejtorisë Rajonale Fier gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Zbatimi i planeve mujore, në plotësimin e detyrave të ngarkuara, në zbatim të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar;
2. Monitorimi dhe kontrolli për parandalimin e zhvillimit të paligjshmërive;
3. Bashkëpunimi me IKMT, Qendër në kontrollin dhe marrjen e masave përgjatë vijës bregdetare;
4. Trajtimi i ankesave të ardhura me (shkresa, email-e), ndjekja e tyre deri në zgjidhje përfundimtare dhe kthim përgjigjja e tyre;
5. Mbajtja e PVK-ve, në rastin e hasjes së zhvillimeve të paligjshmërive në fushën ndërtimore;
6. Mbajtja e protokollit;
7. Hartimi i listprezencës ditore dhe listprezencës mujore të punonjësve;
8. Kthim përgjigje për cdo shkresë në lidhje me financat;
Hartimi i çështjeve juridike.

Prioritetet:

1. Kontrolli dhe monitorimi i Zonave të mbrojtura, parqeve kombëtare dhe vijës bregdetare;
2. Kontrolli dhe monitorimi i akseve kombëtare rrugore;
3. Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit për kontrolle dhe zgjidhje problematikash;
4. Trajtimi i ankesave të ardhura me (shkresa, email-e), ndjekja e tyre deri në zgjidhjen përfundimtare;
5. Mbajtja e korrespondencave me IKMT, Qendër dhe IMT-ve Bashkive pjesë e Qarkut Fier
6. Kontrolli i lumenjëve, konstatimi dhe ndëshkimi i subjekteve që shfrytëzojnë inerte lumore në kundërshtim me Ligjin 111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të burimeve ujore", i indryshuar;
7. Kryerja e inspektimit online në subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre me ndikim në mjedis/ujëra (deri në urdhërin nr.29 i IQ);
8. Ka monitoruar dhe kontrolluar në vazhdimësi territorin e Qarkut Fier, për mbrojtjen e territorit dhe lumenjëve, nga ndotjet mjedisore, shkarkimet dhe nderhyrjet e kundërligjshme;
9. Evidentimi, inspektimi, ndëshkimi i subjekteve të cilët ushtrojnë veprimtarin e tyre të pajisur me leje mjedisore sipas kategorisë përkatëse për ushtrimin e aktivitetit, të parashikuara nga legjislacionet në fuqi për mbrojtjen e mjedisit & ujërave;
10. Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me institucione si, IKMT Qendër, DVP Fier dhe Komisaritet në varësi të saj, Agjencin Rajonale të Mjedist dhe ADZM Fier;
11. Mbrojtja e Pyjeve si pasuri me rëndësi të vecantë për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme;
12. Bashkëpunimet ndër-institucionale në Pyje;
13. Hartimi i planeve të përbashkëta me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier;
14. Mbajtja e protokollit, delegimi i shkresave sipas sektorëve përkatës, kthim përgjigje i shkresave të ndryshme;
15. Mbajtja e listprezencës ditore, si dhe hartimi i listprezencës mujore;
16. Raportimi i gjithë shkresave të dërguara nga ana e IKMT Fier drejt institucioneve të tjera sipas kërkesave të tyre;
17. Përpilimi i shkresave të ardhura në lidhje me financat;
18. Hartimi i çështjeve juridike, marja pjesë në çështjet gjyqësore.

Mangësi dhe problematika :

1. Mosbashkëpunimi i Bashkisë Divjakë, (Drejtoritë e planifikimit të territorit) në dhënien e të dhënave mbi lejet e ndërimin të miratuara gjatë vitit 2024;

2. Mungesa e automjeteve, pengon në kryerjen e numrit dhe cilësisë së inspektimeve;
3. Mungesa e mjeteve logjistike identifikuese të institucionit, në kryerjen e punës në terren, pajisja me karburant për automjetet, pajisja me uniformat identifikuese të IKMT-së, pajisja me tablet të rinj për realizimin e inspektimeve online pasi tabletat që disponojmë janë të vjetër dhe të ngadaltë, pajisja me laptop dhe kompjuter, materiale kancelarike, printer, kondicioner, internet në të gjitha zyrat e tjera;
4. Mungesa e aksesit në sistemin online pas urdhërave nr 17 dhe nr. 29 të IQ;
5. Mungesa e formatit të Akt kontrollit të miratuar.

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale e IKMT-së Fier, përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Territorit.
2. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave.
3. Sektori i Inspektimit Pyjor.
4. Sektori i Finacës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Në dispozicion për zbatimin e Urdhërit të përbashkët Nr.465, datë 21.05.2021, për krijimin e Task Forcës Vendore në nivel Qarku;
2. Kryerjen e inspektimeve në terren në bazë të planit mujor;
3. Kryerjen e inspektimeve në zonat e mbrojtura;
4. Kryerjen e inspektimeve në zonat bregdetare dhe turistike për parandalimin e ndërtimeve të kundërligjshëm;
5. Kryerjen e inspektimeve në akset kombëtare për parandalimin e ndërtimeve të kundërligjshëm;
6. Kryerjen dhe zgjidhjen e problematikave të ngritura nga ankesat e qytetarëve dhe institucioneve;
7. Realizimi i planit strategjik dhe objektivat për periudhën janar-dhjetor 2024 si më poshtë;
8. Ka monitoruar në vazhdimësi territorin e Qarkut për marrjen e masave në parandalimin e ndërtimeve të kundërligjshëm dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit të pajisur me lejet përkatëse. Ka bashkëpunuar me Policinë e Shtetit, për zbatimin e Urdhërit të përbashkët Nr.465, datë 21.05.2021, për krijimin e Task Forcës Vendore në nivel qarku, për mbrojtjen, kontrollin dhe monitorimin e territorit;
9. Për periudhën janar - dhjetor 2024, Sektori i Territorit ka mbajtur 24 Proçes -Verbal për konstatimin e kundërvajtjes dhe ja kemi përcjellë IKMT Qendër, për marrjen e vendimeve;
10. Kontrollë/monitorime në zbatim të planit të veprimit në kuadër të aksionit Plazhi Y në veror 2024 dhe Urdhërit nr.69 dt.30.04.202 të Kryeministrit për ngritjen e Taks - Forcës ndërinsitucionale të sezonit turistik veror 2024 dhe 23 në zona me rëndësi kombëtare;
11. Inspektime/kontrolle/monitorime në zona të tjera (Urbane, rurale dhe industriale);
12. 104 Ankesa dhe shkresa/Informacione të trajtuara.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit & Ujërave:

1. Për muajin janar 2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 1 inspektim online, 2 kontrolle në zonë me rëndësi kombëtare dhe 2 trajtime shkrese;
2. Për muajin shkurt 2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 11 inspektime online dhe janë evidentuar 40 subjekte në zbatim të urdhërit të Ministrit nr.44 dt.16.02.2024 për evidentimin e subjekteve të pikave të skrapit, 3 kontrolle/monitorime;
3. Për muajin mars 2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 22 inspektime online në zbatim të urdhërit të ministrit nr.44 gjithashtu janë kryer 10 kontrolle/monitorime në zbatim të këtij urdhëri, janë trajtuar dhe 4 shkresa/ankesa;

4. Për muajin prill-2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 19 kontrolle/monitorime në subjektet e evidetuara në zbatim të urdherit të ministrit nr.44, janë trajtuar 10 shkresa ankesa;
5. Për muajin maj 2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 12 inspektime online, janë kryer 2 kontrolle monitorime dhe 1 verifikim ankesa;
6. Për muajin qershor 2024 në zbatim të planit të punës, janë kryer 11 inspektime online, 3 kontrolle/monitorime në zbatim të Planit të Veprimit në kuadër të aksionit Plazhi Ynë, gjithashtu janë trajtuar 6 shkresa/ankesa si dhe 6-Kontrolle/monitorime në zbatim të Planit të Veprimit në kuadër të aksionit Plazhi Ynë;
7. Për muajin korrik 2024, në zbatim të planit të punës, janë kryer 6 inspektime online, është kryer 1 kontrolle/monitorime në zbatim të planit të veprimit në kuadër të aksionit plazhi ynë veror 2024, gjithashtu janë trajtuar 6 shkresa/ ankesa;
8. Për muajin gusht 2024, janë trajtuar dhe verifikuar 3 shkresa/ankesa, 2 kontrolle /monitorime në zbatim të Planit të Veprimit në kuadër të aksionit Plazhi Ynë, dhe 9 kontrolle në subjekte të cilat nga veprimtaria e tyre gjenerojnë mbetje shtazore, në zbatim të shkresës së ardhur nga IKMT Qendër;
9. Për muajin shtator 2024, është trajtuar dhe verifikuar, 1 shkresë/ankesë;
10. Për muajin tetor 2024, janë trajtuar dhe verifikuar, 2 shkresa/ankesa;
11. Për muajin nëntor 2024, janë trajtuar dhe verifikuar, 2 shkresa/ankesa, 1 verifikim i informacionit të ardhur për ndotjen e kanalit kullues të Nj.A.Cermë dhe mbajtja e inspektimit online për subjektin Luis& CO është mbajtur proces verbal me gjobë 300000 lekë dhe dënim plotësues pezullim i aktivitetit. 1 zbatim të urdherit për largimin e skrapeve dhe mjeteve motorrike në fund të jetës. 2, verikime informacioni të ardhura për ndotjen e kanalit të quajtur Vija e Ngjalës Nj.A.Dërmenas Bashkia Fier dhe për ndotjen e përroit të Powlës, Pocem Bashkia Mallakastër;
12. Për muajin dhjetor 2024 1.verifikim i informacioni të ardhur nga Bashkia Lushnje për ndotje mjedisore nga një fabrike vaj, dhe hapja e inspektimit online për subjektin Hazis Cela është mbajtur proces verbal inspektimi me masë administrative 300000 lekë gjobë dhe dënim plotësues pezullim aktiviteti, 1 kthim përgjigje Bashkisë Divjakë, 3-trajtime shkresor, 2 mbyllje vendimi përfundimtar për dy subjektet Luis&Co dhe Hazis Cela me mas administrative gjobë 300000 lekë dhe dënim plotësues pezullim i aktivitetit; 1 verifikim i ankesës së ardhur për ndotje mjedisore nga nje stallë gjethi dhe përcjell për kompetenc Bashkisë Lushnje për zgjidhjen e ankesës.

Tabela e masave administrative të mbajtura nga SMU DRIKMT Fier

Nr.	Emri subjektit	Dënim kryesor me gjobë/Lekë	Dënim plotësues		Urdhër sekuestro
1.	EURO ALB 2009	100,000 lekë	Pezullim i aktivitetit deri në pajisien me leje mjedisore		-
2.	DYLBERE SALLIU	100,000 lekë	Pezullim i aktivitetit deri në pajisien me leje mjedisore		-
3.	EDMOND XHINDI	100,000 lekë	Pezullim i aktivitetit deri në pajisien me leje mjedisore		-
4.	PETRIKA DIMO	100,000 lekë	-		-
5.	KUJTIM MECAJ	500,000 lekë	Largimi i mbetjeve inerte, për në		-

			vendin e përshtatshëm		
6.	VALMIRA DURAJ	500,000 lekë	-		-
7.	ALEKS MËRTIKA	500,000 lekë	-		
8.	EDUART MUHO	300.000 lekë	-		-
9.	Luis&CO	300.000 lekë	pezullim i aktivitetit. deri në pajisjen me leje mjedisore		-
10	Hazis Cela	300.000 lekë	pezullim i aktivitetit. deri në pajisjen me leje mjedisore		-
Totali		64,0000,000	6		-

Sektori i Inspektimit Pyjor:

1. Ka kryer monitorime dhe kontrole në zbatim të planeve të punës të miratuara nga IKMT Qendër;
2. Gjatë kësaj periudhe janë kryer gjithsej 60 kontrole dhe monitorime në ekonomitë pyjore, akse rrugore dhe zona të mbrojtura;
3. Ka kryer monitorime dhe kontrole në ekonomitë pyjore si dhe akse rrugore;
4. Ka kryer monitorime dhe kontrole në zonat e mbrojtura Qarku Fier në zbatim të ligjit 81/2017 për Zonat e Mbrojtura;
5. Është marrë masë administrative me gjobë 100.000 lekë të reja ndaj subjektit Denis Besnik Marra si dhe bllokimi i armës së gjahut së bashku me fishekët dhe pajisjet e tjera që shërbenin për ushtrimin e gjuetisë së paligjshme;
6. Është marrë masë administrative me gjobë 100.000 lekë të reja ndaj subjektit Xhuljan Mikel Rrogozi si dhe bllokimi i armës së gjahut së bashku me fishekët dhe pajisjet e tjera që shërbenin për ushtrim e gjuetisë së paligjshme;
7. Ka kryer inspektimeve dhe monitorime në ekonomitë pyjore në zbatim të ligjit 60/2022 "Për Shpalljen e Moratoriumit të Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë";
8. Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier rreth problematikave të ndodhura në fushën e pyjeve dhe referimi i rasteve në komisaritetet përkatëse;
9. Është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me përfaqësues të institucioneve të ndryshme në lidhje me bashkëpunimin dhe problematikat e hasura;
10. Në kuadër të bashkëpunimit institucional nga ana jonë është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, i është kthyer përgjigje në kohë sipas ligjit në fuqi dhe kemi marrë pjesë në takime të zhvilluara nga ky institucion mbi zhvillime dhe problematika në fushën e pyjeve kullotave dhe zjarreve në qarkun e Fierit;
11. Në cdo moment nga ana e sektorit janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me cdo drejtor pyjor pranë njësive të qeverisjeve vendore të 6 Bashkive të Qarkut Fier dhe ADZM Fier mbi cdo problematikë të shfaqur duke marrë masat e duhura për cdo rast;
12. Është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme kontakt me IKMT Qendër për problematikat që mund të jenë shfaqur gjatë kësaj periudhe.

Tabela e masave administrative të mbajtura nga Sektori Pyjor DRIKMT Fier

Nr.	Emri subjektit	Dënim kryesor me gjobë/Lekë	Dënim plotësues	Urdhër sekuestro
1.	Denis Besnik Marra	100.000 lekë		-
2.	Xhuljan Mikela Rogozi	100.000 lekë	-	-

Sektori i Financës & Shërbimeve Mbështetëse:

Sektori i Shërbimeve Mbështetëse për periudhën janar - dhjetor 2024, ka ushtruar detyrat si më poshtë:

1. Menaxhimi i dokumentacionit hyrës dhe dalës (mbajtja e protokollit);
2. Ka hartuar 12 listë prenzencave të punonjësve të Drejtorisë IKM-Fier;
3. Mbajtjen e 12 korrespondencave me postën qendrore Fier mbi shërbimet ligjore;
4. Kthim përgjigje për cdo shkresë të ardhur në lidhje me financat;
5. Juristi menaxhon dhe ndjek çështjet juridike të IKMT-së Drejtoria Rajonale Fier dhe ato të autorizuar nga Kryeinspektori.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025:

1. Monitorimi/evidentimin e subjekteve përgjatë vijës bregdetare;
2. Kontrollë, monitorime të akteve kombëtare rrugorë;
3. Kontrollë, monitorime të parqeve kombëtare arkeologjik Apolloni dhe Bylis;
4. Bashkëpunim me IKMT Qendër në trajtimin e rasteve të deleguara;
5. Bashkëpunim ndërinstitucional me Policinë e Shtetit, IMT-të, ADZM dhe ASHK;
6. Monitorimi dhe kontrolli i subjekteve që shfrytëzojnë burimet ujore që nuk janë të pajisur me leje nga institucionet përkatëse;
7. Monitorimi i subjekteve që operojnë në shtratin e lumenjve me nxjerrjen e inertit lumor;
8. Monitorimi dhe kontrolli i subjekteve që operojnë pa qenë të pajisur me leje mjedisore konform Ligjit Nr.10448 për lejet e mjedisit;
9. Subjektet që operojnë në fushën e menaxhimit të mbetjeve pa qenë të pajisur me leje mjedisore apo licence nga institucionet përkatëse;
10. Vazhdimin e zbatimit të ligjit Nr. 60/2022 “Për shpalljen e Moratoriumit të Gjyqësorisë në Republikën e Shqipërisë” nga ana e Sektorit të Inspeksionit Pyjor për kontrollin dhe monitorimin e zonave të gjyqësorisë në territorin e Qarkut Fier me qëllim ndalimin e veprimtarisë së ushtrimit të gjyqësorisë së paligjshme si edhe për përmirësimin e gjëndjes së llojeve të faunës së egër;
11. Vazhdim i procedurave ligjore (online) në rastet e konstatimit ndaj personave kundravajtës sipas rastit;
12. Përforsim i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacionit ndërinstitucional me institucionet relevante në fushën e pyjeve;
13. Monitorimi i rrugëve autopsyjore për transport të paligjshëm të lëndës drusore;
14. Sekuestrim i mjeteve në rast konstatimi të cilët shërbejnë për transport të paligjshëm të lëndëve drusore;
15. Pajisja me automjet dhe karburant për automjetet;
16. Pajisja me material të tjera logjistike dhe kancelarike si: uniformat identifikuese të IKMT, pajisja me tablete të rinj për realizimin e inspeksioneve online pasi tabletat që disponojmë janë të vjetër dhe të ngadaltë, pajisja me laptop dhe kompjuter, materiale kancelarike, printerë, kondicioner, internet në të gjitha zyrat tjetër;
17. Trajnimi i stafit dhe plotësimi i organikës, për të bërë të mundur rritjen e performancës së DRIKMT Fier.

XVII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT KUKËS

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori janë përmbushur detyrat institucionale për:

6. Kontrollin për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave;
7. Mbikëqyrjen e IMT-ve përmes shqyrtimit të korrespondencave apo inspektimeve në objekt që mund të këtë kryer IMT-ja;
8. Parandalimin, kontrollin dhe ulja e ndotjes së ajrit, ajrit dhe tokës;
9. Rritjen e bashkëveprimit për goditjen e paligjshmërisë në bashkëpunim me institucionet e tjera;
10. Inspektim-kontrollin mbi parandalimin e prerjeve të paligjshme, gjuetisë dhe faunës.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për inspektim:

1. Zonat me rëndësi kombëtare ku janë ushtruar kontrole të herëpashershme dhe konkretisht në Parkun Kombëtar të Valbonës, Rezervatin Natyror të Gashit, Zonën e Shishtavecit, Liqenin e Fierzës, në Rrugët Nacionale, Bregun Liqenor dhe inspektimin e Njësive Administrative në rang qarku.
2. Kontrolli i objekteve në zhvillim dhe kontrolli IMT-ve në shkallë qarku.
3. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
4. Përmirësimi i kushteve të mjedisit;
5. Parandalimi i gjuetisë së paligjshme;
6. Parandalimi, bllokimi dhe sekuestrimi i mjeteve që transportojnë material drusor pa dokumentacionin përkatës konform ligjeve në fuqi;
7. Parandalimi dhe hetimi i zënieve të fondit pyjor dhe kullosor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë Rajonale Kukës gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Rritja e produktivitetit në punë (mbajtja e procedurave me gjobë);
2. Rritja e gatishmërisë (Rritje e zgjidhjes së ankesave nga platforma e bashkëqeverisjes dhe bashkëpunimi me sektorët e tjerë);
3. Rritja e performancës (etika në punë);
4. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional;
5. Parandalimi dhe hetimi i zënieve të fondit pyjor dhe kullosor është tregues në rritje;
6. Garantimi dhe mbrojtja e faunës së ergër dhe bimëve medicinale është tregues në rritje;
7. Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera është tregues në rritje.

Risite e vitit 2024:

1. Komunikimi me e-mail me të gjithë drejtoritë në IKMT;
2. Krijimi i grupeve në aplikacionin WhatsApp, për shpërndarjen e informacioneve në kohë reale;
3. Kontrole të vazhdueshme të 3 sektorëve, pasqyruar dhe me gjobat;
4. Trajnimi i brendshëm i punonjësve të sektorit të finances dhe i shërbimeve mbështetëse;
5. Trajnim/testim i punonjësve nga IQ.

Mangësi dhe problematika:

1. Ankesat e ardhura nga shtetasit në rrugë postare;
2. Pajisja me mjet transporti për kryerjen e inspektimeve për të 3-sektorët;

3. Baza materiale si kancelarike, kompjuter, fotokopje, printer, etj.

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria (Rajonale Kukës) përbëhet nga sektorët si vijon:

Sektori Territorit.

Sektori Mjedisit dhe Ujërave.

Sektori Pyjeve.

Sektori Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Territorit

Sektori i Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Zonat me rëndësi kombëtare
2. Akset rrugore dhe Rrugët Nacionale;
3. Bregu liqenor;
4. Kontrolli i IMT-ve;
5. Kontrolli i objekteve në zhvillim.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje e produktivitetit (procedurat) për zgjidhjen e ankesave;
2. Rritje e gatishmërisë (nëbashkëpunim me sektorët e tjerë dhe institucionet e tjera).
3. Rritje e performancës;
4. Rënie e zgjidhjes së ankesave në rrugë zyrtare (postë);
5. Rritje e zgjidhjes së ankesave nga platforma e bashkëqeverisjes.

Sektori i Territorit ka kryer 256 inspektime në Bashkitë Kukës, Has, Tropojë.

Janë mbajtur 9 procedura, me vendosje pa leje të 9 tabelave reklamuese, në bashkëpunim me IKMT Tiranë, Sektori i Ekzekutimit të vendimeve si dhe 3 kioska pa leje, procedurat e të cilave është mbajtur në vitin 2024. Këto objekte kanë qenë të vendosura në hyrje të pikës doganore Morinë, Bashkia Kukës.

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave për periudhën Janar-Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Oficinat e ndryshme për riparim automjesh dhe gomisteritë;
2. Pikat e shitjes me karburant;
3. Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kukës;
4. Inspektim në fushën e karburanteve;
5. Pastrimi nga ndotja e ujërave të lumenjve dhe liqeneve;
6. Qendra socio-shëndetësore;
7. Inspektim mbi mbetjet urbane dhe inerte;
8. Therrtoret si gjenerues mbetjesh teknologjike me origjinë shtazore si dhe shkarkimet e ujërave të ndotura;
9. Kontrolli në restorante për rëndësinë e sezonit turistik;
10. Kontrolli i perimetrit të sigurisë në shkolla;
11. Kontrolli në fushën e prodhimit të alkoolit dhe pijeve alkoolike duke përfshirë fabrikat e birrave.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritja e produktivitetit në punë (mbajtja e procedurave me gjobë);
2. Rritja e performancës (etika në punë);
3. Rritja e gatishmërisë (zgjidhje e rasteve me ankesa dhe bashkëpunimi me sektorët e tjerë);
4. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Sektori Mjedisit dhe Ujërave ka kryer 204 inspektive në Bashkitë Kukës, Has, Tropojë dhe janë marrë 6 vendime me gjobe.

Sektori i Pyjeve

Sektori i Pyjeve për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Kthimi i përgjigjeve të shkresave të ardhura nga institucionet si dhe ankesat e qytetarëve brenda afateve ligjore;
2. Transportimi i lëndës drusore nga kundërvajtës pa dokumentacion përkatës sipas ligjeve në fuqi;
3. Parandalimi i gjuetisë së paligjshme sipas Moratoriumit të Gjuetisë;
4. Parandalimi dhe hetimi i zënieve të fondit pyjor dhe kullosor në kundërshtim me lagjislacionin në fuqi;
5. Garantimi dhe mbrojtja e faunës së ergër dhe bimëve medicinale përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimi;
6. Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Kthimi i përgjigjeve të shkresave të ardhura është tregues në rritje
2. Transportimi i lëndës drusore nga kundërvajtës është tregues në rënie.
3. Parandalimi i gjuetisë së paligjshme është tregues në rënie.
4. Parandalimi dhe hetimi i zënieve të fondit pyjor dhe kullosor është tregues në rritje.
5. Garantimi dhe mbrojtja e faunës së ergër dhe bimëve medicinale është tregues në rritje.
6. Rritja e bashkëpunimit me institucionet e tjera është tregues në rritje.

Sektori Pyjeve ka kryer 173 inspektive në Bashkitë Kukës, Has, Tropojë.

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetëse

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetëse për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Arshivimin e dokumentacioneve të vitit 2023;
2. Kthimin e përgjigjeve të shkresave me institucionet e tjera;
3. Rritjen e performancës (etika në punë);
4. Përpilimin dhe dërgimin në kohë të listëprezencës mujore, evidentimin e mungesave si dhe rasteve të mungesave të arsyetuara me dokumentacionin justifikues (raport mjekesor) dhe dërgimin e tyre në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbeshtetëse në IKMT Tiranë, në mënyrë elektronike dhe në formë shkresore;
5. Planifikimin e lejes së zakonshme të çdo punonjësi në institucion dhe ndjekjen e grafikut të lejeve;

6. Rivlersimin e pajisjeve dhe materialeve në ambientet e punës në bashkëpunim me IKMT Tiranë;
7. Është bërë parashikimi tek buxheti për vitin ushqimor pasardhës, pajisjeve elektronike si kompjutera, fotokopje, skaner si dhe mjete kancelarike;
8. Është bërë kërkesa për planifikimin e buxhetit të vitit 2025-2027.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës, rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës si më poshtë:

1. Janë kryer të gjitha detyrat dhe rekomandimet e lëna nga Specialistë të Sektorit të Financës dhe të Burimeve Njerëzore si dhe ato të dhëna nga Titullari i Institucionit;
2. Mbajtja e kontakteve të përditshme të adresës elektronike të institucionit, kthimi në kohë i përgjigjeve të problematikave të kërkuara nga IKMT Tiranë dhe institucionet e tjera.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Kontrolli i vazhdueshëm i Zonave me Rëndësi Kombëtare, Rrugët Nacionale, Bregu Liqenor dhe inspektimi i Njësive Administrative në rang Qarku;
2. Kontrolli i perimetrit të Sigurisë së shkollave për objektet në zhvillim;
3. Kontrolli i procedurave të mbajtura nga IMT-të respektive të Qarkut;
4. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
5. Ruajtja, mbrojtja, përmirësimi i natyrës dhe diversiteti;
6. Përmirësimi i kushteve të mjedisit;
7. Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj;
8. Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit natyror;
9. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut;
10. Garantimi, mbrojtja dhe siguria e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale;
11. Garantimi, mbrojtja e gjuetisë së paligjshme sipas Moratoriumit të Gjuetisë;
12. Garantimi, mbrojtja e faunës së ergër dhe bimëve medicinale përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit;
13. Parandalimi, bllokimi dhe sekuestrimi i mjeteve që transportojnë material drusor pa dokumentacionin përkatës konform ligjeve në fuqi;
14. Parandalimi dhe hetimi i zënieve të fondit pyjor dhe kullësor në kundërshtim me lagjislacionin në fuqi;
15. Rritja e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë duke rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera;
16. Mbajtja e kontakteve të përditshme të adresës elektronike të institucionit, kthimi në kohë i përgjigjeve të problematikave të kërkuara nga IKMT Tiranë dhe institucionet e tjera.

XVIII. VEPRIMATIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT LEZHË

Gjatë vitit 2024, nga ana e DRIKMT Lezhë janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Ruajtjen dhe sigurinë e ndërtimeve në Qarkun e Lezhës;
2. Zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standardeve në fushën e planifikimit, zhvillimit dhe mbrojtjes së territorit;
3. Evidentimin e problematikave në akset rrugore lidhur me ndërtimet informale dhe në kundërshtim me ligjin;
4. Kontrollin e zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Drejtorinë Rajonale Lezhë:

1. Evidentimi, dokumentimi dhe goditja e veprimtarisë kriminale në fushën e ndërtimit të paligjshëm, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
2. Trajtimi dhe ndjekja e shkresave/ankesave, në lidhje me problematikat e ndryshme që lidhen me fushën e ndërtimit;
3. Realizimi i të gjitha detyrave të ngarkuara nga Drejtori i Drejtorisë sipas indicieve të ardhura nga institucione/subjekte të ndryshme;
4. Evidentimi, dokumentimi dhe marrja e masave të nevojshme kundër veprimtarive të paligjshme në zbatim të legjislacionit në fuqi për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave;
5. Inspektimi i subjekteve në të gjithë Qarkun Lezhë lidhur me trajtimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktivitete të ndryshme në fushën e mjedisit;
6. Inspekte në zbatim të Urdhërit nr.44 të Ministrit të Brendshëm, datë 16.02.2024 “Për heqjen e mjeteve motorrike, të rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare”;
7. Inspektimi i subjekteve për përdorim të burimeve ujore, lidhur me afatet e lejeve përkatëse.
8. Inspektimi i subjekteve/individëve që kryejnë veprimtari të kundërligjshme në shtretërit e lumenjeve dhe brigjeve në shfrytëzimin e inerteve lumore në lumenjtë Mat dhe Fan;
9. Monitorimi i zonave turistike Shëngjin - Tale përgjatë sezonit turistik, lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe shkarkimet e ujërave në det.

Risite e vitit 2024:

- Pajisja e drejtorisë sonë me dy automjete dhe karburant për realizimin e inspektimeve nga ana e grupeve të punës;
- Shtimi i inspektimeve në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
- Kryerja e trajnimeve të punës për punonjësit brenda Sektorit të Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave;
- Organizmi i aktiviteteve të ndryshme në kuadër të Mbrojtjes së Mjedisit, si prezantime në shkollë, shpërndarje informacioni për kujdesin ndaj natyrës, mbledhja e mbetjeve përgjatë vijës bregdetare të Shëngjinit dhe mbjellja e pemëve në shkollën “Nënë Tereza”.

Mangësi dhe problematika:

- Problem thelbësor vazhdon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për realizimin e mbledhjeve dhe punës së ndarë për katër sektorët, si dhe kushteve fizike të zyrave aktuale të cilat janë jashtë parametrave për funksionim, si pasojë e tërmetit të Dhjetorit 2020, nga i cili ka pasur dëmtime të mëdha që vijnë të jenë të pariparueshme deri më sot;
- Problematikë për sektorët e inspektimit vazhdon të mbetet heqja e inspektimeve të programuara për Sektorin e Inspektimit Pyjor, sipas udhëzimit Nr.17, datë 20.04.2023 “Për bashkëpunimin e Funksioneve Inspektuese në Fushën e mbrojtjes së pyjeve”, i cili nuk kryen procedurë inspektuese;
- Trajnime të vazhdueshme për të gjitha fushat e ushtrimit të veprimtarisë së IKMT-së;
- Mungesa e vetëdërgjegjësimit për plotësimin e dokumentacionit përkatës, e një pjese të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në brigjet e lumenjve Mat dhe Fan, me aktivitet përpunimin e materialeve inerte lumore, edhe pse janë marrë masa ndaj tyre.

Struktura Përbërëse e Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale Lezhë përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Territorit.
2. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave.
3. Sektori i Inspektimit të Pyjeve.
4. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Inspektimit të Territorit:

- Sektori i Inspektimit të Territorit është përgjegjës për zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standarteve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim, menaxhimin e integruar të burimeve ujore, mbikëqyrjen dhe kontrollin ndaj Inspektoratëve të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në nivel qarku, inspektimin e materialeve dhe produkteve të ndërtimit që hidhen në treg, inspektimin e shfrytëzimit të karrierave të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit. Sektori i Inspektimit të Territorit e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e përgjegjësisë së saj.

Numri i kontrolleve/inspektimeve të kryera dhe aktet e mbajtura për periudhën Janar -Mars:

- Aktiviteti i Sektorit të Inspektimit të Territorit nga muaji Janar deri në muajin Mars për vitin 2024 ka konsistuar kryesisht në evidentimin e problematikave në akset rrugore si dhe inspektimet e nisura nga indiciet e qytetarëve apo edhe institucioneve përkatëse. Në zbatim të planit të punës si grup inspektimi jemi fokusuar në monitorimin e akseve rrugore kryesore dhe në zonat me rëndësi kombëtare siç janë: Laç - Mamurras (Rruga e vjetër), Lezhë - Laç, Lezhë - Shkodër dhe Milot - Mirditë, Lezhë - Mirditë, në lidhje me ndërtimet e kundërligjshme ku janë bërë 16 kontrolle/inspektime, ndër të cilat 3 prej tyre jashtë planit të punës ,ku u mbajtën proces-verbale për konstatimin e kundërvajtjeve. Gjithashtu është bërë trajtimi dhe ndjekja e shkresave/ankesave në lidhje me problematikën e ndryshme sa i përket Sektorit të Inspektimit të Territorit.
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë 3 inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit.
- Gjatë kësaj periudhe është bërë 1 inspektim në bashkëpunim me IMT-Bashkia Lezhë.

Numri i kontrolleve/inspektimeve të kryera dhe aktet e mbajtura për periudhën Prill- Qershor:

- Aktiviteti i Sektorit të Inspektimit të Territorit nga muaji Prill deri në muajin Qershor për vitin 2024 ka konsistuar kryesisht në evidentimin e problematikave në akset rrugore si dhe inspektimet e nisura nga indiciet e qytetarëve apo edhe institucioneve përkatëse. Në zbatim të planit të punës si grup inspektimi jemi fokusuar në monitorimin e akseve rrugore kryesore dhe në zonat me rëndësi kombëtare siç janë : Laç - Mamurras (Rruga e vjetër), Lezhë - Laç, Lezhë - Shkodër dhe Milot - Mirditë, Lezhë - Mirditë, në lidhje me ndërtimet e kundërligjshme ku janë bërë 16 kontrolle/inspektime ndër të cilat 4 prej tyre jashtë planit të punës. Për 4 inspektime u mbajtën Procesverbale për Konstatimin e Kundërvajtjes.
- Gjatë kësaj periudhe janë bërë 4 inspektime në bashkëpunim me Policinë e shtetit.

Numri i kontrolleve/inspektimeve të kryera dhe aktet e mbajtura për periudhën Korrik-Dhjetor:

- Aktiviteti i Sektorit të Inspektimit të Territorit nga muaji Korrik deri në muajin Dhjetor për vitin 2024 ka konsistuar kryesisht në evidentimin e problematikave në akset rrugore si dhe inspektimet e nisura nga indiciet e qytetarëve apo edhe institucioneve përkatëse. Në zbatim të planit të punës si grup inspektimi jemi fokusuar në monitorimin e akseve rrugore kryesore dhe në zonat me rëndësi kombëtare siç janë: Laç - Mamurras (Rruga e vjetër), Lezhë - Laç, Lezhë - Shkodër dhe Rubik - Rrëshen, Lezhë - Dajç, Lezhë - Milot, Milot - Rrëshen, Lezhë - Mabë, Milot - Laç, në lidhje me ndërtimet e kundërligjshme ku janë bërë 22 kontrolle/inspektime ndër të cilat 4 prej tyre jashtë planit të punës për të cilat u mbajtën Procesverbale për Konstatimin e Kundërvajtjes.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave:

Sektori i Mjedisit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Inspektimi i subjekteve me objekt për përdorim të burimeve ujore, lidhur me afatet e lejeve përkatëse;
2. Inspektimi i subjekteve në të gjithë Qarkun Lezhë lidhur me trajtimin e mbetjeve të gjeneruara nga aktivitete të ndryshme në fushën e mjedisit;
3. Inspektimi i subjekteve/individëve që kryejnë veprimtari të kundërligjshme në shtretërit e lumenjeve dhe brigje në shfrytëzimin e inerteve lumore në lumenjtë Mat dhe Fan;
4. Monitorimi i zonave turistike Shëngjin - Tale përgjatë sezonit turistik, lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe shkarkimet e ujërave në det;
5. Monitorim në 3 Bashkitë e Qarkut, me objekt Menaxhimin e Mbetjeve;
6. Në përputhje me prioritetet e këtij viti, nga ana e sektorit janë zhvilluar 69 inspekte online, ku nga këto janë 30 inspekte të planifikuara sipas planeve mujore të miratuara nga IKMT për muajt qershor, korrik, gusht, ndërsa 20 inspekte janë zhvilluar në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Brendshëm nr.44, datë 16.02.2024 gjatë periudhës Shkurt- Prill, dhe inspektimet e tjera janë zhvilluar jashtë programit, me informacion/indicie përgjatë gjithë vitit;
7. Për këtë periudhë, janë marrë 20 masa administrative, nga të cilat janë 3 Paralajmërime dhe 17 gjopa në vlerën 17,300,000 lekë, si dhe janë sekuestruar 3 mjete të rënda, përkatësisht 2 eskavator dhe 1 kamion;
8. Në total janë zhvilluar 147 inspekte.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Nga të dhënat e mësipërme rezulton se është shtuar numri total i inspektimeve, si dhe numri i masave administrative, krahasuar me një vit më parë;
2. Ka më pak Urdhëra të Sekuestros për këtë vit, krahasuar me vitin 2023;
3. Gjatë procesit të punës vihet re një rritje e cilësisë së mbajtjes së procedurave administrative nga grupet e punës.

Sektori i Inspektimit të Pyjeve:

1. Për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë mbajtur gjithsej 99 monitorime, nga këto 88 të kryera kryesisht në akset rrugore që përshkojnë ekonomitë pyjore, 10 monitorime për parandalimin në zbatim të moratoriumit për gjuetinë e paligjshme si dhe 1 pranë Strukturës përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në pyje pranë bashkisë Mirditë.
2. Në zbatim të programeve të punës të miratuara, Sektori i Inspektimit Pyjor, DRIKMT Lezhë ka kryer monitorime në akset rrugore auto pyjore që përshkojnë ekonomitë pyjore për parandalimin e transportit të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të tjera me origjinë nga fondi pyjor si dhe në zonat e mbrojtura për parandalimin e gjuetisë së paligjshme.
3. Janë kryer gjithsej 88 monitorime në akset rrugore auto pyjore që përshkojnë ekonomitë pyjore për parandalimin e transportit të paligjshëm të materialit drusor dhe prodhimeve të tjera me origjinë nga fondi pyjor ku nuk janë evidentuar raste të tilla;
4. Gjatë këtij viti janë realizuar gjithsej 10 monitorime në zbatim të moratoriumit të gjuetisë, ku gjatë këtyre monitorimeve nuk është konstatuar të kryhej gjueti e paligjshme;
5. Është kryer inspektim/monitorim pranë Strukturës përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në pyje pranë bashkisë Mirditë;
6. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në Qarkun e Lezhës ka pasur 24 raste të rënies së zjarrit:
 - Sipërfaqe të përshkuar prej 1582.82 ha;
 - Sipërfaqe e djegur 838.47 ha;
 - Për të gjitha rastet e zjarreve në pyje kemi qënë të angazhuar për parandalimin, izolimin dhe shuarjen e tyre;
 - Gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 nga monitorimet e kryera në ekonomitë pyjore është vërejtur një përhapje e konsiderueshme e proçesionares në pyjet e pishës.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (FSHM):

Sektori i FSHM për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

- Gjatë muajit janar e në vazhdimësi është realizuar mbulimi i veprimtarisë administrative të shërbimit të protokollit dhe arkivës për regjimin hyrës/dalës të korrespondencës zyrtare, ku gjatë vitit 2024, në regjistrin shkresor të protokollit janë regjistruar në total 1116 shkresa dhe akte, nga të cilat 779 janë të regjimit dalës dhe 337 hyrës;
- Nga ana e sektorit tonë janë mbajtur regjistrat elektronikë ,të cilët janë përditësuar me informacione dhe të dhëna periodike sipas punës së realizuar në drejtori;
- Gjithashtu, sipas Urdhrit të Kryeinspektorit, është kryer raportimi javor dhe mujor si dhe dërgimi i tyre nëpërmjet postës zyrtare elektronike (email);
- Në vijim, në çdo fillim dite pune është mbajtur listëprezenca ditore e punonjësve të drejtorisë, si dhe ajo mujore në çdo fund muaji e cila është përcjellë në rrugë zyrtare me shkresë dhe e-mail pranë Sektorit të BMNj Qendër;
- Është realizuar planifikimi i lejeve vjetore të punonjësve për vitin 2024-2025 dhe ndjekja e zbatimit të tyre sipas grafikut të miratuar;
- Çdo muaj, sipas problematikave të ardhura dhe shkresave të adresuara pranë sektorit tonë, është bërë përgatitja e dokumentave dhe kthimi i përgjigjeve brenda afateve ligjore në fuqi;
- Nga ana e Specialistit (Jurist) është bërë përfaqësimi juridik për një çështje gjyqësore në mbrojtje të interesave të institucionit ,duke raportuar për cdo seancë mbi ecurinë e procesit gjyqësor pranë DR Juridike;
- Çdo muaj është realizuar raportimi periodik i veprimtarisë së institucionit tonë, pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, nëpërmjet postës elektronike;
- Gjithashtu kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për pajisje dhe mjete kancelarike sipas nevojave të drejtorisë ,për realizimin sa më efikas të proceseve operacionale që mbështesin institucionin në tërësi;
- Gjatë vitit është realizuar vlerësimi i performancës në punë për punonjësit e Drejtorisë tonë, dhe është përcjellë me shkresë pranë IKMT Qendër, sipas udhëzimeve të marra nga ana e Sektorit të MBNj;
- Çdo muaj është kryer përgatitja e dokumentave dhe faturave që vijnë në adresë të institucionit dhe dërgimi i tyre pranë DRFSHM për likuidim;
- Gjatë vitit është realizuar mbajtja e regjistrit të ankesave, përditësimi i tij sipas ndjekjes dhe trajtimit nga ana e sektorëve përkatës dhe raportimi periodik çdo të hënë pranë Dr.Informacionit, konkretisht 22 ankesa në total;
- Lidhur me çështjet gjyqësore të DRIKMT Lezhë, është realizuar brenda afateve dërgimi i fletë-thirrjeve/vendimeve pranë DR Juridike;
- Çdo fillim jave është dërguar formati i Ankesave të ardhura pranë DRIKMT Lezhë dhe të ndjekura nga sektorët përkatës;
- Angazhimi i grupit të punës për inventarizimin e dokumentave të arkivës për vitin 2023 dhe të pajisjeve të zyrës;
- Furnizimi me karburant për automjetet e drejtorisë, për realizimin e inspektimeve në terren nga sektorët e DRIKMT Lezhë si dhe përcjelljen e fletës së udhëtimit me pasqyrimin e lëvizjes së mjeteve pranë IKMT Qendër.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Evidentimin e problematikave si dhe përmirësimin e punës në marrjen e masave për parandalimin, evidentimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e ndërtimit të paligjshëm dhe në bashkëpunim me Policinë e Shtetit;
2. Inspektimet në zonat dhe objektet me rëndësi kombëtare sipas planit të punës;
3. Inspektimi i subjekteve për përdorim të burimeve ujore, lidhur me afatet e lejeve përkatëse;

4. Kontrollin e mbrojtjes së burimeve ujore për parandalimin e zhvillimit të veprimtarive të paautorizuara sipas legjislacionit në fuqi;
5. Kontrollin e zbatimit të legjislacionit mjedisor për subjektet që janë të pajisur me leje Mjedisit Tipi A dhe B;
6. Inspektime në zonat turistike Shëngjin - Tale përgjatë sezonit turistik lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane dhe trajtimin e ujërave të përdorura;
7. Përmirësimi i mëtejshëm në saktësinë e mbajtjes së procedurave online;
8. Për periudhën Janar - Dhjetor 2025 do të zhvillohen monitorime në ekonomitë pyjore të Qarkut Lezhë për evidentimin e problematikave si dhe përmirësimin e punës në marrjen e masave për parandalimin dhe prerjet e paligjshme, zënie të fondit pyjor e kullësor, transport të paligjshëm të materialit drusor apo produkte të tjera me origjinë nga fondi pyjor e kullësor si dhe në gjuetinë e paligjshme;
9. Bashkëpunim me organet e tjera ligjzbatuese për parandalimin e zjarreve si dhe shuarjen e tyre në rastet kur shfaqen;
10. Kryerja e trajnimeve të punës për punonjësit si dhe testimet periodike lidhur me njohuritë e marra.

XIX. VEPRIMATIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT GJIROKASTËR

Gjatë vitit 2024, kjo Drejtori ka përbushur detyrat institucionale për:

1. Mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e kundërligjshme në fushën e ndërtimit, mjedisit, ujërave dhe pyjeve;
2. Zbatimin e legjislacionit në përputhje me fushat përkatëse të inspektimit.
3. Mbikëqyrjen e IMT-ve përmes shqyrtimit të korrespondencave ose inspektimeve në subjektet ku IMT-ja ka vepruar;
4. Zgjidhjen me përparësi të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve;
5. Rritjen e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë në bashkëpunim me institucionet e tjera.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për:

1. Përbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për mbrojtjen e territorit, mjedisit, ujërave dhe pyjeve;
2. Ruajtjen dhe sigurinë e territorit në Qarkun Gjirokastrë, duke siguruar respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, burimeve ujore dhe produkteve të ndërtimit, si dhe ligjshmërinë në fushën e pyjeve, faunës së egër, kullotave, bimëve mjekësore eterovajore dhe tanifere natyrore;
3. Parandalimin, kontrollin dhe uljen e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës;
4. Mbikëqyrjen e zonave me rëndësi kombëtare, ku janë ushtruar kontrole të herëpashershme, konkretisht në pjesët muzeale dhe zonat e mbrojtura;
5. Parandalimin e gjuetisë së paligjshme dhe transportit ilegal të druve të zjarrit
6. Kontrollin e objekteve në zhvillim dhe mbikëqyrjen e IMT-ve në shkallë qarku;
7. Raportimet periodike të inspektimeve të kryera nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit, Pyjeve dhe Territorit;
8. Zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi në fushën e inspektimit të territorit;
2. Kryerja e inspektimeve në përputhje me programin e miratuar të punës, udhëzimet dhe rekomandimet e instancave eprore, si dhe bashkëpunimi me Drejtorinë dhe sektorët në qendër;

3. Rritja e gatishmërisë për zgjidhjen e ankesave nga platforma e bashkëqeverisjes dhe përmirësimi i bashkëpunimit me sektorët e tjerë;
4. Rritja e performancës në punë, përfshirë respektimin e standardeve të etikës profesionale;
5. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional.

Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Kryerja e inspektimeve për të monitoruar dhe siguruar zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi për fushën e mjedisit dhe ujërave;
2. Kontrolli i peizazhit për parandalimin e zhvillimit të veprimtarive të paautorizuara.

Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Pyjeve gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Përbushja e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e inspektimit të pyjeve;
2. Mbrojtja e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve;
3. Inspektimi i pyjeve në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
4. Kryerja e inspektimeve sipas programeve të miratuara;
5. Organizimi i punës në grup me qëllim përbushjen efektive të detyrave të sektorit.

Treguesit kryesorë të strukturave të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

1. Trajtimi efektiv dhe brenda afateve i praktikave të korrespondencës administrative;
2. Mbajtja dhe administrimi i protokollit, përfshirë delegimin e shkresave sipas sektorëve përkatës;
3. Përgatitja dhe administrimi i listëprezencës ditore dhe mujore;
4. Ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të disiplinës administrative në institucion.

Prioritetet:

- Zbatimi i legjislacionit në përpilimin dhe hartimin e shkresave, relacioneve dhe procesverbaleve;
- Trajtimi me përparësi i ankesave të ardhura nga qytetarët;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me IMT-të e Qarkut, DRTK, DVP, DV AHK, etj.;
- Kryerja e kontrolleve të detajuara në territor për të parandaluar ndërhyrjet e kundërligjshme;
- Hartimi i planeve të përbashkëta me Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër;

Prioritetet:

1. Zbatimi i legjislacionit në përpilimin dhe hartimin e shkresave, relacioneve dhe procesverbaleve;
2. Trajtimi me përparësi i ankesave të ardhura nga qytetarët;
3. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me IMT-të e Qarkut, DRTK, DVP, DV AHK, etj.;
4. Kryerja e kontrolleve të detajuara në territor për të parandaluar ndërhyrjet e kundërligjshme;
5. Hartimi i planeve të përbashkëta me Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër;

Strukturat Përbërëse të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale Gjirokastër përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit
2. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave
3. Sektori i Inspektimit të Pyjeve
4. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Sektori i Inspektimit të Territorit:

Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: (131 inspektime; 12 gjoba)

1. Në bazë të Urdhrave të Punës ka zbatuar me përpikmëri dispozitat ligjore në fuqi, si dhe Ligjin 9780 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
2. Ka trajtuar me përparësi dhe prioritet të gjitha ankesat dhe kërkesat e ardhura nga qytetarët pranë DR IKMT - Gjirokastrë;
3. Ka realizuar bashkëpunime institucionale me Policinë e Shtetit dhe IMTV-të e 7 Bashkive të Qarkut Gjirokastrë;
4. Janë mbajtur akte konform ligjit gjatë inspektimeve dhe monitorimeve të kryera përgjatë territorit;
5. Janë realizuar kontrollime të imtësishme në kantierët e ndërtimit, të mbajtura këto me Proçes-Verbale;
6. Realizimi i Planit Strategjik dhe objektivave për periudhën janar - dhjetor 2024.

Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave:

Për periudhën janar - dhjetor 2024, Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: (136 inspektime; 5 gjoba)

1. Kontrollin e peizazheve për parandalimin e zhvillimit të veprimtarive të paautorizuara;
2. Kontrollin e mbrojtjes së burimeve ujore për parandalimin e zhvillimit të veprimtarive të paautorizuara;
3. Zbatimin e detyrave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave;
4. Janë mbajtur akte konform ligjit gjatë inspektimeve dhe monitorimeve të kryera përgjatë territorit;
5. Ka trajtuar me përparësi dhe prioritet të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët.

Sektori i Inspektimit të Pyjeve:

Për periudhën janar - dhjetor 2024, Sektori i Inspektimit të Pyjeve e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime: (98 inspektime; 0 gjoba)

1. Kontrollin në akset kryesore të qarkut për parandalimin e transportit ilegal të druve të zjarrit;
2. Kontrollin në zonat me rëndësi kombëtare si parqe kombëtare, park rajonal natyror etj.;
3. Zbatimin e detyrave ligjore në fushën e pyjeve dhe kullotave;
4. Ka trajtuar me përparësi dhe prioritet të gjitha ankesat e ardhura nga qytetarët;
5. Janë mbajtur akte konform ligjit gjatë inspektimeve dhe monitorimeve të kryera përgjatë territorit.

Sektori i Shërbimeve Mbështetëse:

Për periudhën janar - dhjetor 2024, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Mbajtja e listëprezencës ditore;
2. Administrimi i dokumentacionit;
3. Ndjekja dhe trajtimi i korrespondencës shkresorese hyrëse dhe dalëse;
4. Përgatitja e programeve periodike mujore të punës së sektorit;
5. Inventarizimi i dosjeve.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës, rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Sipas Urdhër Nr.29, dt 30.08.2023, Nr. 374 Prot. i Inspektoratit Qëndror, z. Shkëlqim Hajdari, ku përcaktohen kompetencat për ushtrimin e kontrolleve në subjektet me dhe pa leje mjedisore, IKMT i është hequr e drejta për të realizuar kontrolle dhe inspektime në subjektet me leje mjedisore. Kjo ka bërë që numri i inspektimeve online të programuara të ketë rënie;
2. Konstatimet e kryera në terren për ndërtimet dhe punimet kanë patur rritje si pasojë e rritjes së interesit nga qytetarët për ndërtimet e reja në zonën muzeale dhe zonat me rëndësi kombëtare;
3. Janë kryer të gjitha detyrat dhe rekomandimet e lëna nga Auditi, specialistët e Sektorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe ato të dhëna nga Titullari i Institucionit;
4. Mbajtja e kontakteve të përditshme të adresës elektronike të institucionit, kthimi në kohë i përgjigjeve të problematikave të kërkuara nga IKMT Qëndrore dhe institucionet e tjera.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Forcimi i kontrollit të ushtruar në territor për ndërtimet dhe punimet pa leje;
2. Forcimi i ushtrimit të kontrollit për mbrojtjen e burimeve ujore, veçanërisht lumi "Vjosë" dhe degëzimet e tij, tashmë i mbrojtur;
3. Kontroll në territor për menaxhimin e integruar të mbetjeve, venddepozitimet dhe diferencimi i tyre;
4. Kontroll në terrenet pyjore nga dëmtimet, ku prioritet kanë zonat e mbrojtura;
5. Kontroll të vazhdueshme në zonat me rrezik për zhvillimin e gjuetisë;
6. Zgjidhja në kohë e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve;
7. Mbajtja dhe forcimi i marrëdhënieve me të tretë;
8. Përpilimi i shkresave dhe dërgimi në kohë i tyre pranë organit epror.

XX. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT KORÇË

Gjatë vitit 2024, për këtë drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

- Kontrolli, mbrojtja e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, kontrolli i zbatimit të projekteve në objektet me leje ndërtimi, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore;
- Mbrojtjen e mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit;
- Kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e peisazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e pyjeve;
- Rritja e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të kësaj drejtorie, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera.

Strukturat Përbërëse të IKMT DR Korçë

- IKMT Drejtoria Rajonale Korçë përbëhet nga sektorët si vijon;
- Sektori i Inspektimit të Territorit, ka në strukturë 3 inspektorë dhe 1 përgjegjës sektori;
- Sektori i Inspektimit Pyjor, ka në strukturë 7 inspektorë dhe 1 përgjegjës sektori;
- Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave, ka në strukturë 6 inspektorë dhe 1 përgjegjës sektori;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, ka në strukturë 2 specialistë dhe 1 përgjegjës sektori (mungon specialisti i financës).

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

- Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për Vitin 2024;
- Veprimtari inspektuese dhe kontrolluese e pandërprerë për mbikëqyrjen e territorit lidhur me fushën e ndërtimit, atë të mjedisit dhe pyjeve dhe parashikimin për të adresuar dhe parandaluar kundërvajtje;
- Veprimtari administrative e cila identifikon risqet e menaxhimit financiar, mirëmenaxhimin e aseteve dhe burimeve njerëzore dhe praktikat ligjore që duhen zbatuar në këto raste;
- Menaxhimi i informacionit dhe komunikimi, i cili parashikon mirëadministrimin e shërbimeve online, programet specifike që duhen përdorur dhe një transparencë dhe efikasitet sa më të madh në komunikimin me publikun;
- Azhurnimi i legjislacionit dhe njohja me ndryshimet ligjore për trupën inspektuese;
- Koordinim efikas dhe i shpejtë me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera vendore për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe administrative;
- Hartimi i regjistrit të riskut bazuar në Ligjin 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Hartimi planit të integritetit dhe planin e veprimit, i cili është një dokument mjaft i rëndësishëm që ka të bëjë me mbarrëvajtjen e veprimtarisë, efikasitetin dhe realizimin e objektivave të paracaktuara nga ky institucion; Ky plan krijon një sistem të mirëorganizimit dhe mirëfunksionimit institucional, detajon hapa të rëndësishëm në fushën e integritetit, etikës, transparencës dhe paanësisë së institucionit;
- Inspekte në zbatim të Urdhërit Nr.44, datë 16.02.2024 të Ministrit të Brendshëm, “Për marrjen e masave të menjëhershme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore”;
- Inspekte në zbatim të Urdhërit Nr. 373, datë 17.04.2024 i Kryeinspektorit të IKMT, “Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve” nga IKMT DR Korçë, nga e cila është miratuar Plani i Veprimit “Për marrjen e masave në kuadër të Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik 2024”;
- Bazuar në Urdhërin 98, “Për krijimin dhe plotësimin e regjistrave elektronikë në IKMT”, institucioni dhe sektorët përkatës kanë përfunduar hedhjen e të dhënave për periudhën Janar-Dhjetor 2024 për çdo shkresë të ardhur në institucion dhe inspektimet e kryera në territor;
- Kontroll dhe monitorim brenda perimetrit të sigurisë në shkolla në lidhje me sigurimin teknik në objektet në proces ndërtimi dhe kontroll në lidhje me mbetjet inerte dhe urbane;
- Vlerësimi i përgjegjësave të sektorëve si dhe inspektorëve/specialistëve;

Planet Mujore, Vjetore: afatet, formatet, pëmbajtja, objektivat:

IKMT Drejtoria Rajonale, Korçë ka ushtruar aktivitetin e saj, bazuar në planet mujore, të cilat janë dërguar brenda afateve ligjore me formë shkresore dhe email, pranë IKMT qendër. Përsa i përket planeve mujore, ato përpilohen dhe firmosen nga inspektorët për çdo sektor të kësaj drejtorie, të cilat miratohen nga përgjegjësat e sektorëve dhe në bazë të tyre përpilohet plani mujor për të gjithë drejtorinë, i cili dërgohet për miratim Kryeinspektorit.

Planet e punës përpilohen në mënyrë tabelore ku përcaktohen zonat që do të monitorohen në territor (prioritet i jepet zonave me rëndësi kombëtare) për çdo sektor, verifikimi i informacioneve dhe ankesat e ardhura nga të tretë, si dhe objektivat që do të arrihen nga sektorët. Përsa i takon përbajtjes së planeve mujore, duhet të sqarojmë se programimi i tyre bëhet në përgjithësi, pasi për të tre sektorët kryhet monitorim në territor, dhe nuk mund të parashikojmë veprimtarinë e kundërligjshme, që do të konstatohen në territor ose informacionet nga të tretë.

Ndërkohë për SIT nuk kemi akses në lejet e ndërtimit që miratohen, megjithatë iu është kërkuar bashkive disa here në mënyrë shkresore. Në këto kushte inspektimet kryhen nga monitorimi në terren. Ndërkohë për SIMU përveç planit të përgjithshëm është përgatitur edhe plani mujor për inspekte on-line brenda datës 10 të çdo muaji, i cili është dërguar pranë DIMU IKMT qendër për

miratim nga IQ. Me ardhjen e konfirmimit nga DIMU IKMT për miratimin nga IQ, janë gjeneruar në sistem dhe kanë dalë autorizimet përkatëse.

Duhet të theksojmë se për Sektorin e Inspektimit në Territor, mosdhënia e informacionit të lejeve të ndërtimit, deklaratave paraprake për punime nga Drejtorite e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) nga Bashkitë Korçë, Pogradec si dhe mospatja akses në sistemin e-leje, sjell vështirësi në programimin e planeve të detajuara për inspektim. Pra, në lidhje me objektet me leje ndërtimi, inspektimi kryhet nga monitorimi i territorit dhe në rast konstatimi, kryhet kontrolli në dokumentacion dhe verifikim i zbatimit të zbatimit të projektit të miratuar.

Analizë e të dhënave mes Planeve Mujore dhe Raportimeve Mujore : raporti mes objektivave dhe përmbushjes së tyre, pikat e parealizuara, arsyet, konkluzionet

Nëqoftëse do të krahasojmë planet mujore dhe raportimet mujore, mund të themi se IKMT Drejtoria Rajonale, Korçë i ka përmbushur në përgjithësi objektivat e vendosura. Vëmendja e kësaj drejtorie është përqendruar:

- Veprimtari inspektuese dhe kontrolluese e pandërprerë për mbikqyrjen e territorit lidhur me fushën e ndërtimit, atë të mjedisit dhe pyjeve dhe parashikimin për të adresuar dhe parandaluar kundërvajtjet;
- Bashkëpunim me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera vendore për parandalimin e veprimtarive të kundraligjshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe administrative;
- Kontroll dhe monitorim brenda perimetrit të sigurisë në shkolla në lidhje me sigurimin teknik në objektet në proces ndërtimi dhe kontroll në lidhje me mbetjet inerte dhe urbane;
- Inspektime në zbatim të Urdhërit Nr.44, datë 16.02.2024, e Ministrit të Brendshëm, “Për marrjen e masave të menjëhershme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore”;
- Inspektime në zbatim të Urdhërit Nr. 373, datë 17.04.2024, i Kryeinspektorit të IKMT, “Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve” nga IKMT DR Korçë ka miratuar Planin e Veprimit “Për marrjen e masave në kuadër të Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik 2024” dhe Planin e Veprimit të IKMT DR Korçë Nr.537/1 prot. datë 04.06.2024;
- Verifikimi dhe zgjidhja e ankesave të ardhura në drejtori nga të tretë;
- Monitorim në territor në lidhje me mbetjet inerte dhe urbane;
- Inspektim në subjekte që përbëjnë risk për mjedisin, konkretisht Hoteleri, Thertore, Fabrika të përpunimit të qumështit (baxho), servise, gomisteri.

Numri i inspektimeve të kryera, nr. i PVK, nr. i vendimeve për prishje objekti dhe nr. i vendimeve për prishje të paekzekutuara, mënyra e formimit të grupeve të inspektimit, realizimi i inspektimeve: procedura dhe rezultatet, raporti mes kontrolleve të kryera dhe rezultateve të inspektimit si dhe çdo e dhënë tjetër me interes në lidhje me inspektimet.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se, ka rritje të disa treguesve të punës, si më poshtë:

Për periudhën që po flasim, kemi :

Të dhënat kryesore të IKMT DR Korçë:

Treguesit kryesor të strukturave të Drejtorisë IKMT Korçë gjatë vitit 2024 janë mbajtur 1035 inspektime dhe janë dërguar gjithsej 506 shkresa në mënyrë postare ose me postë elektronike. Konkretisht:

	Nr, i inspekti meve me kundërva jtje	PVKK	Vendim Gjobë/lekë	Vendi m Prishje	Vendim prishje të ekzekut uara	Zjarret sip/ha			Vlerësim dëmi/lekë	Material Drusor i Sekuestruar
						pyje	kullota	shkure		
SIT	18	18	7 subjekte në total 39.350.000	19	14					
SIMU	13		8.500.000							
SIP	6					619 ha e përshkruar dhe 151 ha e djegur	2709 ha	7.7 ha	1.165.000	47.4mst, nga të cilat 34mst Ah dhe 14mst Dushk

Sektorit të Inspektimit në Territor

Gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

18 (tetëmbëdhjetë) PVKK për Sektorin e Inspektimit të Territorit, nga të cilat 18 (tetëmbëdhjetë) Vendime prishje, 7 (shtatë) subjekte me Vendime gjobe në vlerën totale 39.350.000 (tridhjetëenëntëmilionetreqindpesëdhjetëmijë) lekë dhe 13 (trembëdhjetë) Vendime prishje të ekzekutuar.

Përsa i takon vendimeve për prishje të objekteve të kundërligjshme, për periudhën Janar 2024 – Dhjetor 2024, IKMT DR Korçë ka 5 (pesë) vendime të paekzekutuar për stacione plazhi. Në lidhje me ankesat e ardhura në drejtori, është kryer verifikimi dhe zgjidhja e tyre në kohë dhe iu është kthyer përgjigje ankuesve. Nga 35 (tridhjetëepesë) ankesa të ardhura, 31 (tridhjetenjë) janë të zgjidhura dhe 4 (katër) janë në proces. Janë kryer 224 (dyqindënjëzetekatër) korrespondenca zyrtare me qytetarë dhe institucione qendrore dhe vendore.

Janë kryer 258 (dyqindëpesëdhjetëetetë) akte inspektimi (nga të cilat 103 (njëqindetre) janë inspektime të përbashkëta me Sektorin e Mjedisit dhe Ujërave, në zbatim të Urdhërit Nr. 44 datë 16.02.2024 të Ministrit të Brendshëm), ku përfshihen shqyrtimi i ankesave, kontrolli në objekte me leje, inspektimi në lidhje me stacionet e plazhit për sezonin turistik 2024, monitorime në shkolla për perimetrin e sigurisë dhe inspektime në lidhje me ndërtimet në zbatim të Urdhërit Nr. 44 datë 16.02.2024 të Ministrit të Brendshëm, “Për marrjen e masave të menjëhershme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore”.

Janë kryer monitorime brenda perimetrit të sigurisë në 32 (tridhjetëedy) shkolla, si për sigurimin teknik në lidhje me objektet në proces ndërtimi. Gjatë këtyre kontrolleve nuk janë konstatuar problematika. Në pamundësi për të monitoruar të gjitha shkollat në qarkun e Korçës, për shkak të largësisë së tyre, iu jemi drejtuar në rrugë shkresore IMT-ve të bashkive të Qarkut Korçë (Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll, Maliq dhe Pustec) duke kërkuar verifikime të herëpashershme për respektimin e rregullave të sigurimit teknik të perimetrit të sigurisë së shkollave.

Nisur nga Urdhëri Nr. 373, datë 17.04.2024 i Kryeinspektorit të IKMT, “Për ngritjen e grupit të punës në lidhje me kontrollin e zonave të plazheve”, nga IKMT DR Korçë është miratuar Planin i Veprimit “Për marrjen e masave në kuadër të Task-Forcës Ndërinstitucionale të sezonit turistik 2024”. Ky plan ka përfshirë monitorimin përgjatë vijës liqenore të Liqenit të Ohrit për

verifikimin e situatës në lidhje me çmontimin e objekteve provizore të ngritura përgjatë bregut të liqenit për sezonin turistik 2024 dhe kthimin e territorit në gjendjen e mëparshme në kuadër të planit të veprimit “Bregdeti ynë”.

Nga inspektimi janë konstatuar gjithsej 20 (njëzet) struktura provizore, 5 (pesë) struktura provizore ishin të paçmontuara, të cilave iu kishte mbaruar kontrata dhe u mbajtën Proces verbal kundërvajtjeje, për të cilat dolën Vendime prishje dhe Vendim gjobe në total 25.350.000 (njëzetepesëmilionetreqindepesëdhjetëmijë) lekë.

Ndërkohë për periudhën korrik dhe gusht kemi ulje të inspektimeve, për shkak të mungesës së inspektorëve në sektorin e Inspektimit të Territorit, për arsye të largimit të një inspektori dhe një inspektor tjetër ka qenë me raport mjekësor, dhe aktualisht kemi qenë me 1 (një) inspektor.

Në lidhje me ankesat, vihet re se përgjithësisht ankesat janë për ndërtime të kryera vite më parë. Por, mosdërgimi i informacioneve të kërkuara për dokumentacionin e kërkuar nga ana jonë në lidhje me problematikat e hasura në terren, nga DPKZHT pranë bashkive përkatëse, sjell vështirësi për institucionin tonë për zgjidhjen e tyre në afat.


Në disa raste, kemi mungesë të bashkëpunimit ndërinstitutional me njësitë e qeverisjes vendore, në rastet e evidentimit të problematikave, duke mos kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara ligjore, ose informacioni i dërguar ka qenë i cunguar ose i paqartë, gjë që përbën pengesë për zgjidhjen e problemit në kohën e duhur ose nuk veprohet me pretekstin se është zonë me rëndësi kombëtare dhe nuk është kompetencë e IVMT-ve.

IKMT DR Korçë ka patur bashkëpunim me Policinë e Shtetit Korçë dhe konkretisht në lidhje me verifikimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) informacioneve, për të cilat jemi vënë në dijeni nga Komisariati i Policisë Korçë mbi ndërtimet pa leje, për të cilat është kërkuar informacion nga IMT vendore ose është vepruar nga ana jonë për zgjidhje përfundimtare të tyre.

Inspektimet e kryera nga Sektori i Inspektimit në Territor (SIT)


	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Kontrollet/inspektimet e kryera për Sek. Inspektimit ne Territor (SIT)	21	31	2	27	14	8	13	6	5	15	6	7	155
Inspektime të përbashkëta në zbatim të Urdhërit nr.44 date 16.02.2024 të Ministrisë të Brendshëm	0	48	55	0	0	0	0	0	0	0	0	0	103

SIT + SIMU													
Total	21	79	57	27	14	8	13	6	5	15	6	7	258




Korrenspondenca në zgjidhje të problematikave të dala, numri i ankesave të marra, problematikat e evidentuara

	<i>Janar 2024</i>	<i>Shkurt 2024</i>	<i>Mars 2024</i>	<i>Prill 2024</i>	<i>Maj 2024</i>	<i>Qersh or 2024</i>	<i>Korri k 2024</i>	<i>Gusht 2024</i>	<i>Shtat or 2024</i>	<i>Tetor 2024</i>	<i>Nento r 2024</i>	<i>Dhjetor r 2024</i>	<i>Total</i>
Korrenspondenca nga Inspektimi Territorial Sek. ne	15	21	20	19	52	25	11	11	10	25	3	12	224



<i>Ankesa</i>	<i>Janar 2024</i>	<i>Shkurt 2024</i>	<i>Mars 2024</i>	<i>Prill 2024</i>	<i>Maj 2024</i>	<i>Qershor 2024</i>	<i>Korrik 2024</i>	<i>Gusht 2024</i>	<i>Shtator 2024</i>	<i>Tetor 2024</i>	<i>Nentor 2024</i>	<i>Dhjetor 2024</i>	<i>Total</i>
Ankesa të ardhura për shqyrtim nga Sek. Inspektimi Territorial	3	3	3	3	2	5	5	3	4	3	0	1	35



Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave (SIMU)

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, SIMU ka kryer në total 434 (katërqindetridhjetekatër) inspektime, ku 331 (treqindetridhjetenjë) janë inspektime të SIMU dhe 103 (njëqindetre) inspektime janë kryer në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit të Territorit në kuadër të zbatimit të Urdhërit Nr. 44, datë 16.02.2024 të Ministrit të Brendshëm “Për marrjen e masave të menjëhershme për kontrollin, mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme përgjatë autostradave, rrugëve interurbane kryesore dhe rrugëve interurbane dytësore” si dhe në mbështetje të Aktit Normativ Nr. 3, datë 07.09.2011 “Për heqjen e mjeteve motorrike, të rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit, të dala jashtë përdorimit, që ndodhen pranë rrugëve kombëtare”.

Gjatë vitit 2024, vëmendje e veçantë është kushtuar evidentimit të pikave të vendgrumbullimit të mjeteve motorrike, rimorkiove, si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit në afërsi të akseve kombëtare në Qarkun e Korçës. Në periudhën Shkurt-Maj 2024 janë ushtruar 208 (dyqindetetë) kontrolle në subjektet që ushtronin veprimtarinë në afërsi të akseve rrugore kombëtare Korçë-Pogradec, Korçë-Bilisht dhe Korçë-Ersekë. 5 (pesë) subjekte, konkretisht Rolando Zhuleku, Ermal Fifo, Genardi Jashiku, Armando Rehova dhe Raidmond Dukati janë ndëshkuar me masë administrative (gjobë), në total në shumën 3.000.000 (tremilion) Lekë, dhe 2 (dy) subjekte janë ndëshkuar edhe me dënim administrativ plotësues (pezullim aktiviteti).

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave në IKMT Korçë ka vendosur gjithashtu 8 (tetë) masa administrative të tjera (gjobë) në vlerën totale të 5.500.000 (pesëdhjetëepesëmilion) Lekë për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi në fushën e mjedisit. Subjektet ndëshkuar janë: “SELENICA BITUMINOUS GRAVEL” shpk (tre gjoba), “Iljas Mançellari”, “Ferdinand Mehmeti”, “Armand Palla”, “Shaka Boboshticë” shpk, “Spiro Roça” shpk. Në total janë vendosur 13 (trembëdhjetë) masa administrative me një vlerë prej 8.500.000 (tetëdhjetëepesëmijë) Lekë.


Gjithashtu, gjatë vitit 2024, është dhënë vëmendje e madhe edhe zbatimit të paketës së sigurisë në shkollat. Ka dalë 1 (një) Urdhër sekuestro mjeti që është përdorur për kundërvajtje dhe është kryer 1 kallëzim penal. Përgjatë vitit 2024, janë kryer 83 (tetëdhjetëtre) inspektime në shkollat 9-vjeçare

dhe të mesme, publike dhe jopublike në Qarkun e Korçës, me qëllim evidentimin e problematikave të ndryshme në fushën e mjedisit brenda perimetrit të sigurisë në shkolla.

Për më tepër, Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave ka trajtuar gjithashtu 10 (dhjetë) ankesa të depozituara pranë IKMT, Korçë nga qytetarë dhe institucione të ndryshme. Sektori ka shkëmbyer gjithsej 183 (njëqindetëtdhjetëtre) korrespondenca zyrtare të ndryshme me qytetarë dhe institucione qendrore dhe vendore përgjatë vitit 2024.


Inspektimet e kryera nga SIMU IKMT DR Korçë

	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Kontrollet/in spektimet e kryera për Sek. Inspektimit të Mjedisit dhe Ujrave (SIMU)	17	40	40	38	13	18	21	21	56	42	17	8	331
Inspektime të përbashkëta në zbatim të Urdhërit nr.44 date 16.02.2024 të Ministrit të Brendshëm SIMU & SIT	0	48	55	0	0	0	0	0	0	0	0	0	103
Total													434




Korrenspodenca në zgjidhje të problematikave të dala, numri i ankesave të marra, problematikat e evidentuara

	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Korrenspodenca SIMU	27	38	13	12	49	13	13	4	0	3	10	1	183



Ankesa	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Ankesa të ardhura për shqyrtim nga SIMU	0	3	0	1	0	2	1	0	1	1	1	0	10



Sektori i Inspektimit të Pyjeve (SIP):

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, Sektori i Inspektimit Pyjor ka kryer gjithsej 446 (katërqind dyzet e gjashtë) inspektime në kuadër të parandalimit të veprimtarive të paligjshme në fushën e prerjes dhe transportit të lëndës drusore, si dhe të materialit drusor, parandalimit të gjuetisë së paligjshme dhe transportit të bimëve medicinale.

Trupat inspektuese të Sektorit të Inspektimit Pyjor gjatë vitit 2024 kanë konstatuar 6 (gjashtë) raste të prerjes së paligjshme të pyjeve dhe transportit të materialit drusor. Konkretisht:

- Në 4 (katër) raste, individët Arjan Orhan, Ardit Pinderi, Armand Nake dhe Luan Maxhari janë kapur duke transportuar material drusor të prerë në mënyrë të paligjshme;
- Në 2 (dy) raste të tjera, materiali drusor ishte i prerë, por nuk u bë e mundur identifikimi i autorëve.

Sasia totale e materialit drusor të sekuestruar, e cila më pas iu dorëzua punonjësve të policisë së komisarivateve të Korçës ose Drejtorive të Pyjeve dhe Kullotave të Bashkive të Qarkut Korçë, ishte 55.5 metra kub. Vlera e dëmit, sipas procesverbaleve të vlerësimit të mbajtur nga trupat inspektuese, arriti në 1,665,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Gjithashtu, vlen të theksohet bashkëpunimi i mirë ndërmjet Sektorit të Inspektimit Pyjor dhe Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit të Qarkut Korçë, si dhe komisarivateve të Policisë Korçë, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e rasteve të prerjes së paligjshme të pyjeve.


Gjatë vitit 2024 janë trajtuar gjithashtu 2 (dy) ankesa të depozituara pranë IKMT-së në Korçë. Lidhur me zjarret e rëna në Qarkun e Korçës, situata është si më poshtë:

- Në pyjet bashkiake: 250 ha sipërfaqe e përshkruar nga zjarri, 151 ha e djegur dhe 7.7 ha sipërfaqe me shkurre;
- Në pyjet shtetërore (zonat e mbrojtura): 369 ha sipërfaqe e përshkruar në Parkun Kombëtar të Prespës dhe 2,709 ha sipërfaqe kullotash e djegur.

Ndërkohë, Sektori i Inspektimit Pyjor ka shkëmbyer 29 (njëzet e nëntë) korrespondenca zyrtare me qytetarë dhe institucione qendrore e vendore, si dhe ka trajtuar 2 (dy) ankesa të tjera gjatë vitit 2024.


Inspektimet e kryera nga SIP IKMT DR Korçë:

	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Kontrollet/inspektimet e kryera për Sek. Inspektimit Pyjor (SIP)	34	40	34	40	43	33	33	44	40	46	29	30	446




Korrenspodenca në zgjidhje të problematikave të dala, numri i ankesave të marra, problematikat e evidentuara

	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Korrenspodenca nga SIP	3	3	5	7	4	2	2	1	1	1	0	0	29



Ankesa	Janar 2024	Shkurt 2024	Mars 2024	Prill 2024	Maj 2024	Qershor 2024	Korrik 2024	Gusht 2024	Shtator 2024	Tetor 2024	Nentor 2024	Dhjetor 2024	Total
Ankesa të ardhura për shqyrtim nga Sek. Inspektimit Pyjor	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	2



Nëse shqyrtojmë dhe analizojmë të dhënat e mësipërme, mund të konstatojmë si vijon:

- Lidhur me përfshirjen e subjekteve në inspektim, inspektimet dhe monitorimet janë kryer në prani të subjekteve. Megjithatë, ka pasur raste kur subjektet kanë refuzuar të firmosin inspektimet, edhe pse kanë qenë të pranishëm gjatë procesit;

- Numri i ulët i inspektimeve nga Sektori i Inspektimit në Territor shpjegohet nga përbërja e tij me vetëm 3 (tre) inspektorë, gjë që mundëson krijimin e vetëm një grupi inspektimi. Në krahasim, sektorët e tjerë arrijnë të krijojnë 2-3 grupe inspektimi, çka sjell edhe një numër më të lartë inspektimesh.

Sektori i Financës dhe Burimeve Mbështetëse (SFSHM)

- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria Rajonale Korçë, i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në zbatim të Urdhërit Nr. 424, datë 25.11.2020 Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet administrative”, Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, e ndryshuar, Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011, Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Përgjatë vitit 2024 SFSHM ka përgatitur planet e punës vjetore dhe mujore;
- Në zbatim të Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”ka kryer protokollin e dokumentave hyrëse dhe dalëse, korrespondencën zyrtare dhe dërgimin në destinacion brenda afateve ligjore. Është kryer mbajtja e evidencave dhe hedhja e tyre në regjistër dhe janë kryer veprimet përkatëse në rastet e vendimeve me gjobë nga sektorë e inspektimit në tërren dhe dërgimi i dokumentacionit përkatës pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në IKMT;
- Është kryer mbajtja e evidencave të gjobave dhe hedhja e tyre në regjistër dhe në cdo rast dokumentacioni është dërguar pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në IKMT, Tiranë. Vlera totale e masave administrative (gjobë) të vendosura është 47.850.000 (dyzeteshtatëmilione pesëdhjetëmijë) Lekë, nga të cilat, 8.500.000 (tetëmilione pesëqindmijë) Lekë janë vendosur nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave dhe 39.350.000 (tridhjetëenëntë milionetreqindpesëdhjetëmijë) Lekë janë në Sektorin e Inspektimit në Territor;
- Gjithashtu, përsa i përket aspektit ligjor, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka dërguar në afat në Drejtorinë e Inspektimit Juridik të gjitha njoftimet, aktet, kërkesë paditë e mbërritura nga Gjykatat Administrative respektive (Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë) në lidhje me proceset gjyqësore ku IKMT DR Korçë apo IKMT Qendër kanë qenë në cilësinë e palës së paditur ose palës paditëse;
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka tërhequr pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë çdo vendim të kësaj gjykate në procese në të cilat IKMT DR Korçë, ka qenë palë ndërgjyqëse duke e dërguar praktikën e plotë në mënyrë të menjëhershme në Drejtorinë e Inspektimit Juridik si dhe cdo akt tjetër të kërkuar nga kjo Drejtori;
- Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, SFSHM ka zbatuar në afat Urdhërin e Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit “Për Raportim të Aktiviteteve të Strukturave Qendrore dhe Rajonale” duke raportuar në afat veprimtarinë mujore dhe javore të institucionit.

Më konkretisht janë dërguar të plotësuara në Drejtorinë e Informacionit tabelat në lidhje me veprimtarinë mujore të IKMT-së DR Korçë;

- Gjithashtu janë dërguar në Drejtorinë e Informacionit në afat informacionet periodike javore në lidhje me veprimtarinë të IKMT DR Korçë dhe inspektimet e kryer, zbatimin e procedurave të trajtimit të ankesave për çdo kërkesë/ankesë drejtuar IKMT-së. Më konkretisht janë dërguar të plotësuara në Drejtorinë e Informacionit tabelat mujore dhe periodike në lidhje me ankesat e depozituara/trajtuara nga IKMT DR Korçë;
- Nga ana tjetër, Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në korrespondencën zyrtare që ka patur me organet ligjzbatuese përgjatë vitit 2024 ka vënë në dispozicion dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar dhe më konkretisht 6 (gjashtë) korrespondenca me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë dhe 1 (një) korrespondencë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Elbasan;
- Gjithashtu, në 4 (katër) raste Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka vënë në dispozicion informacion dhe dokumentacion me përfaqësues ligjorë të palëve me të cilat IKMT DR Korçë është në proces gjyqësor ose palë në proces administrativ;
- SFSHM ka kryer hartimin e buxhetit në afat dhe sipas kërkesave të ligjit mbi buxhetin;
- Në zbatim të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit publik”, i ndryshuar është kryer në bashkëpunim me komisionin e ngritur nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit inventarizimi i aktiveve afatmesme dhe afatgjata;
- Në zbatim të Urdhërit Nr. 424, datë 25.11.2020 të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e rregullores së brendshme të funksionimit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, janë kryer veprimet përkatëse në lidhje me përgatitjen e listë-prezencës, evidentimin e mungesave dhe për rastet e mungesave të arsyetuara është administruar dokumenti justifikues;
- Është punuar në lidhje me inventarin e brendshëm i dosjeve për vitin 2021 si dhe është ngritur komisioni i ekspertizës, është hartuar lista tip me afatet konkrete të ruajtjes së dokumentave arkivore si dhe është çelur pasqyra emërtuese e dosjeve;
- Ndërkohë, që Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka shkëmbyer 70 (shtatëdhjetë) korrespondenca zyrtare të ndryshme me Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Qendër si dhe institucione qendrore dhe vendore përgjatë vitit 2024.

Mangësi dhe problematika :

1. Mosnjohja e plotë e kuadrit ligjor nga inspektorët, mosqenia e ekspertëve të fushës dhe eksperiencia e kufizuar e tyre, shkakton vështirësi në shqyrtimin dhe verifikimin e ankesave ose inspektimeve të kryera në subjekte sipas planeve mujore;
2. Mostrajnimi i stafit në lidhje me plotësimin e procedurave në sistemin e inspektimit online (autorizim, listë verifikimi, procesverbal, vendim përfundimtar) ka sjellë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit online;
3. Mungesa e një automjeti për kryerjen e inspektimeve në zonat me rëndësi kombëtare dhe urbane dhe rurale deri në gusht 2024 ka paraqitur vështirësi. Duke pasur parasysh faktin se ushtrimi i detyrave, sidomos kontrolli i hapësirave të shfrytëzuara për lëndë drusore në pyje, ndjekja, parandalimi dhe goditja e aktiviteteve të paligjshme si gjuetia e paligjshme etj., ndodhin në terrene malore, në zona të largëta dhe të pakontrollueshme me këmbë, sektoret e inspektimit kanë hasur vështirësi të mëdha në përmbushjen e detyrave dhe evidentimin e shkeljeve në kohe;
4. Mungesa e karburantit ka paraqitur vështirësi në lidhje me zbatimin e detyrave të caktuara;

5. Mungesa e ambienteve të punës ka sjellë vështirësi në menaxhimin e punës (IKMT DR Korçë zhvillon aktivitetin në ambiente me sipërfaqe prej 47 m²);
6. Mungesa e pajisjeve elektronike (kompjuterë, printera) në institucion ka penguar kryerjen efikase dhe brenda afateve kohore të detyrave të ngarkuara;
7. Në shumë raste ka munguar bashkëpunimi ndërinstitutional me njësitë e qeverisjes vendore, sidomos në rastet e evidentimit të problematikave, ku nuk janë kthyer përgjigje brenda afateve ligjore ose informacioni i dërguar ka qenë i cunguar ose i paqartë, gjë që ka penguar zgjidhjen e problemeve në kohe;
8. Mosdhënia e informacionit për lejet e ndërtimit dhe deklaratat paraprake për punime nga Drejtoritë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkive Korçë dhe Pogradec, si dhe mospasja e aksesit në sistemin e-leje ka sjellë vështirësi në programimin e planeve të detajuara për inspektim;
9. Mosdërgimi i informacioneve të kërkuara për dokumentacionin lidhur me problematikën e hasura në terren nga DPKZHT pranë bashkive përkatëse ka sjellë vështirësi në zgjidhjen e tyre në afat;
10. Mungesa e stafit të specializuar në një numër të konsiderueshëm të inspektoriateve vendore ka shkaktuar mosushtrimin e përgjegjësisë të përcaktuara nga ligji nga inspektoriate vendore ose shmangie të përgjegjësisë. Ka ende IMT pranë bashkive që kanë vetëm 1 inspektor (Bashkia Pustec);
11. Në disa raste, mosnjohja e detajuar e kuadrit ligjor nga inspektorët e IMT-ve ka sjellë shqyrtimin dhe verifikimin e ankesave jashtë afateve të përcaktuara ose mosveprim sipas kompetencave ligjore;
12. Theksojmë se në disa raste nuk ekzekutohen vendimet e prishjes të marra nga IMT, me justifikimin se nuk disponojnë mjete prishëse;
13. Në disa raste, IMT vendore nuk veprojnë në zonat me rëndësi kombëtare, duke u justifikuar se kjo është jashtë kompetencave të tyre, ndërkohë që IMT vendore kanë përgjegjësinë për kontrollin e territorit dhe zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike dhe kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, për ato që parashikohen shprehimisht në ligje të tjera, brenda territorit administrativ të kësaj njësie;
14. Në disa raste ka munguar bashkëpunimi me institucione të tjera vendore ose shmangie e përgjegjësisë të tyre për zgjidhjen e problematikave që lidhen me ndotjen e mjedisit, pyjeve dhe territorit;
15. Mungesa e dosjeve dhe kutive standard për ruajtjen e dokumenteve arkivore;
16. Mungesa e një vendruajtjeje të posaçme për ruajtjen e dokumenteve arkivore;

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës, rezulton se ka një rritje të disa treguesve të punës, si më poshtë:

- Rritje e numrit të inspektimeve për të tre sektorët;
- Numri më i vogël i inspektimeve për sektorin e Inspektimit në Territor është për shkak të përbërjes me vetëm 3 (tre) inspektorë, që krijon vetëm një grup inspektimi, ndërsa për sektorët e tjerë krijohen 2-3 grupe inspektimi, gjë që çon në një rritje të inspektimeve prej tyre;
- Rritje e numrit të akteve procedurale të mbajtura nga grupet e inspektimit për konstatimin e paligjshmërisë (procesverbal konstatimi kundërvajtje, vendosje gjobash);
- Numri i inspektimeve për sektorin e Inspektimit në Territor ka rënie gjatë muajve të dimrit, pasi për shkak të temperaturave nën zero pezullohet puna në ndërtim;
- Zgjidhje të problematikave të ngritura në ankesat e qytetarëve;
- Rritje e mbikëqyrjes ndaj IMT-ve vendore lidhur me zbatimin e ligjshmërisë në territorin që mbulojnë;
- Rritje e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit për parandalimin e veprimtarisë së paligjshme.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Përmirësimi i imazhit të institucionit, përgatitja dhe ngritja profesionale e punonjësve sipas fushave që mbulojnë, nëpërmjet trajnimeve dhe njohjes së kuadrit ligjor;
2. Rritja e parametrave të parandalimit të paligjshmërisë, forcimin e zbatimit të ligjit, rritjen e cilësisë së shërbimeve, rritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të punonjësve të kësaj drejtorie, rritjen e besimit dhe forcimin e marrëdhënieve me komunitetin, konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera;
3. Trajnimi i inspektorëve të sektorëve për procesin e plotësimit të dokumentacionit të inspektimit sipas dispozitave ligjore;
4. Azhurnimi i legjislacionit dhe njohja me ndryshimet ligjore për trupën inspektuese;
5. Koordinim efikas dhe i shpejtë me të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë ligjzbatuese dhe institucione të tjera vendore për parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme dhe kryerjen e të gjitha veprimeve ligjore dhe administrative;
6. Ndërgjegjësimi i institucioneve vendore si bashkitë respektive të Qarkut Korçë si dhe i organeve ligjzbatuese Polici, Prokurori dhe organe të tjera si njësitë e shëndetit publik në lidhje me detyrat funksionale të IKMT dhe sektorëve specifike, për sa i përket zbatimit të akteve ligjore e nënligjore;
7. Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
8. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
9. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
10. Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
11. Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
12. Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
13. Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut;
14. Parandalimi, zbulimi dhe goditja e veprimtarisë së paligjshmërisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të kuadrit ligjor në ndërtim;
15. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut në lidhje me veprimtarinë e paligjshme të konstatuar në territor për ndërtime pa leje, ndikim mjedisor dhe fushën e pyjeve;
16. Parandalimi, zbulimi dhe goditja e veprimtarisë së paligjshme të prerjes dhe transportimit të paligjshëm të materialit drusor, bimëve medicinale, gjuetisë së paligjshme në fond pyjor. Koordinim më i mirë dhe i shpejtë i veprimeve të ndërmarra me komisariatet e policisë së Qarkut Korçë dhe sektorët e pyjeve që funksionojnë pranë bashkive të Qarkut Korçë, në rastet e evidentimit të kundërvajtjes;
17. Realizimi i një bashkëpunimi më të mirë ndërinstitutional duke zhvilluar tryeza pune dhe takime të përbashkëta për parandalimin e veprimtarisë së paligjshme, në mënyrë që të ketë një koordinim sa më të mirë të veprimeve të ndërmarra bazuar në dispozitat ligjore në fuqi;

Gjatë vitit 2024, për këtë Drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe realizimin e inspektimeve të planifikuara për sektorët;
2. Trajtimi dhe përgjigje shkresave, ankesave dhe problematikave të ardhura pranë drejtorisë;
3. Kemi ndjekur të gjitha procedurat sipas ligjit për rastet që kemi konstatuar;
4. Rritjen e bashkëpunimit për goditjen e paligjshmërisë me institucionet e tjera.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për:

1. Mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme;
2. Mbrojtjen e mjedisit nga gërmimet e paligjshme në shtretërit e lumenjve, hedhjeve të mbeturinave dhe materialeve inerte;
3. Parandalimi dhe bllokimi i prerjeve të paligjshme, transportit dhe nga gërmimet e paligjshme në pyje;
4. Parandalimi i gjuetisë së paligjshme.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

1. Janë kryer gjithsej 266 inspektime në të gjithë qarkun;
2. Janë marrë masa administrative për dënim me gjobë për 6 subjekte të gjetura në shkelje në fushën e mjedisit me vlerë totale 11.000 000 lekë;
3. Janë realizuar inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit, ADZM dhe katër Bashkitë e Qarkut Dibër;
4. Janë trajtuar të gjitha shkresat dhe ankesat e ardhura.

Risite e vitit 2024:

1. Hartimi i planit të përbashkët me Policinë e Shtetit;
2. Bashkëpunimi me strukturat Qendrore dhe Vendore;
3. Hartimi i planit të masave të përbashkëta për situatën e zjarrvënies në pyje gjatë periudhës së verës;
4. Inspektimet e kryera në kuadër të Paketës së Sigurisë në shkollat;
5. Hartimi i planit të veprimit për marrjen e masave në kuadër të Task-Forcës ndër-institucionale të sezonit turistik veror 2024;
6. Marrja e masave për lirim vullnetar të hapësirave nga mjetet motorrike, rimorkiove si dhe të pjesëve të tyre të këmbimit të dala jashtë përdorimit në një distancë jo më pak se 1 km nga autostradat apo rrugëve interurbane kryesore dhe dytësore.

Mangësi dhe problematika:

1. Mungesa e mjeteve lëvizëse;
2. Mungesa e furnizimit me karburant;
3. Pajisje zyresh (Kompjuter, fotokopje, kondicionerë)

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

1. Drejtoria Rajonale Dibër përbëhet nga sektorët si vijon:
2. Sektori i Inspektimit të Territorit;
3. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave;

4. Sektori i Inspektimit të Pyjeve;
5. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Inspektimit Territorit:

Sektori i Inspektimit Territorit për periudhën Janar - Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Zonat me rëndësi kombëtare;
2. Akset rrugore dhe Rrugët Nacioanle;
3. Kontrolli i IMT-ve;
4. Kontrolli i objekteve në zhvillim.

Në periudhën janar - dhjetor janë bërë 103 inspektime gjithsej në të katër Bashkitë e Qarkut Dibër.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

- 1.Rritje e gadishmërisë në bashkëpunim me sektorët e tjerë dhe institucionet e tjera;
- 2.Rritje e zgjidhjes së ankesave në rrugë zyrtare ose postë;
- 3.Rritje e zgjidhjes së ankesave nga platforma e bashkëqeverisjes.

Sektori Mjedis/Ujëra:

Sektori Mjedis-Ujëra	Nr. Inspektimeve	Nr.Masave Administrative (Gjobë)	Nr. Sekuestrimeve
Janar	4	1	-
Shkurt	41	-	-
Mars	3	2	-
Prill	8	2	-
Maj	8	-	-
Qershor	5	-	-
Korrik	7	-	-
Gusht	5	-	-
Shtator	3	1	-
Tetor	1	-	-
Nëntor	-	-	-
Dhjetor	-	-	-
TOTAL	85	6	-

Sektori Mjedis/ujëra për periudhën Janar - Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Në zonat minerare;
2. Klinika dentare;
3. Kontrollin e subjekteve që nxjerrin dhe shfrytëzojnë inerte si (Gurore, inerte lumore, etj.);
4. Inspektim në fushën e karburanteve;
5. Hec-et;
6. Servis dhe makina në fund të jetës.

Në total janë realizuar 85 inspektime të ndara si më poshtë:

1. Në mjedis janë kryer 78 inspektime në të gjitha Bashkitë dhe subjekte të ndryshme;
2. Në ujëra 7 inspektime në dy lumenjtë kryesorë lumi Drin dhe ai Mat.

Gjatë inspektimeve të realizuara gjatë vitit 2024, janë mbajtur gjithsej 6 raste konstatim kundravajtje (3 në mjedis dhe 3 në ujëra) me vlerë 11.000.000 lekë.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Evidentimi i problematikës së shkarkimeve të ujërave të ndotura nga ndërmarrjet e ujësjellës - kanalizimeve të qyteteve Peshkopi, Bulqizë e Klos, ku bëhen në mjediset ujore pritëse të pa-trajtuara. Këto shkarkime nuk i nënshtrohen trajtimit të parë dhe të dytë e jo më ndërtimit të impianteve të trajtimit të tyre. Ndërsa në Bashkinë Mat është në përfundim impianti i trajtimit të ujërave të ndotura;
2. Evidentimi i problemeve të mbetjeve inerte e urbane është shqetësuese problematika e mbetjeve inerte ne Qarkun Dibër. Në përgjithësi në Bashkitë Klos, Bulqizë dhe Dibër mungojnë studimet dhe miratimet e vend-depozitimeve të mbetjeve inerte. Sidomos në njësitë vendore nuk zbatohen detyrimet e ligjit 10463, date 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe të VKM nr. 575, datë 14.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Sektori i Inspektimit Pyjor:

Sektori i Inspektimit Pyjor për periudhën Janar - Dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

3. Zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e egër, veprimtaritë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor nga subjektet private dhe publike;
4. Mbrojtjen dhe sigurinë e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimin penal të autorëve të tyre, në përputhje me parashikimet e legjislacionit penal;
5. Zbatimin e legjislacionit për përdorimin dhe vjeljen e prodhimeve pyjore nga burimet pyjore e jo pyjore në pronësi apo përdorim të njërive të qeverisjes vendore, zonat e mbrojtura ose në pronësi private;
6. Bashkëpunim me Policinë e Shtetit duke referuar çështjet penale në prokurori.

Gjatë vitit 2024 janë realizuar gjithsej 78 inspektime, nga të cilat 38 janë në bashkëpunim me institucione të tjera të ndara si më poshtë:

- Inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit 17;
- Inspektime në bashkëpunim me ADZM 7 ;
- Inspektime në bashkëpunim me Bashkitë 14.

Muaj	Nr. Gjithsej	Rrugë auto	Ekonomi pyjore	Subjekte	Gjueti	Policinë	ADZM	Bashki
Janar	4	4	0	0	0	0	0	0
Shkurt	6	6	0	0	0	0	0	0
Mars	8	2	1	0	0	1	2	2
Prill	4	0	0	0	0	1	1	2
Maj	15	4	3	0	0	4	0	4
Qershor	7	1	0	4	0	1	1	0
Korrik	8	2	2	0	0	3	0	1
Gusht	6	0	1	0	0	3	1	1
Shtator	7	0	1	0	0	2	1	3
Tetor	5	2	1	0	0	0	1	1
Nentor	4	3	1	0	0	0	0	0
Dhjetor	4	1	1	0	0	2	0	0
Totali	78	25	11	4	0	17	7	14

SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE:

- Juristi dhe Specialisti i Financës;
- Mbajtja në mënyrë korrekte në protokollimin e shkresave të ardhura në institucion, të shkresave të dërguara dhe protokolleve të mbledhjeve;
- Raportimi javor (çdo të Enjte në email) dhe raportimi mujor (çdo fund muaj në formë shkresore) në lidhje me inspektimet e kryera me dhe pa DVP;
- Përfaqësimi i rregullt në të gjitha seancat gjyqësore nga ana e juristes së qarkut;
- Përcjellja e fletë - thirrjeve, ankimeve civile pranë drejtorisë juridike qendër, gjithashtu dhe njoftim vendimi ndaj subjekteve.
- Mbajtja dhe dërgimi elektronikisht dhe në formë shkresore çdo muaj i listëprezencës së punonjësve;
- Dërgimi i faturave postare në IKMT Qendër për likuidimin e tyre;
- Mbajtja e inventarit të drejtorisë dhe kartelat e inventarit për të gjithë personelin
- Dërgimi çdo muaj i evidencës së gjobave;
- Hartimi i regjistrit të riskut dhe hartimin e Projekt Buxhetit Afat-Mesëm;
- Dërgimi çdo javë (ditën e Hënë) i tabelës së ankesave të ardhura dhe të trajtuara pranë IKMT Qendër;
- Mbajtja dhe dërgimi i fletë udhëtimeve së bashku me kuponat tatimor pranë IKMT Qendër.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025:

- Parandalimi, zbulimi dhe goditja e veprimtarisë së paligjshmerisë për çdo ndërtim në shkelje të kushteve të zbatimit të ligjit të urbanistikës;
- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe burimeve të saj;
- Mbrojtja ,ruajtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit ,vlerave kulturore dhe estetike të peisazhit natyror;
- Kontrolli mbi zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e egër, veprimtaritë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor nga subjektet private dhe publike.

XXII. VEPRIMTARIA E DREJTORISË RAJONALE IKMT VLORË

Gjatë vitit 2024, për këtë drejtori, janë përmbushur detyrat institucionale për:

1. Ruajtjen dhe sigurinë e territorit, ndërtimeve, peizazhit, tokës, ajrit, ujërave, dhe pyjeve nga ndotja, dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji;
2. Disiplinim të punimeve në ndërtim, cilësisë së produkteve të ndërtimit si dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore;
3. Mbrojtja dhe siguria e pyjeve përmes parandalimit, zbulimit dhe hetimit të veprave penale kundër pyjeve dhe procedimit penal të autorëve;
4. Inspektimet janë kryer në përputhje me programet e miratuara të punës, porositë dhe rekomandimet e veçanta të instancave eprorë, bashkëpunim me sektorët, drejtoritë në qendër si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore.

Prioritetet kryesore të Drejtorisë për 2024:

Prioritet gjatë këtij viti ka qenë përgatitja dhe planifikimi i masave për :

10. Rritjen e cilësisë së inspektimeve dhe praktikave me qëllim rritjen e aftësisë parandaluese dhe kontrollin më të mirë të territorit;
11. Grumbullimi i informacionit në lidhje me fushat e veprimit të sektorëve të IKMT nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional me strukturat përkatëse;
12. Bashkëpunimi me institucionet e vartësisë si Inspektorati Qendror apo IKMT Qendër, me qëllim trajnimin e punonjësve për rritjen e aftësive profesionale si dhe integritetin në ushtrimin e detyrës;
13. Mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtja dhe përmirsimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut.

Të dhënat kryesore të Drejtorisë:

- Treguesit kryesorë të Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave gjatë vitit 2024 janë si më poshtë.

1. Inspektime totale (192);
2. Inspektime online të programuara (32);
3. Inspektime online të paprogramuara (6);
4. Vendime administrative (6), me vlerë totale 8.000.000 lekë;
5. Mjete të sekuestruara (0);
6. Inspektime në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera (85);
7. Janë trajtuar të gjitha ankesat dhe shkresat.

- Treguesit kryesorë të Sektorit të Kontrollit të Territorit:

1. Inspektime totale (19);
2. PVK për konstatimet e kundërvajtjeve (0);
3. Vendime administrative të mbajtur për shkelje (0);
4. Bashkëpunimet dhe korrespondencat shkresore (205) shkresa në bashkëpunim me PSH, IMT, ASHK , ARRSH;
5. Janë trajtuar të gjitha ankesat dhe shkresat.

- Treguesit kryesorë të Sektori i Pyjeve:

1. Inspektime totale (99);
2. PVK për konstatime (8);
3. Vendime administrative të mbajtur për shkelje (0) (është hequr e drejta e inspektimit dhe vendimit sipas udhëzimit Nr. 17 dt. 20.04.2023 të inspektoriatit të përgjithshëm);
4. Bashkëpunimet dhe korrespondencat shkresore (8) shkresa në bashkëpunim me AKM dhe Agjencia e Pyjeve Tirane, ADZM, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore;

5. Janë trajtuar të gjitha ankesat dhe shkresat.

Risitë e vitit 2024:

1. Trajtimi i ankesave në kohë reale nëpërmjet postës elektronike;
2. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme në institucione vendore dhe ndërkombëtare.

Prioritetet:

1. Parandalimi i shkeljeve në drejtim të mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.
2. Goditja e krimeve mjedisore si masë e domosdoshme dhe efikase për parandalimin e shkeljeve në mjedis.
3. Rritja e bashkëpunimit me institucionet qendrore dhe vendore.
4. Bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese në fushën e mjedisit, ujërave, pyjeve me qëllim shkëmbimin e të dhënave, informacioneve për rastet ose/dhe inspektime të përbashkëta në terren.

Mangësi dhe problematika :

1. Pa mjaftueshmëri e mjeteve logjistike;
2. Pa mjaftueshmëri e karburantit;
3. Mos azhurnimi në kohë reale i sistemit online (e-inspektimit).

Strukturat Përbërëse Të Drejtorisë:

Drejtoria Rajonale Vlorë përbëhet nga sektorët si vijon:

1. Sektori i Inspektimit të Territorit;
2. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave;
3. Sektori i Inspektimit Pyjor;
4. Sektori i Shërbimeve Mbështetëse.

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave:

Sektori i Mjedisit dhe Ujërave për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Kontrolli i subjekteve që gjenerojnë mbetje të llojeve të ndryshme;
2. Kontrolli i bashkive mbi menaxhimin e mbetjeve urbane;
3. Kontrolli i subjekteve që nxjerrin dhe shfrytëzojnë inerte (gurore, inerte lumore, karriera bituminoze, etj.);
4. Kontrolli i subjekteve (me gropa septike) të cilët nuk janë të lidhura me rrjetin e U.K;
5. Kontrolli i subjekteve të pa pajisura me leje mjedisore;
6. Kontrolli i subjekteve që trajtojnë makinat në fundin e jetës, në zbatim të Urdhërit Nr. 44 të Ministrit të Brendshëm;
7. Bashkëpunime në mbështetje të sektorit të territorit për kontrollin dhe prishjen e subjekteve në Bypassin e Vlorës dhe përgjatë rrugës Orikum - Dukat - Llogara.

Duke analizuar treguesit kryesor të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës si më poshtë:

1. Është ulur numri i masave administrative të marra, pezullimeve dhe sekusestrove;
2. Është rritur bashkëpunimi me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera.

Sektori i kontrollit të Territorit:

Sektori i kontrollit të Territorit për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Ndërtime të paligjshme;
2. Ndërhyrjet në bregdet;
3. Bashkëpunim me IKMT Qendër për kontrollin dhe prishjen e subjekteve në Bypassin e Vlorës, Lungomare 3 dhe përgjatë rrugës Orikum - Dukat - Llogara.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritja e bashkëpunimeve me institucionet e tjera vendore;
2. Rënie të masa administrative të marra.

Sektori i Inspektimit të Pyjeve:

Sektori i inspektimit të pyjeve për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Parandalimin dhe mbrojtjen e fondit pyjor nga prerjet e paligjshme dhe abuzive;
2. Zbatimi i moratoriumit të gjuetisë;
3. Mbrojtja e fondit pyjor dhe kullësor nga zaptimet dhe përdorimet e jashtëligjshme;
4. Verifikimet në kohë për ankesat dhe informacionet e ardhura nga qytetarë dhe institucione të tjera.

Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

1. Rritje në numrin e inspektimeve;
2. Rënie të masave administrative të marra.

Sektori Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse:

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për periudhën janar - dhjetor 2024 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

1. Mbulim të veprimtarisë administrative për funksionimin optimal të shërbimeve të arkivit, protokollit dhe regjimit hyrës dhe dalës të korrespondencës zyrtare;
2. Mbarëvajtje të veprimtarisë së institucionit në aspektin administrativ dhe financiar;
3. Trajtim i informacioneve dhe praktikave si dhe procedurave të ardhura;
4. Funksionim optimal të shërbimeve mbështetëse e logjistike në përputhje me nevojat parësore të drejtorisë;
5. Përdorimin efektiv të inventareve në dispozicion të institucionit;
6. Mbështetje për sektorët sipas nevojave të brendshme të institucionit;
7. Përfaqësim juridik dhe mbrojtje e interesave të institucionit në gjykatë;
8. Raportim mbi kërkesat, aketat, inspektimet dhe shkresat e kryera nga secili sektor në mënyrë periodike javore, mujore dhe vjetore.

9. Duke analizuar treguesit kryesorë të punës rezulton se ka rritje dhe rënie të disa treguesve të punës, si më poshtë:

10. Është realizuar me përpikmëri funksionimi optimal i shërbimeve të arkivit, protokollit dhe regjimit hyrës dhe dalës të korrespondencës zyrtare;
11. Çdo muaj janë rakorduar faturat e shërbimit postar, OSHE, Ujësjetës Kanalizime, ndjekja e shërbimit të internetit, mirëmbajtja e ambjenteve të institucionit;
12. Janë përpiluar listëprezencat mujore dhe janë dërguar sipas afateve të vendosura nga IKMT Qendër.

PRIORITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR VITIN 2025

1. Kontrolli i vijës bregdetare gjatë sezonit turistik;
2. Kontrolli i bashkive dhe subjekteve që menaxhojnë mbetjet në të gjithë qarkun;
3. Kontrolli i shtretërve të lumenjve dhe karrierve në qiell të hapur;
4. Evidentimi i subjekteve që nuk janë të pajisur me leje mjedisore;
5. Kontrolli për ndërtime të paligjshme;
6. Kontrolli i vijës bregdetare për ndërtime të paligjshme;
7. Mbrojtja dhe siguria në pyje;
8. Monitorimi i gjuetisë.

XXIII. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT KRYESORE TË IKMT-së NË VAZHDIM TË VITIT 2025.

IKMT duke u bazuar në prioritetet e përcaktuara në Strategjitë Ndërsektoriale dhe Sektoriale të IKMT-së, prioritetet e punës së Ministrisë së Brendshme, si dhe në Programin e Punës së IKMT-së për vitin 2025, do të vazhdojë të zbatojë këto prioritete kryesore:

Prioritet I: (prioriteti kryesor)

Parandalimi i gjuetisë së paligjshme:

1. Inspektime për konstatimin e gjuetisë së paligjshme.
2. Inspektime në zonat e Mbrojtura.
3. Inspektime në fondin pyjor kullosor.

Prioritet II:

Prioritete specifike: Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave.

1. Monitorimi dhe Kontrolli i subjekteve që shfrytëzojnë burimet ujore e nuk janë të pajisur me leje nga Instucionet përkatëse.
2. Monitorimi i subjekteve që operojnë në shtratin e lumenjve me qëllim nxjerrje e inertit lumor.
3. Kontrolli i subjekteve që kryejnë shkarkim të pakontrolluar në ajër, ujë, tokë duke shkaktuar dëme të parikuperueshme.

Prioritet III: Inspektimi i Territorit.

Prioritete specifike:

1. Kryerja e Inspektimeve në zona të mbrojtura, në akse kombëtare etj.
2. Sigurimi dhe respektimi i normave, standardeve dhe kushteve zhvillimore dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e planifikim.
3. Inspektime në zonat e plazhit në bashkëpunim me AZHT.
4. Evidentim i secilit lloj punimi ndërtimor në zonën bregdetare që klasifikohet si zonë me përparësi zhvillimi turizmi.
5. Plotësimi periodik i regjistrave elektronik.